

Tetor 2014  
Numri: 79  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

# ETIKA



BAJRAMI DHE KURBANI  
OSMAN NURI TOPBASH



MUSTAFA ERISH  
SHIFA BINTI ABDULLAH



HIR HOXHA  
KUR VJEN NDIHMA  
DHE DËNIMI I ALLAHUT



IRFAN OZTURK  
NJË LUTJE NJË MALLKIM




NË RRJEDHËN E JETËS  
NUREDIN NAZARKO



MUSTAFA KYÇYKASHÇË  
MBI LUMTURINË  
DHE DHUNËN  
NË MARTHESË

# Kibla

*në rrugëtimin e jetës*




ISSN 2227-3611  
9 772227 361004 1 0

# Përmbajtja



Cfarë presin të moshuarit tanë prej rinisë?  
Salih Zeki Meric

18



Arafati dhe Lutja  
Ali Riza Temel

8



Bajrami dhe Kurbani  
Osman Nuri Topbash

34



24

20




Kur vjen ndihma  
dhe dënimi i Allahut  
Ilir Hoxha

- 5 Shoqëri me kible të gjallë  
Ahmet Tashgetiren
- 11 Kurbani  
Filiz Konxha
- 12 Haxhi, ibadeti plot urtësi  
Dr. Durak Puzmaz
- 14 Zemra e përkushtuar  
ndaj ibadeteve të natës  
Ibrahim Koç
- 16 Receta kuranore ndaj fobive tona  
A. Jasin Demirxhi
- 17 Ndërtimi i shtëpisë së Allahut  
M. Sami Ramazanogllu
- 23 Kush e anuloi ajetin?  
Muhamed El-Gazali
- 24 Shifa binti Abdullah (r.a.)  
Mustafa Erish



56

- Përse e studiojmë jetën e Pejgamberit (a.s.)? 26  
Prof. dr. Muhamed Hamidullah
- Një lutje një mallkim 28  
Irfan Ozturk
- Në rrjedhën e jetës 30  
Nuredin Nazarko
- Një Ajet - Një Hadith 32
- Shkolla e Haxhit 41  
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- Martesa në botën moderne 44  
Ajnur Tutkun
- Shpella e Theurit 46  
dhe enigma e të qenit bashkë me Zotin  
Dr. Vejsel Akkaja
- Virtyti i kurbanit 48  
Ali Bujyqçapar
- Të duash Pejgamberin (a.s.) 50  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan




Mbi lumturinë dhe dhunën në martesë  
Mustafa Kyyqashçë

38

Zgjidhja për ndihmën e individit, shoqërisë,  
umetit dhe njerëzisë është në përsëritshmëri  
M. Ali Eshmeli

52



# SHOQËRI ME KIBLË TË GJALLË

Ahmet Tashgetiren

Qëndrova në prezencën Tënde...

Ndoqa Kuranin Tënd...

U ktheva nga Kibla!<sup>1</sup>...

Kibla ime Qabja...

Kur mendojmë për rruzullin tokësor, me miliona myslimanë kthehen në atë drejtim pesë herë në ditë të përqendruar me zemër në namaz...

Me miliona zemra lidhen me Qaben. Kibla i mbledh zemrat rreth Qabes dhe ia paraqet Krijuesit si një trup të vetëm. Pesë herë në ditë, Krijuesit i ofrohet një buqetë e përbërë prej miliona zemrash...

Vetëdija ndaj kiblës është një gjendje e cila e shpëton zemrën nga devijimi dhe shpërndarja; e mbledh atë dhe e mban vazhdimisht në drejtimin e duhur. Islami e ka predikuar këtë gjendje si gjëja më e domosdoshme për mbajtjen gjallë të zemrës së myslimanit. Namazi është i domosdoshëm për myslimanin, ndërsa kibla është e domosdoshme për namazin.

Ashtu si namazi, që e nxjerr njeriun përpara Krijuesit të tij në mëngjes, në drekë, në ikindi, në aksham dhe në jaci dhe me këtë siguron lidhjen e zemrës së njeriut me Krijuesin, ashtu edhe vetëdija ndaj kiblës, në strukturën e namazit luan rolin e mbledhjes së zemrës prej lëkundjeve, devijimeve, hutimeve dhe humbjeve në këtë botë.

Vetëdija ndaj kiblës është perceptimi "i drejtimit" që duhet të gjendet tek myslimani. Nëse identiteti i myslimanit është i

1. Kibla: Drejtimi i Qabes prej vendit ku ndodhemi.

detyruar të jetë i lidhur në rrugën e drejtë -siratul mustakim- e jo në rrugë të tjera- edhe qëndrimi në "siratul mustakim" varet nga ekzistimi i një kible absolute.

Kibla është një gjilpërë busulle e "siratul mustakim"it, që ka zënë vend në zemër.

### **"Fe ejne tedhhebuun / E ku jeni duke shkuar?"<sup>2</sup>**

Njeriu është gjithmonë në lëvizje e në udhëtim mbi rruzullin tokësor. Jeta s'është gjë tjetër veçse një udhëtim. Pyetja në të cilën fokusohet zemra, ndërkohë që je duke vërejtur qiellin, tokën e nëntokën, është:

Ku është kibla juaj?

Ku është Veriu, Jugu, Lindja e Perëndimi?

Vetë drejtimet nuk kanë ndonjë kuptim. Por nëse drejtimet shprehin zgjedhjen e një besimi apo një mënyre jetese, aty fillon edhe zgjedhja e kiblës dhe Islami kërkon prej myslimanëve që zemrat e tyre t'i drejtojnë nga **"Shtëpia e Allahut"**.

Kudo që shkon, puna e parë që bën një mysliman, është kërkimi i kiblës, sepse pak më vonë do të falë namazin. Namazi është qëndrimi në audiencë të Allahut. Namazi është kuptimi i të fshehtës së krijimit. Namazi është të thuash pesë herë në ditë: "Lebbejke Allahumme lebbejk / lu përgjigja thirrjes Tënde, o Allah!" dhe të qëndrosh gatitu. Namazi është shfaqja më kuptimplote e devotshmërisë.

Nëse myslimani nuk e ka humbur ndjesinë ndaj namazit, do të thotë se nuk ka humbur as lidhjet e zemrës me Zotin e tij. Zemra e njeriut që nuk i humb lidhjet me Zotin e saj, nuk humbet as perceptimin e kiblës. Për myslimanin, këta janë damarë që ushqejnë njëri-tjetrin.

E kundërta e kësaj, njeriu i cili nuk vihet në kërkim të kiblës në vendet ku shkon, është njeriu i cili ka probleme në lidhje me namazin. Dhe njeriu që ka problem në lidhje me namazin, është e vështirë të bëjë një jetë si mysliman.

Në bazë të kësaj, vetëdija ndaj kiblës, për personalitetin e myslimanit do të thotë se vetëdija e tij është gjallë. Qabja, gjatë periudhës së haxhit, hyn si një tjetër realitet në botën e myslimanit... Qabja, për nga ku drejtohet pesë herë në ditë, tashmë qëndron në horizontin e tij për t'u parë me sy, për ta bërë tavaf dhe për të prekur trupin e saj...

Haxhi është bërë i detyrueshëm një herë në jetë për atë që ka mundësi. Mirëpo, Qabja qëndron në vendin e saj në çdo periudhë të viti dhe takohet me ata që e vizitojnë dhe i drejtohen me zemër në çdo orë të ditës,

2. Shih. Kuran: et-Tekuir, 81/26.

në çdo minut e në çdo sekondë.

Qabja, është shtëpia e parë e Allahut, e ndërtuar mbi rruzullin tokësor. Sipas asaj që na mëson Kurani, kudo që të drejtohet njeriu, aty është edhe Allahu. Padyshim se Allahu është i pavarur nga hapësira dhe Atij nuk mund t'i atribuohet vend. Nisur nga kjo, të drejtohesh nga Qabja nuk do të thotë ta adhurosh atë.

Qabja është një vend, ku zemrat fokusohen në teuhid/ njëshmërinë e Allahut dhe devotshmëri. Nga kjo pikëpamje, Qabja, është më tepër se një bina e ndërtuar me gurë. Qabja mbase është vetë zemra. Mund të thuhet se zemrat, duke u drejtuar vazhdimisht nga Qabja, e kanë shndërruar atë në zemrën e një besimtari të brumosur me teuhid.

Lidhja që i bëjnë sufitë zemrës dhe Qabes dhe shpeshherë vënia e zemrës në plan të parë, mbase duhet të jetë, për shkak se vetë Qaben e kanë shndërruar në zemër.

Besimtarët shkojnë në haxh, qëndrojnë në Arafat, zhvishen nga statutet që gëzojnë në këtë botë, shohin mahsherin, qëndrojnë në prezencë të Allahut, bëjnë llogarinë e librit të jetës në llogarinë e madhe, rinovojnë qelizat me përgjërime të sinqerta dhe kërkesë për falje, pastaj përjetojnë takimin e përzemërt me Qaben, vijnë për qark saj si të dashuruar, e marrin atë brenda vetes, çdo vijë të saj e qëndisin në shpirtin e tyre, rinovojnë besnikërinë e vetëdijen ndaj Qabes dhe kthehet në vendin e vet. Njësoj si besimtari që hyn në xhami, i cili bën takimin e përzemërt të trupit me namazin, duke qëndruar në këmbë, në ruku e në sexhde. Pastaj kthehet përsëri në jetën e përditshme...

Mbajtja gjallë e vetëdijes së kiblës, në fakt është për të parandaluar lëkundjet brenda jetës. Se, po të shkojë njeriu në Qabe, bukuria e saj domosdo që do ta tërheqë atë dhe do ta bëjë t'i vijë për qark si i dashuruar. A është e mundur të shkosh në Arafat e të mos bësh dua? A është e mundur të shëtisësh në vende të tjera, ndërkohë që disa milion zemra përpiqen të vjelin mëshirën hyjnore?

Njeriu edhe kur hyn në xhami, rrethohet prej saj. Në çdo xhami e në çdo mihrab, patjetër ka edhe pasqyrime prej botës shpirtërore të Qabes. Kjo atmosferë, në njëfarë kuptimi, është si inkubatorët ku mbahen fëmijët e porsalindur; një atmosferë sterile, e pastruar prej ndyrësive dhe gjynaheve.

Mirëpo, këtu nuk mund të qëndrosh vazhdimisht. Haxhi është njëherë në jetë dhe ditët e tij janë të kufizuara. Vijnë e ikin. Njerëzit shkojnë dhe kthehen prej qyteteve të shenjta. Edhe orët e namazit janë të kufizuara. Nëse i llogarisim pesë kohë namazi brenda 24

orëve bëhen a s'bëhen dy orë. Do apo s'do, nga xhamia do të dilet.

Jashtë xhamisë, ka një jetë që nuk është aspak sterile. Pikërisht, këtu tregohet edhe aftësia. Kur të largohesh prej atmosferës ku gurëzohet e dëbohet shejtani e të kthehesh në realitetin e kësaj bote.

Pyetja jetësore është:

Kush shkon në haxh, ka mundësi ta marrë Qaben brenda vetes dhe ta sjellë. Tashmë, këtej e tutje, a jeton ai duke ndjerë rrahjen e damarit të Qabes në zemrën e tij?

Besimtari që qëndron në namaz, a mund të ndërtojë një jetë të vetëdijshme ndaj rrugës së drejtë që e fitoi në sajë të kiblës dhe e formoi gjatë qëndrimit në prezencë të Allahut?

Ka një thënie popullore, në të cilën thuhet: **"Kali i dobët nuk ka kible"**.

Pra, kalin që nuk ka këmbë e trup të fortë, nuk është e mundur ta mbash në një drejtim. Goditja më e vogël mund ta lëkundë e ta rrëzojë atë.

Edhe njeriu, nuk është më ndryshe. Kujdesi i njeriut ndaj kiblës, megjithëse nuk është një çështje e lidhur me forcën fizike, është e sigurt se është një çështje e lidhur me forcën e zemrës.

Kush shkon në haxh, duhet ta qëndrisë në zemër duanë që bëhet në Arafat.

Kush bën tavaf Qaben, duhet ta gdhendë Qaben në zemrën e vet si një gjilpërë busulle që tregon kiblën.

Kush hyn në xhami, duhet të bartë në rrahjet e zemrës së vet harmoninë e kthimit nga kibra...

Shoqëria myslimane duhet të marrë formën e një shoqërie të kiblës.

Të dërgosh çdo vit dhjetëra mijëra myslimanë në Qabe, pastaj të jesh një shoqëri që ka probleme në marrëdhëniet me kiblën, nuk është e lehtë të shpjegohet brenda kuadrit islam.

Themi se ata që dalin këtë vit në udhëtimin e shenjtë, duhet ta fusin Qaben në zemrat e tyre pa dalë ende për udhë dhe kur të kthehen në vendet e tyre, duhet të marrin prej atje aq sa të munden, që të ndërtojnë një shoqëri me kible të gjallë.

Kur shoqëritë myslimane të shpëtojnë prej gjendjes së devijimit të kiblës, edhe bota do të ndryshojë.



# Arafati dhe Lutja

All Riza Temel

Qëndrimi në Arafat, i cili është prova e mahsherit në këtë botë për miliona njerëz që kanë të njëjtën fe, të njëjtat dëshira dhe të njëjtat zemra, edhe pse kanë gjuhë, ngjyra, raca dhe vende të ndryshme, është tabloja më e gjallë dhe më tërheqëse e haxhit. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Haxhi është Arafat."* Fjala Arafat vjen nga fjala "Marifet". Kandidati për haxhi integrohet me marifetin (njohjen e Zotit) në Arafat, e arrin Marifetullahun, gjallërohet me të dhe percepton mahsherin, tubimin para Mahkemetu'l-Kubra, Gjykimit të Madh. Nëse qëndrimi në Arafat, i cili përfaqëson tubimin më të vështirë dhe më emocional ndërmjet frikës dhe shpresës si në mahsher, nuk na i ngjall këto ndjenja brenda nesh, do të thotë se kemi bërë një qën-

drim pa marifet dhe se nuk e kemi konceptuar shpirtin e haxhit.

Në Arafat, i cili është mahsheri i kësaj bote, të gjithë: gratë, burrat, të moshuarit, të rinjtë kanë veshur qefinët e bardhë, diellin e nxehtë e kanë mbi kokat e tyre, lot në sy, shqetësim në zemra dhe djersë në ballë. Prandaj, Arafati është përjetimi në këtë botë i mahsherit në ahiret. Nevoja dhe dëshira më e madhe e njeriut në këtë atmosferë është gjetja e një vendstrehimi. Në mahsherin e madh, njerëzit do kërkojnë ndërmjetësues për të shpëtuar nga vështirësitë e mëdha që do përjetojnë. Ata do të shkojnë te Ademi (a.s.), te Nuhu (a.s.), te Ibrahim (a.s.), te Musa (a.s.) dhe te Isa (a.s.). Këta pejgamberë do të justifikohen me arsye të veçanta dhe do të thonë se nuk mund të ndërmjetësojnë. Pastaj, njerëzit të dëshpëruar, do të shkojnë te Muhamedi (a.s.) dhe do t'i thonë: "O Muhamed! Ti je i Dërguari i Allahut dhe pejgamberi i fundit. Të gjitha mëkatet e tua të janë falur. Kërko ndërmjetësim te Zoti për ne! A nuk e shikon gjendjen e vështirë në të cilën gjendemi?" I Dërguari i Allahut, (a.s.), do të bjerë në sexhde dhe do t'i përgjërohet Allahut Teala: "O Zot! Umeti im! Umeti im!" Së fundi, realizohet ndërmjetësimi. Atyre që kanë besim sa një farë sinapi, u hapen dyert e xhenetit. Tabloja e mahsherit që shpjegohet me detaje në hadithet fisnike, duhet të ndihet dhe të përjetohej me të njëjtën gjallëri edhe në Arafat. Arafati është mundësia më e madhe për t'u pastruar nga mëkatet, për t'u bërë kandidat për xhenetin, i cili është vendi i të pastërve dhe për të arritur kënaqësinë hyjnore. Ibadeti më i rëndësishëm që bëhet aty, është lutja. Faktikisht, lutja është esenca e të gjitha ibadeteve. Lutja është kërkim i mbrojtjes nga Allahu Teala dhe kërkim i ndihmës nga Ai. Robi ka vlerë aq sa i lutet Allahut të Madhëruar. Allahu Teala thotë: **"Thuaj: 'Zoti nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...'"** (Furkan, 77) Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Te Allahu nuk ka gjë më të mirë se lutja." (Ahmed b. Hanbel, Musned 2/362.) Lutjet që bëhen ditën e Arafatit, janë lutjet më të mira. Madje, dyshimi në pranimin e këtyre lutjeve nuk është pranuar si i lejuar.

Lutja është të shprehurit e robit dobësinë, modestinë dhe dëshirën e tij kundrejt Allahut të Lartësuar. Ajo është një gjendje në të cilën robi së pari hap zemrën dhe pastaj kërkon nga Allahu duke ngritur duart. Lutja

është një mirësi dhe një pranim në audiencën hyjnore. Allahu nuk e lejon robin të bëjë një lutje të cilën nuk do t'ia pranojë. Lutja është gjendja e mosshkëputjes së lidhjes me Zotin (xh.xh.). Allahu Teala, i cili është më afër nesh se damarët e qafës, na urdhëron t'i lutemi. Në Kuranin Fisnik, thotë: **"...Lutmuni Mua, në mënyrë që t'ju përgjigjem!..."** (Gafir, 60)

Lutja e bërë në mënyrë të sinqertë, është një deklaratë për lënien e të këqijave. Kur lihet ndonjë e keqe apo kur bëhet ndonjë mirësi, bëhet dua. Kur robi nisat për udhë apo kur fillon ndonjë punë, i lutet Zotit ta ndihmojë, duke thënë: "O Zot! Unë jam i dobët. Asgjë nuk mund ta bëj pa ndihmën Tënde. Unë kam nevojë për mbrojtjen dhe mbështetjen Tënde." Lutja është një klithmë shprese, një mbledhje e forcës dhe një mbledhje e vetvetes. Lutja është një mburojë karshi fatkeqësive. Ajo është arma më e fortë që përdoret në luftë me ligësitë, sepse, të mbështetesh



te Allahu Teala, do të thotë të marrësh fuqi nga Ai. Të bësh një jetë pa lutje, është sikur të shkosh në luftë pa armë. Lutja e atij që nuk ka vullnet për të bërë diçka, është e pavlerë. Nëse robi e nxjerr veten komplet jashtë funksioni, ndërkohë që ka gjëra për të bërë, së pari, kjo është mosrespektim ndaj vetes së tij. Njeriu shpëton nga përgjegjësia vetëm kur të jetë në një pozitë që nuk mund të bëjë asgjë. Lutja nuk është urdhër, sepse Allahut nuk mund t'i jepet urdhër. Allahu Teala është Ai që jep urdhra. Atij vetëm i kërkohet duke iu lutur. Kuptimi i ngritjes së duarve në lutje është ky: "O Zot! Unë vetëm kaq mund të bëj. Duart po i ngre për ato që nuk mund të bëj."

Për pranimin e lutjes ka disa kushte. Së pari, duhet të kryejmë detyrat që kemi ndaj Allahut Teala, në mënyrë që të kemi fytyrë për t'iu lutur. Pastaj, kërkesat tona duhet t'i shfaqim me modesti. Në suren el-Fatiha, të cilën e lexojmë në çdo namaz, kur themi: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe veten prej Teje ndihmë kërkojmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë!"** – së pari theksohet ibadeti, pastaj kërkesa për ndihmë. Kuptimi i kësaj është ky: Para së gjithash do të kryejmë obligimet ndaj Zotit (xh.xh.) dhe pastaj do të kërkojmë ndihmë.

Fjalët dhe veprat që i pëlqejnë Allahut të Madhëruar, janë shkak për pranimin e lutjeve. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Ai që dëshiron t'i pranohet lutja dhe të dalë nga vështirësia, le të nxjerrë nga vështirësia

dikë që është në gjendje të tillë.” (Ahmed bin Hanbel, 2/23.) Nëse dëshirojmë të na pranohet lutja, duhet të kemi gojë të pastër, zemër të pastër, ushqim dhe rroba hallall e të pastra. Le t’ua vëmë veshin këtyre fjalëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.): *“Si të pranohet lutja e dikujt, i cili ka marrë rrugën dhe ngre duart lart nga qielli, por rrobat i ka të papastra, flokët të parregulluar, ajo që ha, pi dhe vesh është haram dhe lutet: O Zot! O Zot?”* (Muslim, Zekat, 65.)

Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është lutje veprore dhe verbale që nga fillimi e deri në fund. Ai, me fuqinë që mori nga këto lutje, realizoi reformën më të madhe të botës. Ai që strehohet te Allahu Teala dhe e thërret Atë për ndihmë, do të thotë se ka trokitur në derën e duhur dhe ka kërkuar nga Fuqiploti. Lutjet pranohen më shumë në Arafat, Muzdelife, Mina dhe në Kabetu'l-Muaadhdhame. Me këto lutje karikojmë veten tonë dhe i japim fjalën Allahut të Madhëruar se kërkesat tona do t’i kthejmë në veprim. Kërkesat që nuk shndërrohen në vepra, në shërbime fetare dhe në aksion, janë shpresa boshe. Duatë kolektive që bëhen në Arafat, duhet të shndërrohen në vepra kolektive. Lutjet kolektive të bëra në Arafat dhe kërkesat e përbashkëta që i janë paraqitur Allahut Teala, duhet të shndërrohen në një vepër që zgjedh hallet e të gjithë myslimanëve në fillim dhe pastaj të të gjithë njerëzimit. Veçanërisht, këto lutje duhet të formojnë bazën e ringritjes, riformimit dhe ndërtimit të një jete të ndershme e krenare që u ka hije myslimanëve. Haxhi, i cili është kongresi i myslimanëve të të gjithë botës me pjesëmarrjen më të gjerë, krahas përfitimeve që arrihen për Ahiretin, duhet të bëhet shkak edhe për përfitime të kësaj bote. Njëri prej shkaqeve që njerëzit janë thirrur në haxh është edhe ky: **“Që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut...”** (Haxh, 28)

Haxhi, i cili është dua në çdo aspekt të tij, krahas faktit që duhet të formojë një identitet të ri në kuptimin individual, duhet që edhe në kuptimin e përgjithshëm t’i japë umetit identitetin “umeti më i mirë”. Këto lutje kolektive të bëra përgjatë viteve dhe këto kërkesa të shfaqura me lot në sy, sigurisht se nuk do të shkojnë dëm. Kërkesat e sinqerta do të arrijnë rezultate të kënaqshme inshallah. Mjafton që duart të përputhen me zemrat dhe gjuhët të përputhen me veprat. Njerëzit le të ndjekin të Dërguarin e Allahut (a.s.), i cili është udhërrëfyesi i njerëzisë, si në mahsher, ashtu edhe në Arafat, të zbatojnë parimet që ka sjellë Ai, të mblidhen nën udhëheqjen e Tij dhe të kërkojnë nga Allahu që t’ua mundësojë ndërmjetësimin e Tij në Ditën e Gjykimit. Lutjet dhe ibadetet nuk duhet të bëhen për formalitet. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka dhënë shumë rëndësi lutjes së Arafatit. Usame bin Zejdi transmeton: “Unë isha pas

të Dërguarit të Allahut në Arafat. Ai i ngriti duart dhe u lut. Deveja lëvizi dhe kapistra i ra në tokë. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, me njëren dorë përpiquej të kapte kapistrën, ndërsa me tjetrën vazhdonte të lutej!” (Nesai, 2/205.) Edhe pse ka shumë mëkate dhe gjynahe që e ndynjë këtë botë, Zoti përsëri i mëshiron njerëzit. Këtë ndoshta e bën për hatër të këtyre lutjeve dhe përgjërimeve që bëhen në haxh. Le të mos harrojmë se këto lutje të përbashkëta janë një garanci hyjnore për njerëzimin. Lusim Allahun e Madhëruar që lutjet, të cilat bëhen në Arafat të shndërrohen në vepra, kandidatët për haxhi t’i ndryshojë nga koka te këmbët, t’i pastrojë nga mëkatet e t’i bëjë si ditën kur kanë lindur nga nëna dhe të realizojë një rilindje në shkallë individuale dhe në shkallë umet! Le t’i themi kësaj lutjeje “Amin” të gjithë bashkë me një zë që do të lëkundë tokën dhe qiejt!



# Kurban

Fillz Konxha

Fjala kurban, është në tratën e paskajores, që vjen nga rrënja kurb, që do të thotë të afrosh. Kurban quhet edhe kafsha që theret për të shpresuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe për të fituar afërsinë e Tij.

Profeti (a.s.), në vitin e dytë pas emigrimit, një ditë pasi erdhi në Medine, duke u kthyer nga Beteja Sevik (dita e dhjetë e Dhul-Hixhes), doli në vendfalje (musala) bashkë me myslimanët. Pasi udhëhoqi faljen me dy rek'at pa ezan dhe pa ikamet, mbajti një ligjëratë. Në këtë ligjëratë që mbajti, i urdhëroi myslimanët të thernin kurban. Ndërsa vetë ai theri dy kurbane.

Xhabiri (r.a.), thotë: "Profeti (a.s.), në ditën e flijimit të kafshëve theri dy deshë me brirë të përdredhur dhe të majmë. Kur u drejtua për t'i therur tha: **"... Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët!"** (En'am, 79); **"...Në të vërtetë, namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij** (jam prej myslimanëve)." (En'am, 162-163) O Zot, ky kurban është prej Teje dhe për Ty, në emër të Muhamedit dhe të popullit të tij: "Bismilahi Allahu Ekber!" dhe i theri kurbanet." (Taxh, 207)"

Zejd Ibnu Erkam, (r.a.), transmeton: "Shokët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), pyetën: 'O i Dërguari i Allahut, çfarë janë këto kurbane që theren (flijohen) në ditën e Bajramit?' Ai u përgjigj: 'Është suneti i babait tuaj Ibrahimit, (a.s.)' Sahabët thanë: 'Mirëpo, çfarë sevapi do të kemi në therjen e kurbaneve?' Ai tha: 'Një sevap për çdo qimë të kurbanit.' Sahabët përsëri i thanë: 'Nëse është i lesh-të (si qengji i deles që theret për kurban), o i Dërguari i Allahut, (si do të jetë sevapi-shpërblimi)?' Alejhi salatu ue selami, iu përgjigj: 'Edhe për çdo qimë të leshit ka një sevap-shpërblim'.

Në një hadith tjetër ka thënë: "Të mos i afrohet vend-faljes sonë ai që e nëpërkëmb kurbanin dhe nuk e ther, megjithëse ka mundësi ekonomike."

Ndërsa në një hadith tjetër ka thënë: "Zgjidheni të mirë dhe të bukur kafshën për kurban, sepse ajo do t'ju mbajë në Urën e Siratit."

Aliu (r.a.), theri dy deshë, njëri prej të cilëve ishte për Profetin tonë të Nderuar. Kur e pyetën për shkakun e kësaj, ai u përgjigj:

"I Dërguari i Allahut më porositi të ther kurban për të, derisa të jem gjallë. Nuk do ta braktis kurrë këtë"

Porosia e Profetit (a.s.) për Aliun që të therte kurban për të, tregon dashurinë për të therur kurban për të.

Sipas transmetimit të Xhabir b. Abdullah: "Profeti (a.s.), kishte sjellë 100 deve për t'i bërë kurban në Haxhin e Lam-tumirës. Ngaqë ishte 63 vjeç, theri (bëri kurban) me dorën e vet nga një deve për çdo vit, të tjerat që mbetën i la që t'i therte Aliu. Pastaj mori një pjesë nga çdo deve, i poqën së bashku, hëngrën nga mishi dhe nga supa."

Profeti (a.s.) ka thënë: "Therni kurban, sepse ai është sunet i babait tuaj, Ibrahimit (a.s.)." (Ahmed Davudogllu, Sherhi Buluğu'l-Meram (Komentimi i Arritja e Qëllimit) Rrugët e Paqes, IV, 196).

Nëna jonë, Aisheja (r.a.), transmeton se Profeti, (a.s.), ka thënë: "Për birin e Ademit (njerëzit), ditën e Bajramit, nuk ka vepër më të dashur tek Allahu - subhanehu ve te-ala - se derdhja e gjakut (kurban). Ai kurban do të vijë Ditën e Gjykimit me brirët, leshin dhe me thundrat e saj, siç i ka pasur. Sepse Allahu e ka pranuar para se gjaku të derdhej në tokë. Tashmë, gëzohuni me gjithë zemër me kurbanet tuaja."

Allahu i Lartësuar e njofton Profetin (a.s.), se në disa net lutja nuk refuzohet. Katër net të begata, në të cilat hapen dyert e mëshirës, janë:

- 1- Nata e Fitër (Ramazan) Bajramit,
- 2- Nata e Kurban Bajramit,
- 3- Nata e Tervijes (nata e 8-të e muajit Dhu'l-Hixhe)
- 4- Nata e Arafatit (Isfehani)

Muaji në të cilin ndodhet Kurban Bajrami, quhet Dhu'l-Hixhe. Adhurimet që kryhen në dhjetë ditët e para të muajit Dhu'l-Hixhe janë shumë të rëndësishme.

Arife (Dita e Arafatit) është vetëm dita e 9-të e Dhu'l-Hixhes (vigilje, prag, dita para një feste). Dita tjetër nuk quhet Arife. Pas namazit të sabahut në Ditën e Arafatit, deri në namazin e ikindisë në ditën e katërt të Kurban Bajramit, të gjithë burra e gra, pasi të japin selam në namazet farz (të obliguara), qofshin me xhemat apo vetëm, para se të thonë: "Allahumme ente's-Selam...", duhet të thonë njëherë tekbirin e teshrikut, i cili është vaxhib, domethënë: Allahu ekber, Allahu ekber. La ilahe ilallahu Vallahu ekber, Allahu ekber ve lilahil-hamd!

Pasi të dalin nga xhamia ose pas bisedës, nuk nevojitet më të thonë tekbirin e teshrikut. (Halebi)



# HAXHI

## ibadeti plot urtësi

Dr. Durak Puszma

Allahu i Lartësuar i ka krijuar të gjithë njerëzit për ta njohur dhe për ta adhuruar Atë. Këtë e vërteton ky ajet fisnik: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Dharijat, 56) Njeriu e ka për detyrë ta adhurojë Allahun dhe t’i zbatojë urdhrat e Tij. Për këtë arsye, të gjitha ibadetet kryhen ngaqë janë urdhër i Allahut (xh.xh.). Edhe gjërat që janë haram, lihen ngaqë i ka ndaluar Allahu Teala. Në gjërat që ka urdhëruar dhe ndaluar Zoti (xh.sh.), patjetër që ka urtësi të pafundme. Allahu është i Urtë, çdo gjë e bën në vendin e vet dhe me urtësi. Allahu nuk bën asgjë rastësisht. Për një pjesë të këtyre urtësive, Allahu i Madhëruar na ka njoftuar dhe na i ka shpjeguar. Ndërsa, për një pjesë tjetër, jo. Disa prej këtyre mund t’i kuptojmë me mendje dhe meditim.

Si të gjitha ibadetet e tjera, edhe haxhi ka shumë urtësi dhe mirësi që i dimë apo nuk i dimë. Ata që kanë shkuar në haxh, i kanë përjetuar plot entuziazëm këto urtësi dhe mirësi.

Adhurimet, sidomos haxhi për të cilin po flasim, i zhvillon dhe i lartëson ndjenjat shpirtërore që gjenden në krijimin e njeriut. Kur haxhilerët bëjnë tavafin<sup>1</sup> rreth Qabesë, kur bëjnë “sajin”<sup>2</sup> ndërmjet Safës dhe Merves, kur qëndrojnë në Arafat e Muzdelife dhe kur vizitojnë Ravzatu’l-Mutahharan<sup>3</sup>, marrin një kënaqësi shpirtërore

1. Tavaf: Rrotullimi shtatë herë rreth Qabesë, duke filluar nga këndi ku ndodhet Haxheru’l-Esvedi.

2. Riti sa’j: Katër vajtjet dhe tri ardhjet që bëhen mes kodrave Safa dhe Merve gjatë ibadetit të haxhit ose umres.

3. Ravzatu’l-Mutahhara: Qoshku i Dllirë, vendi ku prehet trupi i të Dë - guarit të Allahut (a.s.).

të papërshkrueshme. Me këtë kënaqësi të papërshkrueshme që marrin, u forcohet besimi, ibadetet i kryejnë më me rregull dhe në mënyrën më të mirë, u zbukurohet morali, i lënë veset dhe zakonet e këqija, nëse kanë pasur në të kaluarën dhe bëhen më të sjellshëm e më të ndjeshëm ndaj familjes së tyre e ndaj të tjerëve. Siç thuhet edhe në Kuranin Fisnik, ata tashmë ushqehen me ushqimin e devotshmërisë. Në ajetin e njëqindentëdhjeteshtatë të sures Bakara, thuhet: **“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”**

Haxhiu i lë pas gjërat e shëmtuara, si mëkatet dhe zënkat me njerëzit, që është ushtruar duke i lënë përgjatë haxhit. Ai përpiqet të sillet me mirësi ndaj njerëzve. Është i vetëdijshëm se Allahu e di çdo mirësi që bëhet. Ismail Hakkë Bursevi ka thënë: “Njeriu ka dy udhëtime: Udhëtimi në këtë botë dhe udhëtimi nga kjo botë për në botën tjetër. Përgjatë udhëtimit që njeriu bën në këtë botë, duhet të marrë ushqime me vete. Këto janë ushqime për të ngrënë e për të pirë, mjet transporti dhe pasuri. Edhe përgjatë udhëtimit që do bëjë nga kjo botë për në botën tjetër, duhet të marrë me vete ushqim. Ushqimi që duhet të marrë në këtë udhëtim është marifetullah / njohja e Allahut Teala, muhabbetullah / dashuria ndaj Allahut (xh. xh.), largimi nga çdo gjë e kësaj bote, duke u preokupuar

me bindjen ndaj Allahut Teala dhe duke mos i kundërshtuar ndalesat e urdhrat e Tij. Ky është ushqimi më i mirë që udhëtari mund ta përgatisë në këtë botë, sepse ushqimi i kësaj bote të mbron nga vuajtja e përkohshme, ndërsa ushqimi i botës tjetër të mbron nga ndëshkimi i përhershëm. Ushqimi i kësaj bote është provizor, ndërsa ushqimi i botës tjetër është i përhershëm. Ai e shpie njeriun te kënaqësitë e papërshkrueshme. (Ruhu'l-Bejan, botimet Erkam, II, 253.)

Haxhi ka edhe aspektin e udhëtimit. Në aparencë duket si udhëtim, por haxhi nuk është një udhëtim turistik. Ai është një udhëtim për ibadet. Prandaj, që kur kandidati për haxhi del nga shtëpia, kryen haxhin dhe kthehet në vendin e tij, është në rrugë të Allahut Teala. Allahu i Madhëruar do t'ia japë shpërblimin për këtë. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ata që shkojnë për haxh dhe për umre në shtëpinë e Allahut, janë përfaqësuesit e myslimanëve në audiencën e Allahut. Nëse ata i luten Atij, Allahu ua pranon lutjet. Nëse i kërkojnë falje, Ai do t'i falë.”* (Ibn Maxhe, Menasik, 5.)

Nisur nga kjo, ne duhet të lutemi shumë dhe t'i kërkojmë Allahut falje përgjatë kryerjes së adhurimit të haxhit, në Mesxhidu'l-Haram, Arafat, Muzdelife, Mina, Mesxhidu'n-Nebevi dhe vende të tjera të shenjta si këto.

Adhurimi i haxhit ka sevapin e xhihadit (lufta në rrugën e Allahut). Nëna jonë, Aisheja (r.a.), e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.): *“O i Dërguari i Allahut, ne dimë që vepra më e virtytshme është xhihadi. Pse të mos bëjmë edhe ne gratë xhihad?”* Pejgamberi (a.s.), u përgjigj: *“Xhihadi më i mirë për ju është haxhi i pranuar.”* (Buhari, Haxh, 4.) Sepse gjatë haxhit, ashtu si edhe gjatë luftës, njeriu është larg familjes dhe të afërmve. Po ashtu, është në luftë me nefsin e tij dhe kalon shumë vështirësi.

Siç dihet, feja islame i jep rëndësi të madhe unitetit dhe bashkimit. Prandaj, urdhëron që myslimanët të kenë unitet dhe harmoni. Fakti që haxhi është në një sezon dhe ditë të njëjta, sjell me miliona myslimanë në Qabe, Arafat, Muzdelife dhe Mina nga vende e krahina të ndryshme të botës. Por ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë.

Fjala Arafat vjen nga rrënja marifet. Marifet do të thotë njohje. Haxhiu në Arafat njuh veten e tij, njuh Krijuesin e tij, njuh përgjegjësitë e tij. Përpiqet të njohë qëllimin e krijimit të tij dhe kuptimin e vakfës (qëndrimin në audiencën e Allahut Teala). Ai njihet me haxhilerët e tjerë, prezantohet me ta dhe bashkëpunon. Me fjalë të tjera, ai gjendet plotësisht në një proces kërkimi llogarie ndaj vetes, perceptimi, njohjeje dhe bashkëpunimi me të tjerët.

Qabeja është tempulli i parë që është ndërtuar për të adhuruar Allahun dhe kibra e të gjithë myslimanëve që simbolizon unitetin e tyre, sepse myslimanët i drejtohen Qabesë në faljen e pesë kohëve të namazit. Ndërsa haxhi është ibadeti që e realizon këtë bashkim.

Feja islame ka sjellë parimin e barazisë së të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh prejardhjen, racën apo ngjyrën. Ata që shkojnë në haxh, i heqin uniformat apo rrobat e zakonshme në vendet e quajtura “mikat” para se të hyjnë në Mekë dhe veshin një rrobë të përbërë prej dy copash të bardha, e cila quhet ihram. Kjo simbolizon vëllazërinë dhe barazinë ndërmjet tyre çfarëdo pozite që mund të kenë. Tashmë, aty është i barabartë shefi me nëpunësin, administruesi me të administruarin, i pasuri me të varfrin dhe i ziu me të bardhin. Feja islame thotë se njerëzit janë të barabartë tek Allahu Teala. Këtë e vërteton edhe me praktikë, sepse përgjatë haxhit askush nuk ka rroba që tregojnë pozitën, pasurinë apo varfërinë e tyre. Të gjithë veshin ihramin, i cili nuk është gjë tjetër përveçse dy copa të bardha.

Kjo veshje e bardhë, siç simbolizon barazinë e njerëzve përpara Allahut të Lartësuar, i kujton njeriut edhe qefnin, e bën të mendojë se jeta e kësaj bote është e përkohshme, se një ditë çdo njeri do ta shijojë vdekjen dhe se përveç atij qefni nuk do të marrë asgjë në ahiret, sado i pasur të jetë.

Haxhi, në të njëjtën kohë është edhe një aktivitet intelektual dhe kulturor. Aty haxhilerët takohen me njerëz që vijnë nga vende dhe krahina të ndryshme të botës, njihen me ta, i mësojnë njëri-tjetrit një pjesë prej zakoneve, traditave dhe kulturave të tyre. Ata përfitojnë në mënyrë reciproke nga njëri-tjetri, duke u njoftuar për mendimet, shkencat dhe kulturat e tyre.

Në ditën e Bajramit bëhet remju'l-xhimar, i cili në popull njihet si “gjuajtja me gurë e shejtanit” në Mina. Ky është simboli i reagimit dhe mallkimit ndaj dredhive dhe vesveseve djallëzore në këtë botë. Me të vërtetë, ato që gjuhen me gurë janë ndjenjat e mendimet e këqija dhe vesveset e hilet djallëzore të cilat gjenden brenda njeriut.

Pas mbarimit të këtyre ritualeve, theret kurbani për ta falënderuar Allahun Teala, i cili mundësoi të kryhet me sukses ky ibadet i vështirë dhe i mundimshëm. Kjo, nga njëra anë e mëson njeriun ta përballojë sakrificën materiale për hir të Allahut (xh.xh.), ndërsa nga ana tjetër zhvillon ndjenjat e ndihmës reciproke dhe solidaritetit ndërmjet njerëzve. Njeriun e shpëton nga egoizmi dhe e bën atë të shijojë ëmbëlsinë e të ndihmuarit të të varfërve dhe skamnorëve.

Krahas këtyre urtësive të haxhit, ka edhe shumë urtësi të tjera që nuk i kemi shkruar apo nuk i dimë. Sidoqoftë, ne nuk i bëjmë ibadetet dhe haxhin për shkak të këtyre urtësive e mirësive, por ngaqë ka urdhëruar Allahu i Lartësuar dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Poeti thotë:

Çfarëdo që të kërkojë Zoti, duhet ta kryejmë;

Ne jemi robër, nuk na takon të bëjmë pyetje.

Në Kuranin Fisnik, thuhet: **“Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.’**” (En'am, 162)



# Zemra e përkushtuar ndaj ibadeteve të natës

Ibrahim Koç

Nata mbart një përschirshmëri të veçantë me kohën e paraagimit që ka çdo herë. Prandaj, ibadetet e bëra në kohën e paraagimit janë të pranuar. Pjesa e artë e kohës është nata. Ndërsa zemra e natës është koha e paraagimit. Në Kuranin Fisnik, fjala natë përmendet 114 herë. Po ashtu, ai na njofton se edhe vetë ka filluar të zbresë në një natë të bekuar. Dyert e mëshirës hapen natën. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **“Kryeje namazin prej kthimit të diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në paraagim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt). Kaloje një pjesë të natës, si falje shitesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”** (Isra, 78-79)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na përgëzon duke na treguar se Allahu i Lartësuar zbret në qiellin e dynjasë në kohën e paraagimit dhe u përgjigjet lutjeve që bëhen në këtë kohë. Po ashtu, ka thënë: **“Ju sugjeroj të ngriheni natën (të falni namazin e tehexhudit), sepse ai është zakoni i të devotshmëve që kanë jetuar para jush dhe ju afron me Allahun. Ju mbron nga mëkatet, është falje për të këqijat dhe shpëtues nga sëmundjet fizike.”**

(Tirmidhi, Deavat, 112.) “Leximi i sures Tebareke çdo natë, ju shpëton nga ndëshkimi i varrit dhe ju mbron nga zjarri i xhehenemit.” Për lartësimin e shpirtit të njeriut, mund të thuhet se nuk ka asnjë vlerë që mund të zërë vendin e tehexhudit, i cili falet në kohën e paraagimit. “Veçanërisht namazet e natës që falen në moshë të re, janë si një rrugë e sigurt për t’i hapur shpirtit dyert e frymëzimit hyjnor, sepse namazi i natës është ibadeti që nuk e kapin dhe nuk i ngjiten aspak sëmundjet brejtëse dhe vrasëse.” “Dijeni mirë se nderi i besimtarit është në namazin e natës, ndërsa krenaria e tij është në moskërkimin nga të tjerët.” “Ditët janë të lidhura me botën e dukshme, ndërsa netët janë të lidhura me botën e gajbit.” (Ibn Arabi, Futuhat, 1, 395.)

Profesor Kamil Mirasi, i cili është prej yjeve të qiellit tonë të dijes dhe gnosës, thotë: “Ajetet dhe hadithet që transmetohen në lidhje me frymëzimin dhe begatinë që njerëzit nuk mund ta përshkruajnë dhe përkufizojnë, influencojnë te zemrat e pastra dhe besimtare. Çdo besimtar që i lexon dhe i mëson me sinqeritet e pastërti ato, e ka të pamundur që zemra e tij të mos ndikohet nga ky ibadeti i dashur. Çdo falës i namazit të natës,

që e ka zemrën e zgjuar dhe qëndron në audiencën e Allahut të Madhëruar në kohën e paraagimit, ndjen me plot gëzim zbritjen e frymëzimit hyjnor në zemrën e tij si një shi i butë vere, atë ditë e kalon i lumtur nga fillimi e deri në fund dhe përmallohet për tehexhudin e natës së ardhshme.” (Kamil Miras, Texhrid, vëll. 4, fq. 33.)

Tehexhudi është namazi që i ndriçon errësitat e botës së berzahut. Për këtë arsye, ata që dëshirojnë ta ndriçojnë jetën e berzahut, nuk duhet ta lënë këtë namaz, sepse drita që ndriçon varrin është namazi i natës. Të gjithë librat fetarë dhe veprat letrare flasin për frymëzimin e madh dhe qetësinë shpirtërore që nata dhe paraagimi u jep shpirttrave sublimë. Po ashtu, të gjithë e dimë se mistikët i japin shumë rëndësi gjallërimit të natës me ibadet. Erzurumlu Ismail Hakkë, Junus Emre, Mevlana dhe shumë sulltanë të tjerë shpirtërorë, shihet se i kanë dhënë shumë rëndësi natës dhe paraagimit. Faktikisht, të gjithë mistikët flasin për natën dhe paraagimin.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Natën ka një kohë të tillë që, nëse mysli manit i rastis të lutet në atë orë, çfarëdo që të kërkojë nga Allahu prej të mirave të kësaj bote dhe të ahiretit, Allahu do t’i japë patjetër atë që dëshiron. Kjo orë është çdo natë.”*

*“Dy rekatë namaz që biri i Ademit i fal në paraagim, janë më të mira për të se kjo botë dhe çfarë ka në të. Sikur ta dija se kjo nuk do ishte e vështirë për umetin Tim, do t’ua bëja farz.”*

*“Mos e kalo natën pa namaz, edhe nëse është sa koha e mjeljes së një deveje apo deleje. Edhe namazi që falet pas namazit të jacisë, është prej namazit të natës.”*

*“Dy rekatë namaz që falen në mes të natës, janë falje për mëkatet.”*

*“Epërsia e namazit të natës ndaj namazit të ditës, është si epërsia e sadakasë së dhënë fshehurazi ndaj sadakasë së dhënë haptazi.”*

Ata që nuk e vlerësojnë përfitimin nga begatia e natës, privohen edhe nga begatia e ditës, duke u ngritur në mëngjes të lodhur dhe të mekur. Nëse besimtari e shfrytëzon natën ashtu siç duhet dhe përfiton nga klima shpirtërore e dhikrit, nata e tij bëhet më e ndritshme se dita. Nata është koha më e volitshme për t’u lutur që të shpëtojmë nga ndëshkimi hyjnor. Sulejmanit i tha nëna e tij:

*“Biri im! Mos fli shumë natën, sepse gjumi i tepërt përgjatë natës e lë njeriun të varfër Ditën e Kiametit.”*

I Dërguari i Allahut (a.s.), falte namaz natën, derisa i plasariteshin këmbët dhe i enjteshin pulpat. Ai që ishte mbreti i dy botëve, njeriu më i dashur, sulltani i zemrave dhe i dashuri i Mëshiruesit. Nëna jonë, Aishja i tha:

*“O i Dërguari i Allahut! Allahu t’i ka falur të gjitha gabimet që ke bërë në të kaluarën dhe që mund të bësh në të ardhmen. Përse e lodh veten kaq shumë?” Pejgamberi (a.s.), i tha: “A të mos jem një rob që e falënderon Zotin për këtë?” Domethënë, nëse e lë tehexhudin, nuk mund të jem një rob falënderues.*

Lus Allahun të na bëjë prej fatlumëve që e lënë gjumin për në varr dhe rehatinë për në xhenet! Amin!

# Receta kuranore ndaj fobive tona

A. Jasin Demirxhi

## La Tahzen - Mos u zemëro!

Lumturia e vërtetë është e fshehur në përmbushjen e përgjegjësiave tona, në fillim kundrejt Allahut të Plotfuqishëm, pastaj kundrejt krijesave të Tij.

Ne jetojmë me një numër të ndryshëm frikërash, të cilat vijnë nga krijimi ynë. Njanjëherë mbizotërojnë më pak e njanjëherë më shumë dhe me kalimin e kohës bëhen të shumëllojshme. Frika për të ardhmen, frika për jetesë, papunësia, sëmundja, frika për humbjen e të afërmeve tanë etj. ... Listën mund ta zgjerojmë edhe më tej.

Fobitë e atyre që sillen me moskokëçarje në aspektin e përmbushjes së kërkesave të Islamit dhe të atyre që jetojnë larg jetës shpirtërore, bëhen të shumëllojshme. Janë të detyruar të përballojnë një mal me shqetësime fizike e shpirtërore, për t'u shmangur nga këto fobi që e kthejnë jetën shoqërore në makth dhe shndërrohen në sëmundje. Derdhen një shumë e konsiderueshme parash për kurimin e shendetit mendor pastaj...

Psikiatrët dhe specialistët e zhvillimit personal theksojnë se mënyra më efektive në luftën kundër frikës është qëndrimi me rezistencë ndaj saj. Në Kuranin e Madhërishtë, pasi përmendet si informacion, për frikën theksohet se: **"... për besimtarët, në Ahiret (botën tjetër) nuk do të ketë as frikë dhe as pikëllim..."** ose **"për ata që besuan dhe bënë vepra të mira nuk do të ketë asnjë frikë..."**, ndërsa nga ana tjetër, le të shikojmë se çfarë na këshillon për t'u zhveshur nga fobitë tona.

Në vend që të formojmë fjali të stërzgjatura mbi këtë temë, mund ta formulojmë në këtë mënyrë recetën e Kuranit për heqjen e frikës:

Heqja e frikës mund të realizohet ashtu siç kanë sugjeruar ekspertët e zhvillimit personal, por duhet të rezistosh ndaj saj me **"Frikë ndaj Allahut"**.

Të mos harrojmë se Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe i çdokujt që e frikëson njeriun. Ai i jep forcë dhe fuqi çdo qenieje të gjallë në univers. Të gjithë dhe çdo gjë janë të pafuqishëm para Allahut të Lartësuar. Kanë nevojë për Të...

E ardhmja është në duart e Tij... Ai është pronari i vërtetë, që ka pushtet mbi çdo gjë. Si çdo gjë edhe e ardhmja jote është në duart e Tij. Askush nuk mund të lëndojë askënd, për aq kohë sa Ai nuk e lejon këtë... Ti do të jetosh aq kohë sa është përcaktuar për ty. Asnjë sekondë më shumë e as më pak... Asgjë tjetër përveç asaj që ka shkruar Allahu nuk do të ndodhë... Ai është Furnizuesi. Askush nuk mund ta pengojë furnizimin tënd, përderisa të mos e dëshirojë Allahu i Lartësuar, i cili është Rezzaku-Furnizuesi...

Me pak fjalë, një besimtar me iman i frikësohet vetëm Allahut. Kur lufton kundër fobive të veta, ai mendon fuqinë dhe pushtetin e Allahut të Madhërishtë. Madhësitinë e Tij e krahason me fobitë me të cilat përballlet. Në fund të fundit, kupton lehtë faktin se asnjë fuqi nuk mund t'i përballlet fuqisë dhe pushtetit të Tij. Ky koncept e bën njeriun shumë më të fuqishëm në luftën kundër fobive të tij.

Le ta përfundojmë artikullin me ajetet që këshillojnë të mos kihet frikë nga askush tjetër përveç Allahut dhe si rezultat i kësaj jep një fund premtues në këtë botë dhe në botën tjetër:

**"Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S'ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore."** (Junus, 62-64)

# Ndërtimi i Shtëpisë së Allahut

Allahu Teala thotë: **“Kujtoje kur Ne vendosëm për Ibrahimin vendin e Faltores (duke e urdhëruar): ‘Mos më shoqëro asgjë (në adhurim) dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur.”** (Haxh, 26)

Sipas Ebu’s-Suud Efendiut, ndërtimi i Qabesë nga Ibrahim, alejhi’s-selam, ka qenë ndërtimi i dytë i saj. Për herë të parë e ka ndërtuar Ademi, alejhi’s-selam. Pastaj, ajo humbi në kataklizmën e Nuhut (a.s.). Për së dyti, e ndërtoi Ibrahim, alejhi’s-selam. Për së treti është ndërtuar nga kurejshët në kohën e injorancës para se të shfaqej Islami. Pra, ajo u ndërtua para se i Dërguari i Allahut, (a.s.), të dërgohej me profetësinë. Për herë të katërt e ka ndërtuar Abdullah b. Zubejri. Për herë të pestë e ka ndërtuar Haxhxhaxhi tiran.

Sipas hadithit që përmendet në Zubdetu’l-Buhari, xhamia e parë që është ndërtuar në sipërfaqen e tokës është Kabetu’l-Muadhame. Kjo faltore është ndërtuar dhe riparuar njëmbëdhjetë herë: 1. Së pari engjëjt e nderuar ndërtuan një ndërtesë prej drite. 2. Ademi (a.s.). 3. Shiti (a.s.). 4. Ibrahim (a.s.). 5. Amalika-sit. 6. Fisi Xhurhum. 7. Kusaj. 8. Kurejsh. 9. Abdullah b. Zubejr. 10. Haxhxhaxhi tiran. 11. Çliruesi i Bagdadit Sulltan Murati i IV.

Sipas Fahrudin Razit dhe Nimetullah Efendiut, Allahu i Madhëruar ia tregoi Ibrahimit, alejhi’s-selam, vendin e Qabesë me anë të shpalljes, ngaqë ndërtesa e parë ishte zhdukur nga kataklizma. Ibn Abbasi, radijallahu anhu, transmeton: “Pasi Ibrahim, alejhi’s-selam, u martua me Haxheren dhe u lindi Ismaili, i mori

të dy bashkë dhe shkuan nga Shami në Mekë për t’u mbrojtur nga mësymjet e Sarës. Pastaj, Haxheren dhe Ismailin i la pranë një peme të madhe në një vend të lartë, ku sot gjendet Mesxhidu’l-Harami dhe në anën e sipërme të burimit të Zemzemit.

Në atë kohë, në Mekë nuk banonte asnjë njeri. Madje nuk kishte as ujë për të pirë. Ibrahim, alejhi’s-selam, i la aty nënë e bir. Atyre u la një torbë të mbushur plot me hurma dhe një enë prej lëkure të mbushur me ujë. Pastaj Ibrahim, alejhi’s-selam, u kthye për të shkuar në Sham. Nëna e Ismailit, Haxherja e ndoqi atë nga pas dhe i tha: “O Ibrahim! Ku po shkon, që po na lë në këtë luginë? Këtu nuk paska asnjë njeri dhe asnjë gjurmë jete. Edhe pse Haxherja i përsëriste këto fjalë, Ibrahim (a.s.), nuk kthehej dhe nuk e shikonte. Haxherja e pyeti: “Allahu të ka urdhëruar të na lësh këtu?” Ibrahim (a.s.), iu përgjigj: “Po, Allahu më ka urdhëruar.” Haxherja i tha: “Atëherë Allahu na ruan, na mbron, nuk na lë vetëm dhe nuk na humb ne.” Pastaj u kthye te vendi i Qabesë. Ndërsa Ibrahim, alejhi’s-selam, u largua. Kur arriti në një vend të quajtur Senijje mbi Mekë dhe nga i cili nuk dallohej, e ktheu fytyrën nga Qabeja, i ngriti duart dhe u lut:

**“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pardshtësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndijejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.”** (Ibrahim, 37)

(Mahmud Sami Ramazanogllu, Ibrahim, fq. 111-115.)



# Çfarë presin të

Salih Zeki Meriç

Në kohën e fëmijërisë sonë, mosha tridhjetë-dyzet vjeç na dukej shumë e madhe, saqë përbrenda ndjenim sikur nuk do të venim kurrë në atë moshë. Vitet zmadhoheshin para syve tanë, bëheshin si një masë kohore e pashterueshme. E ndjenim veten të sigurt, sikur kishte një jetë pafund në limanin e sigurt të atyre viteve të mëdha që dukeshin sikur nuk do të shteroheshin. Madje, kur vinte mosha tridhjetë-dyzet vjeç, këtë herë, mosha gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë vjeç i duket njeriut si një moshë e paarritshme ndonjëherë.

Kjo ndjenjë që formohet tek fëmijët, vazhdon të jetë edhe në vitet e rinisë. Kur kthehet pas dhe shikon mbrapa, pas martesës dhe bërjes së fëmijëve, vihet re se kanë kaluar vitet më të çmuara dhe ndjenjat që nuk kalojnë më tej nga e shkuara, ia lënë vendin ndjenjave më reale.

Kur klasifikojmë jetën njerëzore, mund ta ndajmë atë në fëmijëri, rini, pjekuri dhe pleqëri. Pleqëria, që është brenda këtyre etapave, është periudha më e vështirë që përjeton njeriu në jetën e tij. Është një pjesë kohe, në të cilën njeriu bëhet delikat, bëhet i pafuqishëm dhe i nevojshëm për përkujdesje, si nga aspekti fizik, ashtu edhe nga aspekti sentimental.

Me kalimin e viteve, njeriu e frikëson ndjenja e passhmangshme se po i afrohet një fundi. Ndjenja e mosnjohjes së rrjedhjes së jetës si uji ose dobësia e viteve të shkuara. Nuk mund të bëhen llogaritë për të ardhmen, ndërkohë që ke mall gjithmonë për të kaluarën. Por ekziston një realitet i pandryshueshëm e ai është se njeriu nuk i reziston dot kohës dhe plaket. Periudha e pleqërisë, nga njëra anë është periudha e shterimit të shpresave për të jetuar, ndërsa nga ana tjetër është periudha e shfaqjes së pishmanllëkut për të shkuarën. Njeriu është në gjendje shpirtërore, që pothuajse bëhet si fëmijë zemërak. Pa dyshim që është e vështirë t'i shpjegosh një të riu si është psikologjia e plakjes.

Sado të plakët njeriu, po aq e vështirë bëhet përshatja e tij me pleqërinë. Pa marrë parasysh se në çfarë moshe është njeriu, përsëri mendohet se ajo moshë është herët për vdekjen. Megjithatë, vdekja nuk shikon as moshë, as individ. Nuk ka diskriminim në literaturën e vdekjes. Kujt i skadon koha, vjen dhe e merr. Më e rëndësishmja nuk është se në ç'kohë do të vdesim, por si do ta presim vdekjen që vjen papritur



# Ë moshuarit tanë prej rinisë?

dhe në ç'mënyrë jemi përgatitur për të.

*Cilido që është në jetë, një ditë, herët apo vonë, do ta përjetojë këtë ndjenjë të pleqërisë. Para se të vijmë në këtë gjendje, ne duhet të mendojmë rreth pyetjes se çfarë presin nga ne njerëzit që janë në moshën e pleqërisë ose si duhet të sillemi kundrejt tyre.*

Kur ta vendosim veten tonë në vend të tyre, mund të japim përgjigje më të sakta të këtyre pyetjeve.

*Para së gjithash, ne duhet t'ua ndejmë të moshuarve se ata gëzojnë një pozitë të respektueshme në shoqëri.*

*Ne duhet të mos ua bëjmë të moshuarve të ndjejnë mangësitë fizike dhe shpirtërore që burojnë nga pleqëria e tyre dhe t'i nxisim ta kuptojnë se gjithmonë janë të vlerësuar.*

*Duhet të përkujdesemi për çdo njeri të moshuar, me të cilin përballemi në shoqëri, ashtu siç kujdesemi për të afërmit tanë, prindërit tanë; po në atë masë duhet ta tregojmë respektin, dashurinë dhe dhembshurinë tonë për ta.*

Gjendja me të cilën përballen më shumë njerëzit e moshuar është vetmia dhe izolimi i tyre nga shoqëria. Një njeri të moshuar, i cili është në brendësi të kësaj ndjenje, tashmë e pushton një ndjenjë se nuk vlen më për asgjë në jetën ku jeton.

*Njerëzit përreth tij duhet ta vënë re këtë gjë, të pak-tën duhet t'i përfshijnë ata në mjedise sociale dhe të mos u japin ndjenjën e vetmisë.*

*Njerëzit e moshuar duhet të jenë pasqyrë për të tjerët. Kur të shikojmë ata, pothuajse duhet të shikojmë të ardhmen tonë. Të mbartësh ndjenjën se një ditë do të plakemi edhe ne, do të na shtojë ndjeshmërinë tonë ndaj të tjerëve.*

*Megjithëse janë të dobët fizikisht, të moshuarit janë njerëzit që kanë arritur nivelin më të lartë në aspektin e përvojës së jetës. Prandaj, secili nga ata duhet të bartë vlera të veçanta për ne.*

*Ata duhet të jenë njerëz, prej të cilëve duhet të përfitojmë dhe të marrim opinionin e tyre. Në këtë mënyrë edhe i rregullojmë ata edhe përfitojmë nga eksperiencia e tyre.*

Me pak fjalë, vitet e rinisë, kur jemi të fuqishëm dhe vlerën e të cilave nuk e njohim, një ditë do t'ia lënë vendin pleqërisë pas stinës së vjeshtës. Ndërkohë që jetojmë pranverën e jetës sonë, nuk duhet të harrojmë se kjo pranverë do të jetë pranvera e fundit, madje edhe dimri i fundit. Për të korrur atë që kemi mbjellë, nuk është e nevojshme të presim të nesërmen, rinia e sotme është pleqëria e së nesërmes. Çfarë kemi mbjellë sot, atë do të korrin në sezonin e vjeljes.





Kur vjen  
Ndihma **DHE DËNIMI**  
i Allahut!?

Ilir Hoxha

Jetojmë në një kohë kur “e keqja” është bërë zot në pronën e Zotit dhe “e mira” urrëhet vetëm sepse është ajo që është... Në këtë kohë, “të fortët” janë tërbuar me fuqinë që u ka dhënë Allahu, ndërsa “të dobët” kanë rënë në pesimizëm, për shkak të sprovave me të cilat i ka mbuluar Ai. Të fortët mendojnë se s’kanë për t’u zhdukur kurrë, të dobët qahen, edhe deri kur?

Gjithçka që ndodh, e vogël apo e madhe, e fshehtë apo e hapur, është në dijen e plotë të Allahut: **“...Vërtet, Allahu dëgjon dhe sheh çdo gjë!”** (Gafir, 20) Nisur nga kjo, njerëzit “e dobët”, pyesin pa dashje -qoftë edhe me vete- “po a s’i sheh Allahu gjithë këto vuajtje, gjithë këto krime, gjithë këto padrejtësi? Ne po lutemi e po përgjërohemi natë e ditë. A nuk i dëgjon Allahu lutjet tona?”.

Në fakt, e gjithë kjo është diçka e natyrshme për njerëzit në përgjithësi. Por për një besimtar që e lexon vazhdimisht Fjalën e Allahut, duke e kuptuar atë, përgjigja e kësaj duhet të jetë më se e thjeshtë. Pikësepari, ai kujton fjalën e Allahut, kur Ai urdhëron: **“Po të mos ishin mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj jush, si dhe fakti se Ai është Pranues i pendimit e i Urtë (Ai do ta dënonte fajtorin!)”** (Nur, 10)

Ky mesazh i Allahut e bën besimtarin e vetëdijshëm, të kuptojë, se pavarësisht dhimbjes dhe hidhërimit që ndjen ndaj padrejtësive dhe të këqijave që bëhen, asnjë krijesë nuk mund të jetë më e mëshirshme se Krijuesi i tyre. Kur Pejgamberi (a.s.), pa një nënë e cila kishte humbur fëmijën e saj dhe çdo fëmijë që shihte e merrte në gjij për ta ushqyer, i pyet shokët e vet: **“A mendoni se kjo nënë do ta hidhte në zjarr fëmijën e saj?”** “Jo!” - i thanë

shokët... Atëherë Pejgamberi (a.s.), tha: "Vallahi, Allahu është më i mëshirshëm ndaj robërve të Tij sesa kjo grua ndaj fëmijës së saj." (Buhari 5999; Muslim, 2754.)

Si Krijuesi i gjithçkaje, Allahu dëshiron të mos i dënojë krijesat e Tij e veçanërisht njeriun. Prandaj, me Urtësinë e Tij, ai i jep afat atij për t'u kthyer e për t'u penduar tek Ai.

Këto dhe argumente të tjera në lidhje me mëshirën e Allahut, e forcojnë besimtarin dhe e largojnë atë nga çdo dyshim në lidhje me dashurinë dhe mëshirën e Allahut ndaj robërve të Tij. E megjithatë, shejtani i pëshpërit vazhdimisht njeriut; "e kur pra do të vijë ndihma e Zotit tënd!" Kjo këmbëngulje e shejtanit për të na futur në dyshime ndaj Allahut, nuk është për t'u çuditur, sepse ai kështu ka vepruar me të gjithë besimtarët gjatë gjithë historisë njerëzore. Por Allahu, i Cili nje çdo damar të ligësisë së shejtanit, na e qartëson edhe këtë pëshpëritje dyshimi: "**Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: 'Kur do të arrijë ndihma e Allahut?' Ja, ndihma e Allahut është afër!**" (Bekare, 214)

Vërtet, Fjala e Allahut të Madhëruar, Kurani, është i kuptueshëm dhe i qartë për ata që mendojnë, sepse; "**... Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë radhitur mrekullueshëm dhe janë parashtruar me hollësi nga ana e Një të Urti të Gjithëdijshëm.**" (Hud, 1)

E megjithatë, njeriu është një qenie e padurueshme, që e ka frikë të panjohurën, prandaj ai kërkon me ngulm të gjejë një dritare për ta njohur të ardhmen pa i ardhur koha. Mirëpo, ndryshe nga njerëzit e shkujdesur e të paditur, që mundohen ta shohin të ardhmen përmes fundit të ndonjë filxhani apo ndonjë marifeti tjetër të shejtanit, besimtari i vetëdijshëm mundohet të gjejë një dritare për të kuptuar urtësinë e planeve të Allahut dhe mënyrën e veprimit të Allahut, duke u bazuar në Fjalën dhe Atributet e Tij Madhështore.

Mbase, për birin e njeriut, në këtë botë nuk do të ketë ndonjë ditë rehatie me kuptimin e plotë të fjalës, sepse e keqja nuk mund të zhduket plotësisht. Por, pavarësisht se e keqja do të vazhdojë të ekzistojë deri në Ditën e Kiametit, myslimani i vërtetë, dëshiron dhe përpiqet me të gjitha forcat që në këtë botë të mbizotërojë e mira. Pra, ai e ka të qartë se kjo botë ka një

polarizim apo një dualizëm jetik siç është "e mira" dhe "e keqja". Dhe pikërisht për këtë arsye, sido që të ndodhë, besimtari i vetëdijshëm, zgjedh vetëm njërin nga polet, pra polin e së mirës dhe nuk guxon të kalojë nga poli i së keqes për asnjë arsye. Madje nuk i lejohet të qëndrojë as në mes, sepse në fakt -përkundër iluzioneve ngjyrë gri-, nuk ekziston një pikë e mesme midis së keqes dhe së mirës. Ose je në anën e së mirës, ose në anën e së keqes!..

Në këtë pikë mund ta bëjmë më lehtë lidhjen e kësaj teme dhe t'i japim përgjigje pyetjes se: "Kur vjen ndihma dhe dënimi i Allahut?"

Po t'u hedhim një sy historive të popujve që Allahu i ka shkatërruar dhe i ka përmendur në Kuran, për të marrë mësim njerëzit me mendje të shëndoshë, do të vërejmë se të gjithë kanë disa gjëra të përbashkëta që në vija të përgjithshme mund të përmblihen në këto pika:

- Kalimi i kufijve në shturje,
  - Ftesa e pejgamberëve/paralajmërimi,
  - Qartësimi i anëve/palëve; kush me kë është,
  - Shpëtimi i të mirëve dhe shkatërimi i të këqinjve.
- Të gjitha këto pika përbëjnë një proces relativisht të gjatë për qeniet e burgosura në kohë, siç janë njerëzit, por jo për Allahun e Madhëruar, i Cili nuk ndikohet nga koha. Ja se si na e qartëson Allahu këtë çështje me shembuj gozhdues për kriminelët dhe shpresëdhënës për të shtypurit:

**"Ata e quajtën gënjeshtar Nuhun. Kështu që Ne shpëtuam me anë të barkës atë dhe të gjithë njerëzit që ishin me të, ndërsa ata që i mohuan shpalljet Tona, i fundosëm. Ata qenë vërtet një popull i verbër."** (Araf, 64)

**"Me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuam Hudin dhe të gjithë besimtarët që ishin me të dhe i asgjësua ata që i mohuan shpalljet Tona. Ata ishin të gjithë jobesimtarë."** (Araf, 72)

**"E, kur erdhi urdhri Ynë, Ne - me mëshirën Tonë, e shpëtuam Salihun bashkë me besimtarët e tij nga poshtërimi i asaj dite. Me të vërtetë, Zoti yt është i Forti dhe i Plotfuqishmi. Kurse ata që bënë të këqija, i kaploi një zë i tmerrshëm dhe u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm në shtëpitë e tyre."** (Hud, 66)

**"Përgjigja e popullit të tij (Lutit) ishte: "Dëbojini ata nga vendi juaj! Ata janë njerëz që duan të jenë të pastër." Kështu, Ne e shpëtuam atë me gjithë famil-**

Mbase,  
për birin e njeriut,  
në këtë botë nuk do të ketë  
ndonjë ditë rehatie me kuptimin  
e plotë të fjalës, sepse e keqja nuk mund  
të zhduket plotësisht. Por, pavarësisht  
se e keqja do të vazhdojë të ekzistojë  
deri në Ditën e Kiametit, myslimani i  
vërtetë, dëshiron dhe përpiqet  
me të gjitha forcat që në këtë  
botë të mbizotërojë  
e mira.

**je, përveç gruas së tij. Ajo ishte nga ata që mbetën pas (dhe u ndëshkuan). Dhe mbi ta lëshuam rrebesh (gurësh)...”** (Araf, 82-84)

Këta shembuj mjaftojnë për të kuptuar faktin se pasi janë formuar polet dhe janë bërë të qarta anët, ka ardhur edhe ndihma e Allahut së bashku me dënimin e Tij. Kështu ka ndodhur gjithmonë; ky është ligji i Allahut, sepse Allahu është i Drejtë, nuk bën padrejtësi, nuk dënon askënd pa ia bërë të qarta çështjet; Ai është i Durueshëm dhe i Urtë, nuk nxiton në dënim dhe u jep afat mohuesve; Ai është Besnik e Kujdestar dhe nuk e lë robin e Tij në baltë...

Nëse gjendjen aktuale të botës dhe kohës ku jetojmë, e shohim nën dritën e këtyre fakteve të qarta, do ta kuptojmë lehtë se në çfarë distance është ndihma apo shkatërimi i Allahut.

Sot, mund të pohojmë pa asnjë mëdyshje, se pika e parë, pra “Kalimi i kufijve në shturje”, tashmë është plotësuar me kohë. E mira ka kohë që nuk mbizotëron më dhe ajo tashmë është e diskriminuar, e shtyrë, e përjashtuar, e tallur dhe e për-buzur në pjesën më të madhe të shoqërisë. Ndërsa, për sa i përket pikës së dytë, “ftesa e pejgamberëve/ paralajmërimi”, është një pikë e cila ka 14 shekuj e 3 dekada që është plotësuar. Muhamedi (a.s.), është i Dërguari i fundit i Allahut për të gjithë njerëzimin, deri në Ditën e Kiametit. Ai **“...është i Dërguari i Allahut dhe vula e pejgamberëve...”** (Ahzab, 40) Allahu ia ngarkoi misionin dhe i tha: **“Ne të kemi dërguar ty vetëm si përgëzues dhe paralajmëruer.”** (Furkan, 36)

Tashmë, gjendemi në fazën e tretë, në “qartësimin e anëve/palëve”. Shekulli i ri në të cilin kemi pothuajse 15 vjet që kemi hyrë, ka diktuar edhe një formim më të shpejtë të poleve, ku shohim shumë koalicione, bashkime, bashkëpunime qoftë politike, gjeografike, ushtarake apo edhe ekonomike. Nga të gjitha këto koalicione, më i fuqishmi dhe më efikas, është koalicioni i së keqes (i kaosit social, luftës dhe manipulimit ekonomik). Ndërsa koalicionet e tjera janë shumë të dobëta dhe kanë një ndikim të kufizuar vetëm në fushën shoqërore dhe pak në atë ekonomike. Shumica e tyre shpërbëhen shpejt ose detyrohen t’u bashkëngjiten të fortëve. E megjithatë, një pjesë e atyre që kanë arritur të mbijetojnë në anën e së mirës, vazhdojnë të luftojnë përkundër vështirësive dhe vuajtjeve që po heqin.

Gjatë vitit që lamë pas, në 2013-tën, ranë pothuajse të gjitha maskat dhe tabloja bipolare është bërë më e qartë se kurrë. Pra, besoj se sot nuk ka njeri që ka dy sy,

dy veshë dhe mendje të shëndoshë, që të mos kuptojë se për çfarë koalicionesh bëhet fjalë dhe me kë e kundër kujt po punojnë. Nuk besoj se ka ndonjë njeri që e dëshmon këtë kohë dhe nuk e kupton se ai që luftohet sot është vetëm Islami dhe myslimanët.

Pothuajse nga të gjitha fetë dominuese, si të krishterët, hebrejtë, budistët, hinduistët etj., janë turrur si egërsira dhe po vrasin, po masakrojnë, po robërojnë, po dëbojnë nga vendet e tyre dhe po torturojnë vetëm popujt myslimanë. Në cilindo vend të botës që ka luftë, të shtypurit, të vrarët e të dëbuarit janë vetëm myslimanët. Madje, sikur të mos mjaftonin këto, e gjithë bota është vënë në gjuetinë e tyre nën petkun e luftës “kundër terrorizmit”. A ka evidencë më të qartë se ky polarizim i njerëzimit? Në njërin anë, pjesa dërrmuese e feve dhe pjesëtarëve të tyre, në anën tjetër popujt myslimanë, të cilët kanë një shekull që kanë humbur fuqinë e lavdinë. Por ekziston edhe një pjesë e njerëzimit që janë jashtë çdo koncepti gjeografik e kohor. Kjo pjesë është e fjetur, e anestezuar, e mashtruar dhe e shtypur aq ëmbël, sa nuk e ndjejnë skllavërinë. Një pjesë e mirë e këtyre janë myslimanë që ende nuk dinë se ku janë ose që luftojnë për interesa të ngushta të një grupi e ideologjie dhe nuk përpiqen të shohin më larg se shehu, hoxha apo lideri i tyre.

Faza në të cilën gjendemi, mbase është edhe më e vështira, sepse këtu gjenden sprovat më të mëdha. Këtu rrihet hekuri në zjarr dhe merr formën që duhet të marrë. Këtu do të marrë jetë Fjala e Allahut; **“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë? Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu t’i dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë.”** (Ankebut, 2-3)

E gjithë çështja, është të pozicionohemi në anën e së mirës në mënyrë të vetëdijshme dhe të hapur, me qëllim që edhe më të dobët të marrin zemër e të shfaqen. Po ashtu, duhet të jemi të vendosur e të qëndrueshëm; jo të lëkundur, sepse lëkundjet të hutojnë dhe të hedhin në fushën gravitacionale të së keqes. E pasi të jenë bërë të qarta të dyja palët, pasi të jenë rreshtuar të gjithë në palën e vet, atëherë pritë ndihma e Allahut për besimtarët e drejtë dhe dënimin e Tij për mohuesit dhe dyfytirëshit. Në këtë pikë, besimtarëve u vjen në ndihmë garancia e Allahut, i Cili urdhëron: **“Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e shejtanit; në të vërtetë, pala e shejtanit është e humbur.”** (Muxhadile, 19)



# KUSH E ANULOI AJETIN?

Nëse përhapet pazotësia në mendim dhe parregullsia në gjykim, atëherë në mendje asgjë nuk është më e saktë.

Një njeri ishte ulur dhe po u komentonte Kuranin njerëzve, ku thoshte se ajeti 190 i sures Bekare: **“Luftoni në rrugën e Allahut, ata të cilët ju luftojnë dhe mos mësyni. Me të vërtetë, Allahu nuk i do mësymësit”** është i anuluar. Sahabët (r.a.), e kanë vërtetuar këtë anulim me mësymjen e tyre ndaj romakëve dhe persianëve, duke e shoqëruar thënien e tij me ajetin: **“Luftoni ata të cilët kufizohen me ju prej jobsimitarëve dhe le të gjejnë tek ju ashpërsi ...”** (Teube, 123)

Kjo injorancë më ngacmoi dhe i thashë komentuesit gabimtar: “Kush të ka thënë se romakët dhe persianët nuk kanë sulmuar arabët dhe myslimanët?”

Nëse rusët pushtojnë Afganistanin dhe aty instalojnë pushtetin e tyre, pastaj afganët fillojnë të rezistojnë duke sulmuar, a konsiderohen mësymës të fajësuar?

Nëse hebrenjtë pushtojnë Palestinën dhe arabët fillojnë të kundërshtojnë pushtimin e të shporrin dhunën, a konsiderohen sulmues të fajësuar?

Romakët erdhën nga Evropa dhe pushtuan Sirinë, Libanin, Jordaninë dhe Palestinën. Zbarkuan mësymës në Tebuk dhe Mu'teh në tokën e gadishullit! Nëse myslimanët fillojnë t'i shporrin nga Shami, Egjipti dhe mbarë vendet e tjera, të cilat janë pushtuar prej tyre, a konsiderohen myslimanët mësymës dhe u thuhet se ajeti i ndalimit të mësymjes është i anuluar?

Kjo është marrëzi e pastër dhe një të marri, që është i pazoti të shohë realitetin nuk i lejohet të komentojë Kuranin dhe të përpiqet të dëmtojë kuptimet e tij.

Ju me këtë lloj komentimi, i cili anulon çfarë jeni të pazotë ta kuptoni, lejoni politikën e plaçkitjes në rrugë dhe terrorizimin e të pafajshmëve.

Lufta me romakët ka qenë më e drejta luftë, që ka ndodhur mbi sipërfaqen e tokës dhe në kohën tonë, asaj i ngjet lufta ndaj sionizmit dhe kolonizmit, derisa toka t'u kthehet të zotëve të tyre dhe këto zullume të marrin fund.

Si pretendon dikush se ajeti **“Luftoni në rrugën e Allahut, ata të cilët ju luftojnë dhe mos mësyni. Me të vërtetë Allahu nuk i do mësymësit”**, është ajet i anuluar?

A është kthyer Allahu i dashur me mësymësit, pasi ka qenë më përpara urryes i tyre?

Ose, si mund të vijë dikush me hanxhar e me të t'i bjerë ajetit dhe ta ndajë në dysh, të zhdukë njëren pjesë dhe të mbajë tjetrën?

Këto mendje të sëmura duhet të shporren prej fikhut (kuptimit) të Kuranit dhe Sunetit e të mos ua prishin njerëzve fenë e tyre.

Atë që thamë për ajetin e mësipërm, e themi edhe për ajetin tjetër: **“Nuk ka detyrim (imponim) në fe. Është qartësuar udhëzimi prej humbjes”**. (Bekare, 256) Disa jonormalë kanë thënë se ajeti është i anuluar. Ata, me këtë lloj kuptimi kanë devijuar nga e vërteta (e sakta), sepse nuk ka ndodhur kurrë në jetën e Pejgamberit (a.s.) dhe të shokëve të tij, të jetë detyruar dikush të hyjë në Islam. Bile, detyrimi në fe është i papranueshëm që nga koha e Nuhut (a.s.) dhe deri në kohën e Muhamedit (a.s.).

Nuhu (a.s.), i tha popullit të tij: **“Çfarë mendoni ju, nëse unë jam në të vërtetën prej Zotit tim, më ka dhënë mëshirë prej Tij, dhe ju jeni të verbuar, a do t'ju detyrojmë në të, ndërkohë që ju jeni refuzues të saj?”** (Hud, 28)

Pastaj, iu tha Muhamedit (a.s.), pas kësaj me dhjetëra shekuj: **“Sikur të kishte dashur Zoti yt, nuk ka dyshim se të gjithë njerëzit në tokë, pa përjashtim do të kishin besuar. A ti do t'i detyrosh njerëzit, në mënyrë që ata të jenë besimtarë?”** (Junus, 99)

Të gjithë profetët e Allahut e refuzojnë imponimin dhe pranojnë vetëm bindjen e lirë. Prandaj, si i lejohet një mendjeje të prishur ta komentojë Kuranin sipas epshit të tij dhe ta cilësojë ajetin e qartë (muhkem) se ai është i anuluar?

Në këto ditë po më shqetësojnë dy gjëra, njerëzit që nuk arrijnë të kuptojnë një vepër tokësore të një njeriu të zakonshëm, pastaj vijnë me pazotësinë e tyre tek Libri i Allahut, që të ngatërrojnë të vërtetën me të kotën!

Nuk ka dyshim se feja e Allahut është më e dëlirë se sa të merret prej gojëve të budallenjve.

Përktheu nga arabishtja:  
Lavdrim Hamja

# Shifa binti Abdullah (r.a.)

## Mustafa Erish

Shifa binti Abdullah, radijallahu anha, ishte një zonjë sahabe, e cila u nderua me Islamin në Mekë, para hixhretit... Asaj i pëlqente t'u shërbente njerëzve edhe në periudhën e injorancës, ishte e mençur, e zgjuar dhe virtuoze... Ishte një zonjë që mjekonte disa sëmundje me mjete të ndryshme, ajo vazhdimisht ishte burim shërimi...

Ajo ishte nga Meka dhe u përkiste adijve prej fisit Kurejsh. Babai i saj ishte Abdullah ibn Abdu'sh-Shems, ndërsa nëna ishte Fatima binti Vehb bin Amr. Që në vitet e para të Islamit, i dha besën të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe u nderua me Islam.

Ajo u martua me Ebu Hajseme ibn Hudhejfen. Nga kjo martesë i lindën dy djem, që quheshin Sulejman dhe Merzuk. Asaj ia vendosën nofkën "Ummu Sulejman-Nëna e Sulejmanit", sepse djali i parë e kishte emrin Sulejman.

Edhe kur shumë pak njerëz, mes arabëve, dinin shkrim e këndim, ajo arrinte të shkruante në arabisht. E donte shumë edhe shërbimin fetar. Ishte një grua që kishte intuitë të mprehtë.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi për vizitë te shtëpia e saj, ajo i përgatiti një minder dhe një shtrat të veçantë, në mënyrë që Pejgamberi (a.s.), të ulej e të pushonte. Ai (a.s.), e vizitonte shpesh zonjën në fjalë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), pas namazit të drekës

shkonte te shtëpia e Shifasë, radijallahu anha, për gjumin e drekës. Edhe ajo (r.a.), sa herë që e vizitonte, i shtronte këtë minder dhe dyshekun që kishte. Në këtë mënyrë, përpiquej të shfaqte dashurinë që kishte në zemër, ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Këtë kujtim të të Dërguarit të Allahut (a.s.), e ruajti përgjatë gjithë jetës së saj. Pasi ajo ndërroi jetë, ato u ngelën fëmijëve të saj. Më vonë, këto gjëra të çmueshme me vlerë shpirtërore, i kaluan prijësit Emevi, Mervanit.

Shifaja, radijallahu anha, ishte një zonjë fatlume, që vazhdimisht bënte dua. Në kohën e xhahilijetit lexonte për shërimin e disa lloj puçrave të një sëmundjeje lëkure ngjitëse që jepnin temperaturë. Dhe Allahu Teala i shëronte. Shtëpia e saj ishte bërë si spital për ata që prekeshin nga kjo sëmundje. Pasi u bë myslimane, shkoi te i Dërguari i Allahut për t'i marrë leje për këtë lloj mjekimi. Hafsa (r.a.), ishte pranë saj. Këtë gjë që ia copëtonte zemrën, ia tregoi të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Pejgamberi, (a.s.), e lejoi ta vazhdonte këtë shërbim dhe i tha:

*"Mësoja këtë lutje edhe Hafsës, siç e ke mësuar të shkruajë!"*



Pasi i Dërguari i Allahut, (a.s.), i dha leje, ajo e vazhdoi këtë shërbim me zemër të qetë. Të dhënat në lidhje me këtë lloj mjekimi, ia mësoi edhe nënës sonë Hafsas (r.a.).

Shifaja, radijallahu anha, ishte një zonjë e sjellshme, e ndjeshme dhe e devotshme. Një ngjarje që i ndodhi, e tregon kështu: "Një ditë shkova te i Dërguari i Allahut, (a.s.), për ta pyetur për diçka. Ngaqë ishte koha e namazit, më kërkoi ndjesë dhe filloi namazin. Unë dola dhe shkova te shtëpia e vajzës sime, e cila ishte e martuar me Surah b. Hasene.

Suraha ishte në shtëpi, edhe pse ishte koha e namazit. Unë e pyeta atë: "Namazi ka filluar, ndërsa ti akoma je në shtëpi?" I thashë edhe gjëra të tjera.

Ndërsa Suraha më tha:

"Mos më qorto o teze, sepse unë kisha vetëm një rrobë. Sot i Dërguari i Allahut, (a.s.), erdhi te ne dhe na kërkoi një rrobë. Menjëherë ia dhamë. Unë nuk dola jashtë, ngaqë nuk kisha rrobë tjetër." I kërkova ndjesë, duke i thënë: "Nëna dhe babai im të qofshin falë! Unë nuk arrita ta kuptoja këtë."

Shifaja, radijallahu anha, ishte një zonjë që të gjithë përfitonin nga mendimet e saj; e ditur, e sjellshme dhe e respektueshme. Umeri (r.a.), preferonte të zgjidhte

atë për të marrë prej saj këshilla dhe mendime. E dinte se ajo ishte e zgjuar dhe e virtytshme. Përfitonte prej mendimeve të saj dhe ngelte shumë i kënaqur.

Një ditë, Shifaja, radijallahu anha, pa disa njerëz që shtireshin në sjelljet e tyre, që flisnin ngadalë dhe që ecnin rëndë-rëndë. Ajo pyeti:

"Kush janë këta?" lu përgjigjën:

"Këta janë asketët." Shifa binti Abdullah, radijallahu anha, u përgjigj duke thënë:

"Betohem në Allahun se Umeri, radijallahu anhu, fliste me zë të lartë kur thoshte ndonjë fjalë për Allahun. Ecte shpejt kur ecte dhe të godiste shumë kur të rrihte. Krahas kësaj, ai ishte adhurues dhe asket."

Transmetohet se Shifa binti Abdullah, radijallahu anha, ka transmetuar disa hadithe nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Njëri prej tyre është ky. "Një ditë e pyeta të Dërguarin e Allahut (a.s.):

-O i Dërguari i Allahut! Cila vepër është më e virtytshme?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), m'u përgjigj:

-Besimi ndaj Allahut, xhihad i rrugë të Tij dhe haxhi i pranuar."

Allahu qoftë i kënaqur prej saj!

Allahu Teala e bëftë banore të xhenetit Firdeus! Amin!



# Përse e studiojmë jetën e Pejgamberit (a.s.)

Prof. dr. Muhamed Hamidullah

Muhamedi (a.s.), që në ditën e parë të shpalljes si profet i drejtua gjithë njerëzimit. Ai nuk ishte i kufizuar për një periudhë apo për një komb të veçantë. Ai nuk bënte asnjë dallim racor apo social në punën e tij për t'u komunikuar njerëzve të vërtetën. Në Islam, barazia absolute ndërmjet njerëzve dhe përgjegjësia individuale janë parime.

**1.** Termi "Profet i Zotit", sipas vendit dhe kohës shpreh kuptime të ndryshme. Në këndvështrimin islam njeriu është qenia më e nderuar ndër gjithë krijesat e Allahut, kurse Pejgamberi (a.s.), njeriu më i nderuar dhe i përsosur ndër gjithë njerëzit.

**2.** Jeta e njeriut është si një monedhë me dy anë: njëra është shpirtërorja, kurse ana tjetër materialja. Për të siguruar një ekulibër ndërmjet këtyre dy cilësive, njerëzit kanë nevojë për një shembull ideal.

**3.** Historia është dëshmitare e personaliteteve të pa-fundme që kanë lënë gjurmë në historinë e njerëzimit, si mbretër, dijetarë, filozofë etj. Megjithëse kanë kaluar katërmëdhjetë shekuj nga vdekja e Pejgamberit (a.s.) dhe gjatë kësaj periudhe shkenca ka përparuar me hapa galopantë, duke ndryshuar rrënjësisht gjendjen dhe konceptet tona për jetën, përse e ndjejmë të nevojshme të studiojmë jetën e Muhamedit (a.s.)?

**4.** Për një mysliman përgjigjia është shumë e lehtë, sepse një person që nuk ndjek rrugën e Muhamedit

(a.s.), nuk mund të jetë mysliman. Por për një që nuk i di akoma detajet e jetës së Pejgamberit (a.s.), është i nevojshëm kujtimi i disa çështjeve:

**a.** Mësimet e Pejgamberit (a.s.), janë shkruar nën kujdesin personal të Tij dhe janë ruajtur më së miri për brezat pasardhës. Muhamedi (a.s.), nuk u mjaftua vetëm me përcimin e mesazhit të populli i vet, por i urdhëroi sahabët të shkruanin dhe shumëfishonin Kuranin. Leximi i Kuranit gjatë adhurimit u bë obligim. Kjo bëri të domosdoshëm mësimin përmendsh të ajeteve. Shkrimi dhe memorizimi i Kuranit nga ana e besimtarëve vazhdoi pa ndërprerje deri në fund. Këto dy metoda, shkrimi dhe memorizimi ndihmuan njëra-tjetrën në transmetimin e shpalljes hyjnore, pa humbur asgjë nga veçoritë e saj. Teksti i Kuranit është më gjithëpërfshirës se Teurati dhe Inxhili së bashku. Prandaj të mos habitemi nga direktivat dhe këshillat e Kuranit për të gjitha fushat e jetës.

**b.** Muhamedi (a.s.), nuk e konsideroi asnjëherë shpalljen si monopol të tij, përkundrazi, Ai ka theksuar faktin se para Tij janë dërguar pejgamberë të tjerë në popuj të ndryshëm, disa prej të cilëve janë të përmendur në Kuran, kurse shumë të tjerë nuk janë përmendur. Ai e ka përkufizuar veten mbartës të të njëjtit mesazh me pejgamberët para Tij. Pas vdekjes së Tij nuk do të kishte nevojë për pejgamber tjetër, sepse shpallja do të ruhej e paprekur nga deformimet dhe shtrembërimet që pë-



suan shpalljet para Tij. Dhe me të vërtetë, ne sot kemi në duar Kuranin dhe traditën profetike të pacenuar dhe me të njëjtën gjallëri si në kohën e Pejgamberit (a.s.).

**c.** Muhamedi (a.s.), që në ditën e parë të shpalljes si profet iu drejtua gjithë njerëzimit. Ai nuk ishte i kufizuar për një periudhë apo për një komb të veçantë. Nuk bënte asnjë dallim racor apo social në punën e tij për t'u komunikuar njerëzve të vërtetën. Në Islam barazia absolute ndërmjet njerëzve dhe përgjegjësia individuale janë parime.

**d.** Komunikimi i Tij synonte shumicën e njerëzve dhe fushën e interesit me njerëzit nuk e kufizoi në asnjë mënyrë. Sipas Kuranit, njeriu duhet të kërkojë më të mirën në këtë botë dhe në botën tjetër.

**e.** Historia e njerëzimit ka njohur edhe figura të tjera të famshme me ndikim në histori, por të gjithë janë vlerësuar për kontributin e dhënë në fusha të caktuar. Muhamedi (a.s.), është i vetmi që i ka mbledhur të gjitha cilësitë dalluese në personalitetin e Tij. Merita e Tij nuk qëndron thjesht në formulimin teorik, por edhe në shndërrimin e teorisë në praktikë.

**f.** Muhamedi (a.s.), me një profil reformisti, arriti që në një kohë të shkurtër ta shndërronte një mjedis në gjendje kaosi në promotor të përparimit dhe zhvillimit botëror. Në një kohë relativisht të shkurtër arriti të themelonte një shtet nga hiçi dhe të zgjeronte kufijtë në gjithë Gadishullin Arabik, për të vazhduar më tej përhapjen e kufijve të shtetit islam nga Spanja në Kinë nga ndjekësit e Tij. Në luftërat që ka drejtuar vetë, humbjet njerëzore në të dy anët ishin minimale, pa i kaluar disa qindra. Ai drejtonte zemrat e njerëzve dhe pas një pune ngulmuese arriti që në haxhin e lamtumirës t'u ligjëronte 150.000 mijë vetave besimtarë.

**g.** Muhamedi (a.s.), megjithëse ishte pejgamber, nuk e përjashtoi veten nga përgjegjësitë fetare, përkundrazi, Ai falte namaz, agjëronte, jepte lëmshë më shumë se të tjerët. Siç do ta shikojmë më vonë, Ai ishte i drejtë dhe i mëshirshëm në kohë lufte dhe kohë paqeje edhe me armiqtë e Tij.

**h.** Gjatë jetës së Tij u interesua për të gjitha dimensionet e jetës së njeriut, duke lënë edhe shembullin e tij të përsosur, si në jetën materiale, shpirtërore, ekonomike dhe politike.

**5.** Prandaj, para se të jepen konkluzione për Të, duhet studiuar jeta e Tij

**6.** Jeta e personaliteteve është ndërtuar mbi bazën e burimeve të ndryshme. Në dokumentet e shkruara, për disa gjejmë informacion të mjaftueshëm, kurse për disa të tjerë nuk gjendet informacioni i duhur.

**7.** Nga ana tjetër, bie në sy dallimi i theksuar i jetës së

të Dërguarit të Allahut në krahasim me personalitete në fusha të ndryshme, si filozofi, politikë, jurisprudencë, letërsi etj. Në jetën e Tij rastisen gjendje dhe ngjarje që nuk janë të mundura për njerëz të tjerë, si mrekullitë, etj. Për një kërkim objektiv dhe të paanshëm, për ata që dëshirojnë të shkruajnë jetën e Tij, së pari duhet të jenë të sinqertë dhe të kenë një përgatitje të thellë për temën në fjalë. Për të vlerësuar siç duhet meritat e Tij në historinë e njerëzimit, duhet studiuar historia e shkuar e atij vendi; për të kuptuar ngjarjet dhe ndryshimet që solli Muhamedi (a.s.), në historinë botërore, duhet studiuar historia ndërkombëtare e kohës; për të kuptuar rolin e sahabëve në ngritjen e kulturës dhe qytetërimit, duhet sociologjia; për të kuptuar vlerën e jashtëzakonshme të Kuranit, duhet letërsia; për të kuptuar cilësitë ushtarake të Muhamedit (a.s.), duhet studiuar shkenca ushtarake; për të kuptuar shkaqet e konvertimeve dhe ndryshimeve në shoqërinë islame, duhet studiuar psikologjia.

**8.** Për periudhën kur ka jetuar Muhamedi (a.s.), ka burime dhe materiale të bollshme. Së pari, është shpallja e shkruar sa ishte Ai vetë gjallë. Pastaj është hadithi: çdo fjalë, veprim dhe miratim i Pejgamberit (a.s.), i koleksionuar. Pa harruar trashëgiminë e pasur gojore, ku me qindra mijëra besimtarë u kanë transmetuar diçka nga jeta e Pejgamberit (a.s.), brezave pasardhës.

**9.** Krahas Kuranit dhe hadithit, ekziston edhe një burim tjetër shumë i rëndësishëm informacioni, siç është poezia arabe e asaj periudhe. Një fjalë e urtë arabe thotë: "Poezia është arkivi i arabëve."

**10.** Në Mekë dhe Medinë ka me mijëra shkrime për periudhën e Pejgamberit (a.s.), që sapo kanë filluar të studiohen.

**11.** Myslimanët filluan të shkruanin jetën e Pejgamberit (a.s.), që herët në kohën e sahabëve. Fillimisht trajtoheshin luftërat dhe më vonë dolën punime më të gjera. Punimet e shekullit të parë hixhri nuk kanë humbur të gjitha, por punimet mbi jetën e Pejgamberit (a.s.), pothuajse kanë humbur. Punimi më i vjetër mbi jetën e Pejgamberit (a.s.), që ndodhet në bibliotekën e Marokut, me autor Ibn Is'hakun, daton në vitin 151 hixhri. Punime të plota, që kanë arritur deri sot, janë el-Megazi, me autor El-Vakidin, që ndodhet në muzeun britanik dhe er-Ridde, që ndodhet në Indi. Për koleksionimin e shkrimeve të Ibn Is'hakut i jemi mirënjohës Ibn Hishamit (210 h).

**12.** Ibn Kelbi (204,h) dhe nxënësi i tij el-Belazuri (276 h) kanë sjellë deri tek ne vepra voluminoze mbi periudhën e hershme islame.

# Një lutje NJË MALLKIM

Haku ndaj prindërve është shumë i rëndësishëm. Allahu (xh.sh.), e ka lidhur kënaqësinë e tij me kënaqësinë e prindërve.

Erdhi një njeri dhe kërkoi leje nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, për xhihad e ai i tha: *"A i ke prindërit gjallë?"* Sahabi tha:

*"Po." I Dërguari i Allahut tha: "Kthehu tek ata dhe bëje xhihadin tek ta."*

Në një version tjetër të Muslimit, thuhet: "Një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe i tha: 'Të besatohem për emigrim (hixhret) dhe xhihad e me këtë synoj bindjen ndaj Allahut.' I Dërguari i Allahut i tha: 'A e ke ndonjërin prej prindërve gjallë?' Sahabiu tha: 'Po, që të dy.' Tha: 'A dëshiron vallë shpërblimin prej Allahut?' Tha: 'Po.' 'Kthehu tek prindërit e tu dhe sillu mirë me ta.'"

(Mutefekun alejhi: Buhariu nr. 3004, 5972, Muslimi nr. 2549.)

Ata të cilët gëzojnë prindërit e tyre, kanë gëzuar edhe Profetin (a.s.) dhe ai bën dua për ta.

Sihariq për ata që sillen mirë me prindërit. Allahu ua zgjattë jetën!

Për ata të cilët nuk i gëzojnë prindërit e tyre, por i mërzisin, Profeti (a.s.), ka thënë: *"Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, hidhërimi i Allahut është në hidhërimin e prindërve"*. (Tirmidhi, birr, 3/1899)

O vëlla, nëse nëna jote është akoma në këtë botë, atëherë vrapo për te ajo dhe puthja këmbët. Nëse ajo ka ndërruar jetë, atëherë mos u kurse nga këndimi i Kuranit dhe duatë për të, që të fitosh kënaqësinë e saj.

Mosbindja dhe mosrespekti ndaj prindërve mund të bëhet shkak për personin që të ndahet nga kjo botë pa besim. Por edhe, nëse vdes me besim, ai do të ndëshkohet në jetën e varrit, si dhe kur të dalë para Allahut, Ditën e Gjykimit.

Profeti (a.s.), ka thënë: *"Nëse dikujt i plaken prindërit pranë tij dhe nuk arrin të fitojë xhenetin prej tyre, i shkatërruar qoftë, i shkatërruar qoftë, i shkatërruar qoftë!"* (Muslimi, birr, 9, 10.)

Çfarëdo shërbimi që të bëjë një njeri ndaj prindit të vet, nuk mund ta lajë hakun ndaj tyre.

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton, se Pejgamberi, (a.s.), ka thënë: *"Nuk ka mundësi fëmija t'ia kthejë hakun prindit, përveç nëse e sheh atë të zënë rob, pastaj e blen dhe e liron."* (Muslimi)

Ndodhia e mëposhtme e shpjegon shumë bukur këtë gjë:

Në një rast, duke bërë tavaf, Hasan el-Basriu (r.a.), shikon një person, i cili bënte tavaf qaben me një sepet në shpinë. Hasan Basriu një gjë të tillë e konsideroi si mosrespekt ndaj qabes, prandaj iu afrua personit dhe e pyeti se përse po e bënte tavaf Qaben me atë sepet në shpinë. Njeriu iu përgjigj se brenda sepetit kishte nënën e tij shumë të moshuar së cilës po ia bënte tavafin në shpinën e tij. Dhe i tregoi se e kishte sjellë nga Shami në Qabe mbi shpinën e tij.

Pastaj e pyeti: "O imam, e kam shlyer hakun tim ndaj nënës me këtë që kam bërë?" Imami i tha: "Jo një herë, por sikur shtatë herë ta sjellësh nënën në shpinë nga Shami dhe t'ia bësh të mundur tavafin, nuk mund ta shlyesh hakun e saj.

Nëse te një person gjenden këto katër cilësi, Allahu (xh.sh.), shpërndan tek ai mëshirën e Tij dhe ai bëhet prej të dashurve të Allahut.

1. Nëse pret në shtëpinë e tij një mysafir fukara ose bëhet vetë mysafir në shtëpinë e tij.

2. Tregohet i mëshirshëm ndaj të sëmurëve, të braktisurve, dhe personave me të meta fizike dhe mendore.

3. Çdo person prej gjuhës dhe dorës së të cilit është i mbrojtur gjithkush.

4. Sillet butë me prindërit, u shërben atyre në çdo punë dhe i bën dua Allahut për faljen ndaj tyre e Allahu ia pranon duanë.

Mosrespekti dhe mosbindja ndaj prindërve është një shenjë për afrimin e Kiametit.

Ky fenomen do të vijojë me:

- Largimi i bereqetit nga dynjaja,
- Largimi i mëshirës nga zemrat,
- Largimi i dashurisë ndaj krijesave,

- Largimi i turpfit,

- Largimi i frikës së Allahut nga zemrat,

- Largimi i durimit nga i varfri,

- Largimi i bujarisë nga i pasuri,

- Largimi i drejtësisë nga drejtuesit,

- Largimi i legjislacionit të Kuranit,

- Largimi i besimit nga zemra.

Natyrisht që të gjitha këto largime virtytesh janë si shkak i gjynaheve tona të shumta.

Kur është pyetur Profeti (a.s.), për shenjat e Kiametit, ka thënë:

"Kur robëresha të lindë zotërinë e saj"

Kur të afrohet Kiameti, nëna dhe babai nuk do të respektohen, madje fëmijët e tyre do të sillen si zotëri dhe prindërit do t'i trajtojnë si skllëvër.



# Në rrjedhën e jetës

Nuredin Nazarko

Ardhja e njeriut mbi sipërfaqen e lëmshit të dheut është jashtë dëshirës së tij. Po ashtu edhe largimi i tij është jashtë dëshirës së tij. Ardhja dhe largimi janë dy kufij, të cilët mund të shkelen vetëm njëherë dhe kjo është ligjësia e pandryshueshme e jetës.

Përgjatë këtyre kufijve përvijohet përkohësia njerëzore mbi sipërfaqen e tokës, përkohësi e cila është e ndryshme për cilëndo qenie. Kësisoj secila qenie jeton brenda një afati të paracaktuar, afat që as nuk shtyhet e as nuk vonohet, por vjen pikërisht në çastin kur është paracaktuar të vijë. Përbrenda këtij afati rrjedha e jetës së njeriut është kaq dinamike, saqë është pothuajse e pamundur që çdo gjë të ecë sipas dëshirave dhe planifikimeve nga ana e njeriut.

Ecuria konstante si dhe ecuria vetëm pozitive apo vetëm negative janë të përjashtuara nga jeta e njeriut. Jeta e njeriut mbi sipërfaqen e tokës i nënshtrohet ndryshimit të ditëve në jetën e tij. Kësisoj njeriut i duhet të përballet me jetën jo në formën të cilën ai ëndërron dhe dëshiron apo shpreson që t'i vijë, por i duhet të përballet me jetën me formën në të cilën ajo vjen. Jeta e njeriut është e mbushur përplot me ngjarje, ngjarje të cilat janë të pashmangshme për të mos qenë të pranishme në jetën e njeriut.

Natyrisht që ngjarjet që mbushin përkohësinë e njeriut shpesh marrin vëmendjen dhe seriozitetin jo te duhur nga ana e qenies njerëzore. Madje jo rrallë ndodh që njeriu të ndihet i pakënaqur nga rrjedha e jetës së vet dhe ngjarjet që e mbushin përkohësinë e tij. Kjo pakënaqësi vjen si rrjedhojë e përplasjes mes formës me të cilën vjen jeta njerëzore dhe formës me të cilën ëndërron dhe shpreson njeriu që t'i vijë jeta e

vet. Pra ndryshe ëndërron dhe shpreson njeriu, ndryshe ndodh në të vërtetë dhe kjo ndryshueshmëri bën që jo vetëm të ndihet i pakënaqur me jetën e vet, por shpesh edhe të mallkojë fatin e tij që nuk i ka siguruar atë çfarë ëndërronte, dëshironte dhe shpresonte. Në të tilla gjendje jo rrallë ka ndodhur që njeriu t'i ekspozohet rrezikut të rëndimit të gjendjes shpirtërore dhe pasojave që sjell pikërisht ky rëndim. Njeriu bashkohor, dhe jo vetëm, në përfytyrimin e tij mbi rrjedhën e jetës përfshin vetëm dimensionin material të saj dhe vetëm me vështrimin drejt tokës sipas parimit *këtu dhe tani*. Kësisoj, duke iu nënshtuar këtij përfytyrimi të ngritur në ligjësi të pakundërshtueshme qenia njerëzore mendon se jetë e suksesshme është ajo jetë ku dimensionin material është mëse i përmbushur dhe kjo përmbushje është kriteri i vetëm që e nxjerr jetën e njeriut nga gjendja negative e rrjedhës së saj. Në qoftë se dimensionin material i jetës është në rregull atëherë edhe jeta është në rregull. Në qoftë se dimensionin material çalon, atëherë edhe jeta çalon.

Në këtë mënyrë, shumë syresh mendojnë se të pasurit e një jete komode materialisht është shenjë treguese se punët e tyre janë të përvijuara në anën e së mirës, përndryshe nuk kishin pse të kishin sukses në këtë dimension të jetës. Ky është një nga ngashnjimet dhe ndezullitë e shumta që janë përbrendësuar suksesshëm në përfytyrimin e njeriut mbi formën e rrjedhës së jetës.

Nuk duhet të keqkuptohemi dhe të mendojmë se jemi kundër përmbushjes së këtij dimensionin, madje kjo përmbushje është pjesë e natyrshmërisë njerëzore. Por ne nuk duhet të veprojmë sipas parimit *këtu dhe*

tani dhe të ecim përgjatë përkohësisë vetëm me vështrimin drejt tokës. Gjatë gjithë kohës njeriu bashkëkohor është i mbërthyer nga diskutimet mbi dimensionin material të jetës dhe pothuajse as që vramendet për largimin e tij nga vlerat morale dhe gremisjen në shpellën platoniane. Madje është kaq i adaptuar me jetën në këtë shpellë sa që i quan të dalë mendsh ata syresh që rrahin tu kumtojnë se jeta e vërtetë nuk është jeta në llagëmet e kësaj shpelle. E në qoftë se ndodh ndonjë fatkeqësi në jetën e tyre apo në jetën e të tjerëve, që natyrisht ka për të ndodhur, fatkeqësi më të madhe konsiderojnë humbjet materiale.

Në qoftë se kanë humbur vlerat morale nuk vramenden pasiqë njeriut i duhet të mbushë stomakun më së pari, pastaj të shohë se ç'mund të bëjë me dimensionin tjetër të jetës, në qoftë se ka ende ndonjë reminiscencë për këtë dimension. Kjo logjikë e egër dhe e pamëshirshme që përdoret për të analizuar rrjedhën e jetës i ka ndërkryer shumë syresh të rebelohen ndaj fatit, duke e mohuar apo duke e mallkuar atë.

Prandaj do të gjesh qenien njerëzore që vazhdimisht shtron pyetje pesimiste për atë çfarë i ka ndodhur. Pse të më ndodhte mua kjo? Çfarë kam bërë unë që të më bien mbi krye këto fatkeqësi? Pse të më ndodhin mua të tilla mynxyra? Apo do t'i gjesh të zhytyr në supozime të pafund duke thënë vazhdimisht ah sikur të mos më kishte ndodhur kështu! Ah sikur mos kisha bërë këtë apo atë gjë! Ah sikur të kisha bërë këtë apo atë gjë, tani do t'i kisha gjërat ndryshe dhe vazhdon e vazhdon me sikur a thua se do të mund të kthehej në kohë për t'i bërë gjërat ndryshe. Pavarësisht sikurve lumi jetës vazhdon të rrjedhë në shtratin e paracaktuar. Por çfarë ka humbur njeriu bashkëkohor që humbet në detin e paanë të sikurve mbi atë çfarë i ka ndodhur përgjatë përkohësisë së vet?

*De facto* njeriu bashkëkohor ka humbur shumëçka nga të qëniet njeri më së pari dhe duke humbur njerëzoren në brendësinë e vet ka harruar se është njeri dhe si i tillë nuk mund të jetë zot i vetvetes apo i fatit të vet. Çfarëdo që të thotë e çfarëdo që të bëjë kurrsesi

nuk mund të jetë zot i vetvetes edhe pse për njeriun modern, por jo vetëm, ky pretendim është tepër ngashnjes dhe ndezullitës.

Duke u mbështetur tërësisht tek vetvetja për të kuptuar dhe shpjeguar rrjedhën e jetës njeriu modern shkel një udhë e cila nuk ka për të ofruar asnjëherë rrugdalje nga forca rraskapitëse e sikurve. Madje ecja në këtë udhë do ta përfund gjithmonë e më tepër nën peshën tmerruese dhe të frikshme të vetvetes. Ky lloj i njeriut nuk dëshiron ta kuptojë se jeta e gjithësecilës qenie rrjedh në atë lloj mënyre që është më e mira për atë qenie sepse në themel të funksionimit të rendit kozmik është drejtësia.

Logjika e cunguar njerëzore që rrethkohet përreth vetvetes dhe nuk pranon t'i nënshtrohet shpjegimit metafizik të rrjedhës së jetës kurrsesi nuk ka për të pranuar faktin e pazhbëshëm se rrjedha e jetës së çdocilës qenie vjen sipas një urtësie të paracaktuar, themeli i së cilës është drejtësia përtej njerëzore. Është prej rendit natyror të gjërave që qenia njerëzore të mos mundet ta kuptojë dot këtë urtësi, pasiqë edhe në moskuptimin e kësaj urtësie ka urtësi. Kësisoj lind si domosdoshmëri dorëzimi para urtësisë së rrjedhës së jetës edhe pse kjo nuk do të thotë aspak që qenia njerëzore të gjunjëzohet e të mos veprojë gjithë sa ka mundësi të veprojë. Pranimi dhe dorëzimi përballë kësaj urtësie do ta çlironte njeriun nga pesha e frikshme e vetvetes dhe do t'i jepte asaj një qetësi dhe rehati që absolutisht në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të sigurohet.

Qenia njerëzore, duke qenë përballë zgjedhjes, në shumicën e rasteve preferon atë udhë që në dukje është lehtësisht e shkelshme, por zgjedhja e shumicës nuk tregon se domosdoshmërisht kjo zgjedhje është në anën e drejtësisë dhe nuk duhet të harrojmë kurrësesi se sasia sado e madhe që të jetë nuk mund të jetë shenjuese e së vërtetës. Le ta pranojmë dhe ndjekim shpjegimin metafizik të jetës, në mënyrë që të çlirohemi nga vetvetja dhe veprat tona me daljen nga përkohësia të jenë pjesë e përfundimeve të mira.

*"Thirri njerëzit për haxh dhe ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta!"*

(Haxh, 27)

Faltorja e shenjtë në Mekë është tempulli i parë i themeluar dhe dedikuar plotësisht adhurimit të Allahut. Ndërtuesit e saj janë dy profetë të mëdhenj, babë e bir. Njëri u hodh në zjarr, si dënim për injorimin që i bëri adhurimit të idhujtarisë, kurse tjetri, si bindje ndaj urdhrit të babait, e dorëzoi veten për t'u sakrifikuar. Kjo është shtëpi e zgjedhur për myslimanët si kible (pikë orientimi gjatë adhurimit).

Drejtimi nga qabja, është themelor në kryerjen e namazit, por edhe për ibadete të tjera, sepse ajo është shtëpia e parë e shenjtë, e ndërtuar për ibadet në sipërfaqen e tokës, duke qenë edhe shenjë udhëzimi për gjithë besimtarët. Kjo është kibra, që bën të mundur, që të gjithë besimtarët, kudo që janë, në të katër anët e botës, ta ndjejnë veten si një organizëm i vetëm. Ky bashkim vjen si pasojë e adhurimit të një Zoti të vetëm, besimit të një peygamberi dhe drejtimit drejt një orientimi. Ajo është një shtëpi, ku çdokush e ndjen veten të sigurt dhe kështu ka qenë gjatë gjithë historisë, para dhe pas islamit.

Pastaj Allahu urdhëroi Ibrahimin të ftonte njerëzit për të vizituar këtë shtëpi, simbol të monoteizmit, dhe e garantoi se do t'i përgjigjeshin ftesës

së tij dhe do të dyndeshin nga të gjitha anët për të vizituar Qaben, vendin e shenjtë, në këmbë apo me mjete të tjera udhëtimi. Për hir të lidhjeve historike dhe shpirtërore, Allahu e bëri obligim, për bashkësinë myslimane, kryerjen e pelegrinazhit në faltoren e shenjtë. Ritet jetëdhënëse të kësaj vizite të shenjtë, gjallërojnë ndjenjat e besimit dhe bindjes, dhe i forcojnë dhe më shumë ndjenjat e përkushtimit ndaj Zotit. Fjalët e thëna janë plot me domethënie fisnike. Haxhi, që është edhe shtylla e pestë themelore e islamit, së pari është rit fetar, por në mënyrën islame, është edhe tubim politik dhe panair tregtar. Ky është vendi i njohjes, është vendi ku takohet kjo botë me botën tjetër. Besimtarët mblidhen këtu nën një flamur të vetëm, flamurin e besimit. Në këtë flamur, ku humbet çdo dallim racor. Kjo shtëpi është e mbrojtur nga Allahu dhe, që nga koha e Ibrahimit deri më sot vazhdon të qëndrojë në funksionin e saj dhe do të vazhdojë deri në fund. Miliona besimtarë vazhdojnë të vijnë edhe sot e kësaj dite si përgjigje e thirrjes së Ibrahimit (a.s.). Kjo do të jetë kibra e myslimanëve deri në Ditën e Kiametit. Të gjithë besimtarët myslimanë do të kthehen nga Qabja, pa dallim kombi, race, gjuhe e ngjyre.

Transmetohet nga Ebu Katade (r.a.),  
se Pejgamberi -salall-llahu alejhi ve selem-,  
është pyetur rreth agjërimit të ditës së Arafatit dhe është përgjigjur:  
*"Agjërimi i saj shlyen mëkatet e vitit të kaluar  
dhe vitit pasardhës."*

Dita e Arafatit është dita e nëntë e muajit dhilhixhe, një ditë para ditës së Bajramit. Dita e Arafatit është e veçantë, pasi qëndrimi në Arafat është prej kush-teve të haxhit. Muhamedi (a.s.), ka thënë: *"Haxhi është arafat"*.

Prej agjërimeve vullnetare është edhe agjërimi në Ditën e Arafatit. Meqenëse dita e Arafatit është dita kryesore e haxhit, pra dita kur pelegrinët plotësojnë haxhin, nuk është e këshillueshme që të agjërohet nga pelegrinët. Për ta, kjo ditë është si një ditë feste. Kurse për besimtarët që nuk kanë shkuar për të kryer haxhin, agjërimi në këtë ditë, është i pëlqyeshëm. Siç na informon Pejgamberi (a.s.), agjërimi në këtë ditë shlyen mëkatet

e vitit të kaluar dhe vitit pasardhës. Thënieën "shlyen mëkatet", dijetarët e kanë komentuar si shlyerje e mëkateve të vogla, sepse për mëkatet e mëdha është kusht pendimi i sinqertë. Kurse falja e mëkateve për vitin e ardhshëm, është komentuar nga dijetarët si mbrojtje nga rënia në mëkate. Pra, për hir të agjërimit të kësaj dite, Allahu i mbron besimtarët nga mëkatet në të ardhmen. Kurse një grup tjetër e ka komentuar si shlyerjen e mëkateve të ardhshme. Vlen të theksohet se nuk është shumë e rëndësishme mënyra se si falen mëkatet, por lajmi i mirë për shlyerjen e mëkateve për dy vjet, si pasojë e agjërimit për hir të Allahut në këtë ditë të bekuar.

### Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Mirësitë dhe mëshira e Allahut janë të bollshme.
2. Agjërimi në Ditën e Arafatit është ekuivalent me faljen e mëkateve për dy vjet.

## Një Hadith



## BAJRAMI DHE KURBANI

Kjo botë është vend i kurbetit të shpirtit midis së pafilltës dhe të pafundmes. Ndërsa bajramet janë ditë vëllazërie, gëzimi dhe hareje, që Zoti ynë ua ka falur robërve të Tij dhe të cilat rrjedhin në dimensionin kohor, ndonjëherë me tablo lumturie e ndonjëherë me tablo hidhërimi.

Qëndresa në devotshmëri është shpërblimi i sakrificës në rrugën e Allahut. Me gjithë këtë, bajramet kurrë nuk janë ditë pushimi, argëtimi, gëzimi e lumturie individuale. Bajramet janë gëzimi i mbarë shoqërisë. Njeriu nuk mund të bëjë bajram si një individ i vetëm. Pra, ashtu siç nuk mund të mendohet që një namaz bajrami të falet vetëm apo të urosh vetveten, nuk mund të mendohet as një bajram i posaçëm për lumturinë e një njeriu të vetëm apo të familjes së tij. Përkundrazi, bajramet janë fushata të fitimit të zemrave. Ato janë ditë të bekuara, ku realizimi i shumë prej përgjegjësive tona, si vizita e të afërmeve, shfaqja e vëllazërisë islame në shoqëri, pajtimi i të zemëruarve, gëzimi i skamnorëve, të vetmuarve, të sëmurëve e të vuajturve arrin nivelin e më të lartë.

Po ashtu edhe urimet dhe përgëzimet reciproke, janë raste të volitshme për përmirësimin e shpirtit të vëllazërisë në shoqëri. Të parët tanë, që prej njeriut më të thjeshtë e deri tek zyrtarët më të lartë, i kanë dhënë një rëndësi shumë të madhe ceremonisë së urimit reciprok të bajrameve.

Në radhë të parë, urimet reciproke të bajramit duhen bërë me ata që presin më shumë kujdes, ndihmë dhe mëshirë, me ata që kanë harruar gëzimin dhe harenë, si zemrat e hidhëruara, shpirtrat e përvuajtur, të mjerët e të vetmuarit. Pra, është e nevojshme që gëzimin e bajramit, më parë ta ndajmë me ta. Ndërkohë që gëzojmë fëmijët tanë, nuk duhen harruar as jetimët, të cilët nuk

kanë as nënë e as baba që do t'i gëzojë. Besimtari duhet të përpiqet të shpërndajë gëzimin e bajramit tek të gjithë ata ku mund të zgjasë dorën e mëshirës, pa i dhënë mundësi egoizmit me arsyetime si: **"Cilin të ndihmojë më parë?"**.

**Ebu Said el-Hudri** (r.a.), tregon:

Rasulullahu (a.s.), në ditët e Bajramit të Kurbanit dhe Ramazanit, dilte në namazgjah dhe më parë fillonte me faljen e namazit. Pasi falte namazin, çohet në këmbë dhe kthehet nga xhemati, i cili ulet ku kishin falur namazin. Nëse kishte nevojë të dërgonte ndonjë grup diku, ua thoshte xhematit ose nëse kishte ndonjë punë tjetër, i urdhëronte vetë. Gjatë mbajtjes së hutbes, thoshte: **"Jepni sadaka, jepni sadaka, jepni sadaka!"**. Dhe ato që jepnin më tepër sadaka, ishin gratë. Më vonë, Rasulullahu (a.s.), largohej nga namazgjaja." (Muslim, Ijdejn, 9.)

### EDUKIMI I SAKRIFICËS

Treguesi i dashurisë së vërtetë, është sakrifica. Dashuria ndaj Allahut kërkon të marrësh parasysht çdo







lloj sakrifice për Të. Adhurimi i kurbanit, që është edhe një edukim sakrifice, është një kujtim i veçantë që na ka ngelur prej Ibrahimit (a.s.).

Duhet të mendojmë: Si u bë Ibrahim (a.s.), Halilullah/ Miku i Allahut? Si mundi t'ia kushtonte fronin e zemrës vetëm Allahut? Ai vuri jetën në shërbim të Allahut; gjeti jetë. Dhuroi bujarisht pasurinë; arriti një pasuri të paparë. Erdhi në momentin e flijimit të birit të tij, që ishte edhe vazhdimi i sojit të tij;

Allahu i Madhëruar e përgëzoi me suksesin e sprovës. Në Kuranin Kerim, kjo ndodhi tregohet kështu:

**“Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrat, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë për tokë. Ne e thirrëm: ‘O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.’ Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një provë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. ‘Paqja qoftë mbi Ibrahimin!’ Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.”** (Saffa, 103-111)

Për këtë arsye, jo vetëm kafshët duhen konsideruar si kurban në rrugën e Allahut, por edhe gjithçka që kemi. Edhe sahabët e nderuar e zotëronin këtë pjekuri shpirtërore. Prandaj dhe dëshirën më të vogël të Rasulullahut (a.s.), e konsideronin si borxh dhe thoshin: **“Të qofshin falë nëna, babai, malli dhe jeta ime o i Dërguar i Allahut!”** Për të pasur nderin e një sakrifice në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ata garonin ndërmjet tyre. Vetëm sahabët? Jo! Edhe krijesat e tjera i vinin rrotull atij “Nuri”... Të marrim

mësim prej këtyre krijesave... **Abdullah bin Kurt** (r.a.), tregon:

Rasulullahut (a.s.), i kishin sjellë pesë apo gjashtë deve për kurban. Devetë filluan të vinin drejt Pejgamberit tonë (a.s.), sikur garonin se kush do të bëhej kurban e para. Kur devetë u prenë dhe ranë mënjanë, Rasulullahu (a.s.), tha diçka me zë të ulët, por nuk arrita ta kuptoj. Pyeta (dikë që ishte para meje), se çfarë tha Rasulullahu (a.s.):

*“Kush të dojë, le të presë e të marrë nga ky kurban.”*, tha ai. (Ebu Daud, Menasik, 19/1765)

Përpjekja e deveve duke garuar me njëra-tjetrën për të dhënë shpirt në duart e Pejgamberit tonë (a.s.), padyshim se është një nga mrekullitë që Allahu i ka falur atij. Edhe ndodhia e trugut të hurmës, që qau prej mallit të ndarjes me Pejgamberin (a.s.), nuk është më ndryshe. Sipas një thënie të vetë Pejgamberit (a.s.): *“Përveç kryeneçëve prej hindëve dhe njerëzve, të gjitha krijesat e tjera e njihnin atë.”* (shih. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, III, 310.)

Sa mësimdhënës është fakti se edhe kafshët, që Allahu i Madhëruar ia ka dhënë birit të njeriut për shërbim, ndjejnë një dashuri aq të madhe për Pejgamberin tonë (a.s.), sa garojnë me njëra-tjetrën për t'i

dhuruar atij jetën e tyre. Devetë garuan me një bindje e dorëzim të pashoq ndaj Rasulullahut (a.s.), edhe pse ato nuk do të kenë asnjë shpërblim, qoftë në këtë botë e qoftë në botën tjetrën. Prandaj edhe biri i njeriut lumturia e të cilit edhe në këtë botë, edhe në tjetrën është lidhur me bindjen ndaj tij, sakrificën që duhet të tregojë në dorëzimin ndaj të Dërguarit të Allahut, duhet

Qëndresa në devotshmëri është shpërblimi i sakrificës në rrugën e Allahut. Me gjithë këtë, bajramet kurrë nuk janë ditë pushimi, argëtimi, gëzimi e lumturie individuale. Bajramet janë gëzimi i mbarë shoqërisë. Njeriu nuk mund të bëjë bajram si një individ i vetëm. Pra, ashtu siç nuk mund të mendohet që një namaz bajrami të falet vetëm apo të urosh vetveten, nuk mund të mendohet as një bajram i posaçëm për lumturinë e një njeriu të vetëm apo të familjes së tij.

ta peshojë nën dritën e kësaj ndodhie...

Një tjetër tablo mësimdhënëse që na kujton një ndodhi të "epokës së lumturisë", është edhe kjo: Para shumë vitesh, në një vend të Ruisë, një dem i cili do të bëhej kurban, shkoi i qetë drejt vendit ku do të bëhej kurban, sikur të drejtohej nga një dorë e padukshme dhe u ul në krye të pusit ku do të bëhej kurban. Ata që ndodheshin aty, e panë të mahnitur këtë ngjarje.

Allahu Teala, përveç shumë urtësive, ndonjëherë shfaq edhe ndodhi të tilla dhe, nëse dëshiron, ua tregon ato edhe robërve të Tij. Ashtu siç Allahu Teala i shfaq ndodhi të tilla duke bërë përjashtime në ligjet e Veta, ashtu edhe i gjithë krijimi është i mbushur me të fshehta dhe urtësi të mrekullueshme hyjnore. Por e rëndësishme është që të zotërohet një sy zemre, i cili mund t'i lexojë faqet e fshehtësive dhe urtësive në librin e gjithësisë; që zemra të mund të lexojë me syrin e urtësisë, sipas urdhrit hyjnor: "**Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijon.**" (Alak, 1) Allahu Teala edhe kafshëve për kurban u ka dhënë një ndjenjë dhe i ka zgjedhur ato për realizimin e një adhurimi. Prandaj, mëshira, dhembshuria dhe kujdesi që duhet të tregohet ndaj kafshëve për kurban, në fakt shpreh respektin ndaj Allahut Teala.

Për këtë arsye, Pejgamberi i mëshirës (a.s.), e ka ndaluar kryerjen e këtij adhurimi në mënyrë të dhunshme dhe të pashpirt. Kafsha që do bëhet kurban, duhet mbajtur mirë me ujë e me ushqim nëse ka nevojë, duhet qetësuar, i duhen lidhur sytë dhe duhet çuar në mënyrë të mirë dhe pa e torturuar deri në vendin ku do bëhet kurban. Rasullullahu (a.s.), kur e pa dikë që po e tërhiqte prej veshi delen që do të bënte kurban, ndërhyri dhe tha:

"*Lëshoja veshin kafshës dhe kape anash qafës!*" (Ibn Maxhe, Zebaih, 3.)

Përveç kësaj, me qëllim që të mos e torturojnë shumë kafshën gjatë prerjes, Pejgamberi (a.s.), ka porositur që thikat të mprehen mirë:

"*Kur dikush prej jush të presë një kafshë, le ta bëjë shpejt!*" (Ibn Maxhe, Zebaih, 3.)

Përsëri një ditë tjetër, Pejgamberi ynë (a.s.), pa dikë që po priste një dele. Njeriu pasi e shtriu delen në tokë, filloi të mpriste thikën. Por Pejgamberi ynë (a.s.), përballë kësaj sjelljeje të pamenduar dhe të pashpirt, tha:

"*A dëshiron ta vdesësh këtë kafshë për disa herë me radhë? A nuk do të ishte më mirë që ta mprishje thikën pa e shtrirë atë përtokë (që ajo të mos e shihte)?*" (Hakim, IV, 257, 260/7570.)

Nisur nga kjo, nuk duhet të harrojmë kurrë se kurbanit është një adhurim dhe se duhet të ruhem nga sjelljet që e cenojnë anën shpirtërore të këtij adhurimi. Kjo, sepse siç ka thënë edhe **Enes bin Maliku** (r.a.): "*Edukata e treguar në vepër, është tregues i pranimit të saj*". Po ashtu edhe të dashurit e Allahut janë shprehur, se "*Adhurimi e çon njeriun në xhenet, ndërsa edukata dhe respekti në adhurim, të afron tek Allahu*".

Dy nga të dashurit e Allahut, **Sami Efendi** dhe babai im **Musa Efendi** (Allahu i mëshiroftë), kur prisnin kurban, tregoheshin shumë të kujdesshëm. Ata nuk lejonin të priheshin dy kurbanë në një gropë. Porosisnin që kafshës t'i lidheshin sytë dhe të dërgohej me butësi në vendin e kurbanit. Nëse ishte prej kafshëve të imëta, kërkonin që të merrej në krah dhe të dërgohej me butësi. Ata kujdeseshin që thika të ishte e mprehur mirë dhe porositnin që kafsha të therej mirë e shpejt, pa e torturuar dhe të lihej që gjaku t'i kullonte deri në fund. Kur kurbanit ishte duke u prerë, nuk uleshin kurrë, por prisnin në këmbë derisa gjaku të kullonte plotësisht. Duke menduar për kurbanet, duhet të falënderojmë Allahun, sepse në vendin e tyre mund të ishim edhe ne. Pra, Allahu Teala mund të na krijonte ne si kafshë kurbanit. Për këtë arsye, duke menduar rreth mirësisë që na ka falur Allahu, duke na krijuar si robër të Tij, duhet ta shtojmë edhe më shumë falënderimin ndaj Allahut. Ndërsa, përballë skenës ku kurbanet japin shpirt, duhet të mendojmë edhe frymën tonë të fundit. Me një fjalë, nëse është e mundur, të qëndrojmë te koka e kurbanit, ndërkohë që ai është duke u prerë dhe të meditojmë të zhytur në ndjenja të thella rreth këtyre të vërtetave.

Treguesi më i bukur  
i shkallës së besimit,  
është mëshira. Ndërsa  
mëshirë, është që atë  
që zotëron, t'ua dhurosh  
nevojtarëve, duke  
plotësuar nevojat e tyre.  
Ky aspekt i kurbanit e  
bën atë një adhurim  
që mpreh ndjenjën e  
mëshirës në zemrat e  
besimtarëve.

Përveç kësaj, gjatë këtyre ditëve të bekuara, duhet të mos merremi me punë të padobishme, por këtë kohë shumë të çmueshme ta zbukurujmë me përmendjen e Allahut, me dhënie sadakaje e veçanërisht me tekbiere, që janë edhe prej simboleve të bajramit. Në "epokën e lumturisë", Fitër Bajrami përgatitej me sadaka, qerasje dhe dhurata; ai përballohej me dhurimet që bëheshin për hir të Allahut. Kjo, sepse dihej shumë mirë se përjetimi i një bajrami të vërtetë arrihet duke gëzuar edhe zemrat e hidhëruara me harenë e bajramit.

Në kohën e Pejgamberit tonë (a.s.), kur po afrohej koha e Bajramit të Kurbanit, erdhi një grup beduinësh të mjeruar e nevojtarë. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), urdhëroi që mishi i kurbanit të mos mbahej më tepër se tri ditë dhe të shpërndahej. Më vonë, kur u shtuan edhe mundësitë, Pejgamberi (a.s.), e hoqi këtë detyrim. Megjithatë, ai nuk hoqi dorë nga motivimi dhe nxitja e myslimanëve për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe për t'u kujdesur ndaj të varfërve.<sup>1</sup>

Për këtë arsye edhe ne si umeti i Muhamedit (a.s.), duhet të mendojmë në këtë mënyrë: Sot, në rruzullin tokësor ka shumë vëllezër myslimanë, të cilët prej kohësh nuk kanë parë mish me sy. Kështu që me ndihmën që mund të japim me rastin e Bajramit të Kurbanit, pikësëpari, duhet të kthejmë gëzimin e bajramit në fytyrat e këtyre vëllezërve tanë e të përpiqemi të fitojmë ato zemra të dëshpëruara. Kjo, sepse përpjekja për të fituar një zemër të tillë mund të bëhet shkak i kënaqësisë dhe afërsisë me Allahun. Mbase kjo mund të jetë edhe rruga më e shkurtër për takimin me Zotin tonë.

Një ditë, nxënësi që i shërbente të nderuarit **Daud-i Tait**, tha:

"Kam pjekur pak mish, a po urdhëroni?" Pasi vuri re se mësuesi i tij po heshtte, ai e solli mishin. Mirëpo, i nderuari Daud-i Tai, duke e parë mishin që iu vu përpara, pyeti: "Çfarë lajmesh kemi nga filan jetim, mor bir?" Nxënësi tha: "Ashtu siç e dini, i nderuar!". Pas kësaj, ky i mik i mirë i Allahut, tha: "Atëherë, këtë mish çojua atyre!" Ndërsa nxënësi i singertë, i cili dëshironte që ushqimin e përgatitur ta hante mësuesi i tij, këmbënguli duke thënë: "I nderuar, edhe ju keni kohë të gjatë pa

ngrenë pak mish!"... Megjithatë, Daud-i Tai, nuk pranoi dhe tha: "Biri im! Nëse do ta ha unë këtë mish, ai do të humbasë. Por, nëse e hanë ata jetimë, ai do të ngrihet përjetësisht tek Allahu Teala!.."

I dashuri i Allahut, Mevlana, në lidhje me ata që fokusohen vetëm në planin e jashtëm të kurbanit, pa qenë të vetëdijshëm ndaj këtyre të vërtetave dhe kushteve shpirtërore të tij, shprehet me këto fjalë qortuese:

*"Ki kujdes, mos u mundo të bësh kurban hijen e dhisë!.."*

Mishi dhe kocka e kafshës që bëhet kurban, është hija (e kurbanit); ndërsa thelbësore është kuptimi që shprehet ai (kurbanit). Pra edhe shpirti duhet të jetë i vetëdijshëm ndaj këtij kuptimi. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

**"Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj!.."** (Haxhxh, 37)

Treguesi më i bukur i shkallës së besimit, është mëshira. Ndërsa mëshirë, është që atë që zotëron, t'ua dhurosh nevojtarëve, duke plotësuar nevojat e tyre. Ky aspekt i kurbanit e bën atë një adhurim që mpreh ndjenjën e mëshirës në zemrat e besimtarëve. Bajrami i vërtetë është për robërit fatlumë, që në sajë të këtyre ndjenjave arrijnë të marrin vizën e shpëtimit të përjetshëm, duke ia kushtuar jetën dhe pasurinë Allahut Teala; për besimtarët altruistë, vetëmohues, bujarë e punëtorë,

të cilët e marrin urimin e bajramit prej Allahut Teala, në sajë të një duaje të pranuar që është ngritur tek Ai nga një zemër e hidhëruar, e cila ka shijuar bajramin në sajë të tyre.

ÇLIRIMI MË MADHËSHTOR, ËSHTË ÇLIRIMI I ZEMRAVE. LUM ATA QË DUKE E BËRË ZEMRËN VEND-MËSHIRE PËR TË GJITHË BESIMTARËT DHE KRIJESAT, U JAPIN JETË NË SARAJET E SHPIRTIT TË TYRE...

**Allahu Teala na bëftë të mundur një jetë të mbushur me frymëzim shpirtëror dhe frymën tonë të fundit e bëftë hapin e parë të paqes dhe lumturisë së një bajrami të përjetshëm!...**

**Amin!..**



1. Shih. Muslim, Edahi, 28, 34; Ebu Daud, Edahi, 9-10/2812.

# Mbi lumturinë DHE DHUNËN në martesë

Mustafa Asim Kyçkashçe

Të Gjesh Shpirtin Binjak.

Disa e lidhin martesën me një utopi të tillë.

Sa është e mundur që martesën ta vlerësojmë në formën e gjetjes së shpirtit binjak? Ta fillosh martesën me një ideal kaq të lartë që në fillim, mos është rraskapitje?

Mund të gjejmë një koncept më të bukur e me real sesa *shpirti binjak*:

Pasqyra e shpirtit...

Në fakt;

Është në përputhshmëri me hadithin e Profetit: "*Besimtari është pasqyra e besimtarit.*" (Ebû Dâvûd, Edeb, 49/4918), si dhe shpjegues i veçorisë që martesë plotëson gjysmën e njeriut. (Hâkim, el-Mustedrek, Nr: 2681, 2/175)

Gjithashtu, është në atë formë që do të përfshinte atë parimin e reflektimit shpirtëror të hadithit: "*Jini të ndershëm e të virtytshëm ndaj grave të të tjerëve, në mënyrë që edhe gratë tuaja të jenë të ndershme e të virtytshme.*" (Kenzu'l-Ummâl, 34/34)

Në fakt edhe ata që janë në kërkim të shpirtit binjak i gjen përpara pasqyrës. Por;

I ka kapluar një mendjemadhësi kur thonë "Pasqyrë

moj pasqyrë, pa më thuaj mua! A ka më të bukur në botë se unë?" Kurse ajo jona është një pasqyrë që tregon sa bukurinë, po aq edhe të metat tona dhe që shpreh të vërtetat aq sa tregon edhe bukurinë.

Të thuash shpirti binjak, të kujton kërkimin e partnerit tjetër të shpirtit të vet të "mrekullueshëm". Ndërsa, duke shikuar në pasqyrën e shpirtit, do të thotë të bësh "mirëmbajtjen" e vetes dhe "me besnikëri" ndaj personit përballë, pra, duke pasqyruar në mënyrën më të mirë gjendjen reale me përkushtim e ndershmëri, të bësh të mundur që edhe ai të arrijë të bëjë mirëmbajtjen, edukimin, pastrimin e shpirtit të tij. Pikërisht këtu duhet të jetë veçoria e plotësisht të gjysmës së martesës.

Lexusit tanë të martuar do ta vërtetojnë këtë. Le të jenë martuar me çfarëdolloj mënyre apo procedure, do të shikojnë se caktimi i Allahut u ka dhuruar atyre bashkëshortë të ngjashëm e në përputhje në disa pika e në disa pika pothuajse krejt të kundërt.

Nëse njëri është i kujdesshëm, tjetri është indiferent...

Nëse njëri është shumë i përpiktë, tjetri është më i rehatshëm...

Nëse njëri preferon të flasë shumë, tjetri preferon heshtjen...

Nëse njëri është i ndrojtur, tjetri është inkurajues...

Edhe nëse ka diçka të tillë si shpirti binjak, dy shpirtëra që janë kopja e njëri-tjetrit, a është e mundur të jenë të lumtur në një organizëm siç është martesë?

Në fillim; disa prej atyre që martohen duke thënë

se "Kam gjetur shpirtin binjak!" më pas të zhgënjyer nga pretendimet e mëdha, a nuk është e dhimbshme të ngrihen e të thyejnë edhe pasqyrat e shpirtit?

Ndërkohë që lumturia në martesë është dy llojesh.

1. Lumturi Materiale/ e dukshme: Për shembull, një bashkëshort/e fisnik/e / me pozitë e autoritet, e bukur / i bukur, i fortë /i/e aftë, i/e pasur / nga një ambient shoqëror i mirë... një sërë mundësish ku nuk përballësh me asnjë mungesë materiale dhe jeton një jetë komode e të rehatshme.

Tani le të analizojmë këtë lloj lumturie:

a) Gjendja e përkryer e kushteve të kësaj lumturie mendoj se ekziston vetëm në përralla. Madje edhe në përralla shtrigat e liga bëhen pengesë e lumturisë, duke ua nxirë jetën princave me kalë të bardhë e princeshave me flokë të artë.

b) Në përgjithësi, kushtet e kësaj lumturie materiale janë në dorën e fatit. Ka të bëjë pikërisht me fatin. Nëse nuk është e shkruar, nuk ju mbetet gjë për të bërë. Është e kotë të merreni me atë që nuk e keni ju në dorë.

c) Edhe pse kanë të bëjnë me fatin, njeriu mund të përqendrohet në këto. Në martesën që do të bëjë; mund të mundohet të ketë më të mirën e këtyre kushteve fizike, materiale dhe të dukshme. Por, për arsyt që i përmendëm edhe në dy pikat e mësipërme, ky përqendrim të dërgon në njërën prej këtyre përfundimeve:

- O mbetet kërkim pa rezultat, pra ai që kërkon partner (bashkëshort/e) pa të meta mbetet pa partner. (Kështu që sot, ndërkohë që martesat pakësohen, fenomeni i jetesës si beqar dhe i/e ve po përhapet.)

- Ose mund ta orientojë njeriun drejt një zgjedhjeje të gabuar dhe sprovave, si ndërrimit të bukurisë shpirtërore me bukurinë trupore; inteligjencës dhe zgjuarsisë me pozitën; qetësisë me pasurinë.

- Për shkak se këto pika janë në dorën e fatit, në momentin që individi nuk arrin t' i zotërojë, në botën e brendshme zhvillohen ndjenja negative. Këto ndjenja negative, nëse drejtohen drejt fatit, kthehen në pakënaqësi, nëse drejtohen drejt individëve që i zotërojnë, kthehen në xhelozë dhe urrejtje.

Çdonjëri prej këtyre përfundimeve është privim nga lumturia.

Ndërsa lloji i dytë i lumturisë që mund të përfitohet në martesë, është ajo shpirtërore dhe e padukshme:

2. Lumturia shpirtërore / e padukshme: Kjo lumturi është e thjeshtë. Është harmoni e përkryer, qetësi dhe lumturi që zhduk çdo brengë. Të lumturohesh

duke u kënaqur me gjëra të vogla. Është një kënaqësi shpirtërore që buron nga të qenit familje, nga të dashruarit të tjerët dhe të dashruarit nga të tjerët, nga të respektuarit dhe të ndjerit dhembshuri, nga të bërit shërbim dhe të shikuarit si i denjë për të të shërbyer, nga besnikëria dhe nga të qenit i sigurt në lidhje me të ardhmen. Kur kësaj i shtohet edhe lumturia e gjeneratës, bëhet e përkryer.

Nëse i analizojmë këto:

a) Edhe këto pika padyshim që janë çështje fati, por nga pikëpamja e origjinës të gjitha janë rezultatet e sjelljeve morale. Dashuria, nderimi, respekti, besnikëria, kënaqësia, të gjitha këto janë veti që mund të fitohen apo që mund të përfitohen me edukim. Për këtë shkak edhe është e mundur. Martesa është një zgjedhje e përjetshme. Bukuria e përkohshme përballë jetës fishket, por bukuria morale gjatë gjithë jetës është e bukur. Pasuria mund të zhduket, por pasuria shpirtërore nuk shteret. Asnjë lloj pozite nuk është aq e lartë sa besnikëria.

b) Personi, i cili ka si synim parësor qetësinë shpirtërore edhe kur martohet përsoset pikërisht në këtë. Këtu le të bëjmë një shpjegim të hadithit të njohur të Profetit Muhamed (a.s.):

Alternativat që merren parasysh nga kandidati që do të martohet në përzgjedhje janë:

Prejardhja (sot kësaj mund t'i bashkërendisim edhe postin e arsimimit), pasuria, bukuria dhe feja...

Përderisa të gjitha këto s'mund të kihen njëherësh dhe përderisa tre shkaqet e para materiale e fizike të përzgjedhjes janë të përkohshme e që nuk mund të sjellin një lumturi absolute, alternativa që duhet synuar në të vërtetë mbetet ajo e fesë. Padyshim që këtu me termin fe kemi për qëllim të qenit besimtar i devotshëm, ku përfshihet morali i mirë, edukimi islam, mirësjellja dhe personaliteti.

Thamë që martesa është një zgjedhje e përjetshme. Nëse bukurinë e vlerësojmë nga pikëpamja e jetëgjatësisë së martesës, prejardhja-pozita i intereson rinisë dhe për më tepër moshës së mesme, dhe pasuria më së shumti u intereson të moshuarve. Kurse të qenit i devotshëm gjatë gjithë jetës, i intereson jetës së pafundme e të vërtetë.

Të rinjtë që do të martohen në ditët e sotme, ndërkohë që kapen pas kushteve të lumturisë materiale, po humbasin qetësinë shpirtërore.

Nga familjet që braktisin moralin shpirtëror zhduket edhe begatia, besnikëria, durimi, rezistenca, dhembshuria.

Nga njeriu i ditëve të sotme po bëhen përpjekje të hiqen dy veti të trashëguara:

Nga meshkujt xhelozia (ndjenja mbrojtëse), nga gratë ndjenja e turpit.

Po mirë, a është ky një zhvillim? Pra, femrat dhe meshkujt e braktisën ndjenjën e turpit dhe xhelozinë në mënyrë graduale? Jo... Plani shoqëror i shtyu individët drejt kësaj. Për shkak të joshjeve, iu afruan dhe e gjetën veten e tyre në këtë gjendje.

Shoqëritë që kanë ndjenja fetare, akoma janë paksa më larg kësaj; por edhe tek to vërejmë një ndikim të madh. Por ndikimi anësor del në pah gjithmonë në familje.

Në syrin e personit, i cili pandeh se u reziston shikimeve që i hidhen bashkëshortes së tij, në të vërtetë bashkëshortja e tij sa vjen e bëhet më e pavlerë. Shigjetat e shikimeve ekstreme, shigjetat e fjalëve, mikrobet kompleksivë që depërtojnë e i ngulen bashkëshortes së tij nga mëngjesi deri në darkë, kthehen në një ind dhe aromë morale që e bën gruan të urrejë bashkëshortin e saj. Kjo urrejtje që të bën të zhvlerësuar; nganjëherë e egjëron mashkullin në atë shkallë, sa gruas të cilën e dashuroi, e pëlqeu dhe u martua me të t'i ngulë qindra thika. Nganjëherë gruan e bën aq të pamëshirshme, sa të braktisë atë së bashku me dy fëmijët.

Sepse mungesa e xhelozisë dhe turpit zhduk besnikërinë dhe përkushtimin.

Sepse ndjenja e mbrojtjes, pra të xhelozosh, në origjinë do të thotë të zotëros. Të xhelozosh, do të thotë të mos duash ta ndash me dikë tjetër. Një dashuri e shkallës: "O je e imja, o je e dheut!", kur kthehet në urrejtje e bën personin së fundmi ta lërë apo ta braktisë ose e divorcon përfundimisht apo, edhe pse e ka divorcuar nuk e nxjerr nga mendja: e plagos, e vret, e gropos. Në këto vitet e fundit, një pjesë e mirë e ngjarjeve të dhunës ndaj femrës i shikojmë në mesin e çifteve të divorcuar...

Thonë: "T'i edukojmë meshkujt që të mos sillen këshu!"

Le të shtrojmë pyetjet:

A ka familje, nëse nuk ekziston ndjenja e mbrojtjes, xhelozia? Kur nuk gjendet ajo ndjenja e turpit, a qetësohet ajo ndjenja e xhelozisë?

Të dyja këto ndjenja janë të natyrshme. Pa dyshim që xhelozia e tepërt duhet lëmuar. Hadithi:

*"Është një lloj xhelozie që Allahu e do; është edhe një pjesë tjetër e xhelozisë që Allahu nuk e do. Xhelozia të cilën Allahu e do, është xhelozia që personi*

*ndjen në raste dyshimi (me shikimin e një veprë të ndaluar nga i afërmi i tij). Xhelozia të cilën Allahu nuk e do, është ajo që personi të ketë xhelozia pa pasur dyshime..."* (Ebû Dâvud, Xhihad 104, 2659)

Por xhelozia nuk eliminohet. Edhe nëse mendoni se e keni eliminuar, nuk zhduket. Ashtu siç evidentohet me emra të tillë si shtypje e reflektime të psikologjisë, në një fushë tjetër shfaqet në formën e dhunës në familje e të shtimit të divorceve.

Sot anekdotat, komeditë, karikaturat, tregimet e produktet e ngjashme humoristike i shtynjë meshkujt vazhdimisht drejt ftohjes nga martesja e të bërit një keqtrajtuës i pabesë e një hedonist i papërgjegjshëm. Ashtu si intrigantët që përpiqen të fusin dy persona në grindje me njëri-tjetrin, të cilët shkojnë te femrat e duke u thënë që: "Meshkujt gjithmonë kështu janë!", u imponohet të mos i binden bashkëshortit e për hatër të tyre të mos jenë të detyruara të kenë turp, të mbulohen e të jenë besnike. Versionet serioze të këtyre janë në garë për ta treguar mashkullin si mizor, të egër, të pamëshirshëm e agresiv.

Cila është këshilla juaj?

Në vend të syve të nxirë, çati ngjyrë vjollcë.

Nëse meshkujt dhe femrat i kalibrojnë xhelozinë dhe turpin sipas asaj që të mos bien ndesh me ligjet e Allahut (xh.sh.), e ashtu siç e kërkon suneti i Profetit Muhamed (s.a.v.s.), del në pah një qetësi që do i kënaqte të gjithë.


Sot, nëse në një sallon do të bëhej një organizim meshkuj-femra më vete, ata të cilët thonë: "Ah të prapambeturit! Po rikthehen sërish kohët e vjetra! Në cilën epokë jetojmë?", një ditë do ta kuptojnë se xhelozia dhe turpi, organizimet meshkuj-femra më vete, mbulesa e hixhabi janë nevojë e lumturisë së shoqërisë.

Sot diçka të tillë e kundërshtojnë duke thënë se "stili i jetesës" është ky i tyri. Në Egjipt ia dolën mbanë. Gjoja "stili i tyre i jetesës" shpëtoi. Por u zhduk "e drejta e jetesës" e qindra njerëzve të tjerë!

Nuk arrijnë të perceptojnë se shqetësohemi paksa edhe për shkak se në këtë anije të cilën janë duke e çarë në paturpësi, shthurje, pabesi... pra se në këtë shoqëri jetojmë edhe ne, se nëse kjo anije fundoset, do të fundosemi të gjithë së bashku.

A s'ka ardhur koha t'u vëmë veshin besimtarëve të devotshëm e të shqetësuar?

**"Është një lloj xhelozie që Allahu e do; është edhe një pjesë tjetër e xhelozisë që Allahu nuk e do. Xhelozia të cilën Allahu e do, është xhelozia që personi ndjen në raste dyshimi. Xhelozia të cilën Allahu nuk e do, është ajo që personi të ketë xhelozia pa pasur dyshime..."**



Njeriu që bën haxhin, i hap krahët edhe drejt botës tjetër, duke e kthyer tunelin kohor nga e shkuara në të ardhmen. Dhe, duke u përpjekur të arrijë të fshehtën e vdekjes para se të vdesë, ai ka rastin të bëjë edhe provën e jetës tjetër.

# Shkolla e haxhit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Synimi kryesor i feve hyjnore dhe qëllimi i parë e themelor i pejgamberëve, është purifikimi i njerëzimit; pastrimi i zemrës së njerëzve nga kjo botë dhe i egove të tyre nga veset e këqija.

Purifikimi, fillon me pastrimin e zemrës prej çdo besimi dhe mendimi që bie ndesh me teuhidin (njëshmërinë e Allahut). Misioni kryesor i pejgamberëve që përmenden në Kur'an, është lufta për teuhidin; shpëtimi i njerëzve nga batakuri i mohimit, idhujtarisë dhe ateizmit. Periudha e parë prej njëmbëdhjetë viteve e Rasulallahut (a.s.), në Mekë, kaloi duke luftuar për

teuhidin. Në fund të vitit të njëmbëdhjetë, filloi pastrimi me namaz, më pas me agjërim, pastaj me zekat dhe më në fund u kurorëzua me urdhrin e haxhit.

Urtësia e të gjitha adhurimeve është të kontribuojnë në pastrimin e shpirtit të njerëzve dhe ta përmirësojnë atë. **"...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe!.."** Pra, namazi e ruan njeriun nga e keqja dhe nëse besimtarët **"janë të për-**

1. Ankebut, 45.

**ulur në namazin e tyre**<sup>2</sup>, ai bëhet një adhurim që të çon në shpëtim.

Agjërimi, është një adhurim që i mëson njeriut kohën e paraagimit dhe është urdhëruar **“...që (ai) të mund të bëhet i devotshëm**<sup>3</sup> dhe të ruajë zemrën e tij nga të këqijat.

Kuptimi i fjalës “zekat”, është pastrim. Për rrjedhojë, zekati është një adhurim i cili **“e pastron njeriun**<sup>4</sup> nga çdo lloj ndjenje koprracie. Përveç kësaj, ai është edhe një adhurim që të shpie tek ndjenja e dhurimit, njësoj sikur hap një tunel, i cili kalon pengesat për tek nevojtarët.

Për sa i përket haxhit, ai është një shkollë që mesatarisht zgjatë 20-30 ditë. Edhe në këtë shkollë, synimi është pastrimi, purifikimi dhe arritja e devotshmërisë së zemrës. Në ajetin në lidhje me haxhin, urdhërohet:

**“Koha e haxhit është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhin, le të largohet nga marrëdhëniet (seksuale), vepra e këqija dhe grindjet. Ndërkaq, Allahu e di çdo vepër të mirë që bëni. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria...”**<sup>5</sup>

Sipas të dhënave të Kur'anit Fisnik: **“Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”**<sup>6</sup>

Haxhi, nuk është vetëm një udhëtim fizik në një pozicion gjeografik, në Mekë e Medinë, por edhe një udhëtim në tunelin kohor; në të shkuarën dhe në të ardhmen. Udhëtim në të shkuarën, sepse vendet e haxhit janë vendet ku babai ynë Ademi (a.s.) dhe nëna jonë Havaja, janë takuar përsëri pasi kanë zbritur nga xheneti. Sipas transmetimeve, Qabja për herë të parë është ndër-tuar nga Ademi (a.s.). Përveç kësaj, kur Ademi (a.s.), u vendos në xhenet, u urdhërua të mos hante nga pema e ndaluar.

Ndalesa “e marrëdhënieve seksuale” gjatë haxhit, duket sikur është një proces i ri ekzistence dhe një kthim në jetën e xhenetit ku Ademi (a.s.) dhe Havaja

jetonin më parë. Ndërsa ndalimi “i veprave të këqija”, është rezistenca e njerëzve gjatë haxhit për të mos rënë në kurthet shejtanit, i cili më parë kishte shtyrë në gjynah edhe Ademin (a.s.) dhe Havanë kur ndodheshin në xhenet. Kurse “grindja”, na kujton luftën e shejtanit me Ademin (a.s.) dhe birin e tij, për shkak të të cilëve (shejtani) u dëbua nga xheneti. Prandaj, njeriu duhet të ruhet nga grindjet gjatë haxhit, me qëllim që të mos ketë të njëjtin përfundim. Nisur nga kjo, për sa kohë që njeriu të jetë nën ndalesat e “ihramit/haxhit”, përjeton përvojat e njeriut të parë dhe udhëton drejt periudhave të fillimi.

Gjithashtu, në tunelin kohor të haxhit, mund të për-kujtojmë edhe Ibrahimin (a.s.), i cili e ndërtoi Qaben për herë të dytë, peripecitë e djalit të tij Ismailit (a.s.) me nënën tonë Haxher dhe luftën e tyre me shejtanin. Ibrahim (a.s.), i vendosi disa nga pasardhësit e tij, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë së Shenjtë të Zotit, me qëllim që të falin namazin.<sup>7</sup> Ibrahim (a.s.), e vendosi gruan e tij Haxherin dhe djalin e tij Ismailin në luginën e Mekës dhe ia la amanet Allahut. Meka u bë një qytet i sigurt, ndërsa Qabja harem, pra tokë e shenjtë.

Njeriu, brenda haremit përjeton emocionin e nënës sonë Haxher, e cila kërkonte ujë për birin e saj Ismailin midis kodrave Safa dhe Merve dhe lumturinë e saj kur arriti të gjejë ujin e Zemzemit. Kur gjuajmë shejtanin në Mina, përkuajmë Ibrahimin (a.s.), Ismailin dhe Haxherin, të cilët gjuajtën me gurë shejtanin që mudohej t'i mashtronte. Me mbajtjen gjallë të këtij syneti, i tregohet vendi edhe shejtanit që gjuhet me gurë nga balta prej së cilës buron edhe Ademi (a.s.), të cilin ai (shejtani) e përçmoi aq shumë.

Në këto toka, ku i Dërguari i Allahut (a.s.), kaloi 53 vite të jetës së tij 63 vjeçare, na vijnë parasyshe edhe lufta e tij për ta pastruar Qaben nga idhujt. Aty përjetohet emocionin e Dërguarit të Allahut (a.s.), kur bënte tavaf rreth Qabes i hipur në deve dhe gjallëria e entuziazmi i tij kur bënte sajin<sup>8</sup> në haxhin e lamtumirës, të cilin e realizoi pasi e pastroi Qaben nga idhujt dhe e bëri të përshtatshme për haxh.

7. Shih. Ibrahim, 37.

8. **Saj:** Ecja e shpejtë midis dy kodrave Safa dhe Merve, që simbolizon ecjen midis këtyre dy kodrave të nënës sonë Haxher kur kërkonte ujë për birin e vetë Ismailin.

2. Mu'minin, 2.  
3. Bekare, 183.  
4. Shih. Teube, 103.  
5. Bekare, 197.  
6. Al-i Imran, 96.



Më së fundi, njeriut i duket sikur dëgjon hutben (ligjëratën), që është në cilësinë e të drejtave universale të njeriut, të cilën Rasulallahu (a.s.), e mbajti prej vendit të quajtur Xhebeli Rahmeh, para 125 mijë sahabëve të mbledhur në Arafat.

Të vërtetat që iu shpalosën njerëzimit, të qëndisen në zemër. Ndërsa këto fjalë që i Dërguari i Allahut i tha kur ishte duke u larguar prej Arafatit, të prekin thellë në zemër:

*“Ata që më dëgjuan, le t’ua përçojnë fjalët e mia atyre që nuk ndodhen këtu. Mbase ata që nuk ndodhen këtu, i kuptojnë më mirë fjalët e mia se ata që ndodhen dhe po dëgjojnë”.*

Ata që ndodhen në haxh, duhet të mendojnë sikur këto fjalë janë një amanet për ta dhe kur të kthehen nga haxhi, duhet t’ua përçojnë ato edhe njerëzve të tjerë përreth. Kjo, sepse kështu vepruan edhe 125 mijë sahabët, të cilët shkuan në zemër të Azisë së Mesme, Afrikë, Andaluzi dhe Stamboll për t’i bartur këto fjalë në zemra dhe horizonte të reja.

Njeriu që bën haxhin, i hap krahët edhe drejt botës tjetër, duke e kthyer tunelin kohor nga e shkuara në të ardhmen. Dhe, duke u përpjekur të arrijë të fshehtën e vdekjes para se të vdesë, ai ka rastin të bëjë edhe provën e jetës tjetër.

Sheshi i Arafatit, duhet menduar si sheshi i Arafatit, ku (në botën tjetër) njerëzit do të mblidhen për të dhënë llogari para Allahut dhe, ashtu i mbështjellë me qefin të bardhë, duhet të përjetojë momentin e “ba’thu bade’l-meut”, ringjalljes pas vdekjes. Edukimi i vdekjes, e përgatit njeriun të vdesë si mysliman, sepse njeriu, ashtu siç jeton, ashtu do të vdesë. Dhe, ashtu siç vdes, ashtu edhe do të ringjallet. Qëllimi përfundimtar në këtë botë, është të vdesim si mysliman.<sup>9</sup>

Në shkollën e haxhit, gjatë kohës që është në ihram, njeriu ia ndalon vetes gjërat e mira dhe të lejuara, sepse ai po mëson nivelin më të lartë të edukimit të vullnetit. Për hir të Allahut, ai nuk i preferon as gjërat e mira dhe hallall; ai zgjedh vetëm kënaqësinë e Allahut. Me këtë, ai shpreh se, nuk i intereson kjo botë dhe krijesat e tjera jashtë Allahut.

9. Shih. el-Bekare, 132; Al-i Imran, 102.

Vështirësitë fizike dhe ekonomike të vendadhurimeve të haxhit, e orientojnë njeriun në pjekurinë dhe pastrimin shpirtëror.

Në Kur’an, Allahu i Madhëruar, ritet dhe elementet në lidhje me haxhin, si kodrat Safa dhe Merve, kurbanin dhe të tjera si këto, i cilëson si “sheair / shenja, simbole”<sup>10</sup> të Tija. Po ashtu, Allahu i Madhëruar shprehet se **“kush i madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”**<sup>11</sup>

Këto ajete dhe disa urdhra të haxhit, në një farë mënyre bartin kuptime simbolike. Në mënyrë të veçantë, gurëzimi i shejtanit, nënkupton gurëzimin e egos; qethja apo rrojçja, nënkupton shkëputjen e zemrës nga kjo botë; ndërsa kurbanin simbolizon egon, pra flijimin e kësaj bote dhe gjithçkaje tjetër jashtë Allahut. Tavafi përreth Qabes, të kujton njeriun e dashuruar, i cili vjen rrotull shtëpisë së atij/asaj që dashuron me shpresën që ta shohë. Në secilin prej urdhrave, ka një kuptim të thellë dhe urtësi të madhe. Këto urdhra dhe rregulla, gjatë gjithë haxhit, injektojnë tek njeriu ndjenja të larta në kuadër të edukimit.

Rregullat e ihramit, të cilat ndalojnë dëmtimin e kafshëve dhe bimëve të gjelbra, janë ligje hyjnore që edukojnë vetëdijen e mbrojtjes së ambientit të asaj lugine jopjellore dhe urdhërojnë mbrojtjen e ekuilibrit ekologjik.

Pasuria më e madhe në botë, është arritja e kënaqësisë së Allahut. Këto ia mëson njeriut shkollën e haxhit. Për të arritur suksese në këtë shkollë, duhet të jesh një nxënës i mirë, të kesh interes të madh dhe njohuri cilësore. Nëse përfitohet ashtu siç duhet prej shkollës së haxhit, njeriu arrin nivele të larta në procesin e jetës fetare dhe ndjenjat e devotshmërisë. Për të përjetuar një haxh i cili mbjell në zemra mallin për Qaben, edukimin për vdekjen dhe dashurinë për Pejgamberin (a.s.), është e nevojshme që ky adhurim të merr seriozisht. Kjo, sepse një haxh i mirë i cili merr seriozisht, i jep njeriut qetësi e lumturi në këtë botë. Ndërsa në botën tjetër, e bën atë të arrijë edhe kënaqësinë, edhe takimin me Allahun.

10. Shih. Bakara, 158; Maide, 2; Haxhxh, 32, 36.

11. Shih. Haxhxh, 32.



Ajnur Tutkun

# Martesa në botën moderne

Nëse vështrojmë rreth e rrotull, sa meshkuj mund të numërojmë që kërkojnë në internet apo lexojnë libra rreth martesës, rreth edukimit të fëmijëve dhe komunikimit me ta? Ose, teksa takohen me shokët e tyre, sa meshkuj flasin, këshillojnë dhe konsultohen me njëritjetrit rreth këtyre çështjeve? Në tubimet shoqërore meshkujt përgjithësisht quhen shpëtimtarët e botës, ndërsa gratë shpëtimtarët e folesë familjare. E thënë ndryshe, shtëpia, familja, fëmijët, shpenzimet familjare janë tema që përmbushin të përditshmen e femrave, ndërsa politika, puna, paraja, makinat janë tema që përmbushin të përditshmen e meshkujve.

Vallë! A duhet të vazhdojë kjo gjendje kështu? Nëse familja përbën thesarin e përbashkët edhe të gruas edhe të burrit, nëse edukimi i fëmijëve është përgjegjësi e të dyve, a nuk duhet që çështjet familjare të preokupojnë edhe meshkujt? Ja dhe zgjidhjet e dy bashkëshortëve në lidhje me problemet familjare: përgjithësisht gratë përpiqen me të gjitha mënyrat për të ruajtur dhe mbajtur në këmbë familjen, ndërsa meshkujt i japin fund lidhjes martesore me fjalën "nuk funksionon".

Meshkujt nga vetë krijimi i tyre nuk janë më të mëshirshëm se femrat. Për këtë arsye, ata në çështjet dhe

problemet familjare nuk mendojnë shumë për fëmijët. Ndërsa femrat, si shkak i mëshirës që i karakterizon, para se të hedhin ndonjë hap, gjithnjë vënë në plan të parë fëmijët duke menduar: "Po fëmijët, ç'do të bëhen?" Edhe nëse nuk ekzistojnë fëmijët, femrat nga ndjeshmëria që i karakterizon janë më të frenuara dhe nuk u bien vizë menjëherë çështjeve që i mendojnë.

Kohët moderne po i lehtësojnë gjithnjë e më shumë divorcet. Në ditët e sotme fenomenet si dobësimi i respektit dhe besimit mes bashkëshortëve, punësimi masiv i grave, nevojat e pafundme ekonomike, fenomeni i liri, përgjegjësia e pabalancuar ndikojnë shumë në shpërbërjen e familjeve.

Si shoqëri, teksa mendohe mi t'i edukojmë fëmijët si të pavaruar, nuk e kuptojmë se në të vërtetë i dëmtojmë ata. Fëmijët, të cilët rriten pa marrë ndonjë përgjegjësi mbi supe, mbeten gjithnjë "fëmijë". Duke u ripërsëritur fraza "aman le të studiojë", si vajzat ashtu edhe djemtë rriten në një liri të plotë. Madje, as që nuk mendohet t'u ngarkohet ndonjë përgjegjësi, porse edhe ushqimi, çaji, kafeja u serviret e gatshme nga prindërit. Ama, nuk duhet mënjanuar fakti se jeta e vërtetë nuk përbëhet vetëm nga shkollimi. Sepse në martesë vajzat do bëhen zonja shtëpie, ndërsa djemtë drejtuesit e

familjes. Vajzat që nuk kanë mësuar mirë të gatujnë, të pastrojnë, të hekurosin pasi diplomohen, punësohen dhe martohen, përballen me punët e shtëpisë dhe çështjet familjare, duke i përjetuar si një stres të vërtetë. Po ashtu edhe djemtë, duke mos zotëruar njohuritë dhe eksperiencën e mjaftueshme për drejtimin e familjes, jetojnë gjithnjë stresin dhe frikën e shpërbërjes së saj.

Djemtë dhe vjehrrat janë gjithnjë në kërkim të nuseve që punojnë, "nuse me rrogë", por harrojnë se si duhet të sillen ndaj tyre. Një burrë, i cili nuk ia ka haberin punëve të shtëpisë, gatimit, që është i paaftë të ndihmojë nënën e tij në çështjet shtëpiake, pas martesës nuk do të jetë i aftë të kuptojë pritshmëritë e gruas së tij, aq më tepër ta ndihmojë atë.

Moskonceptimi i qartë i "dëshirave" dhe "nevojave" ekonomike e vendosin familjen përballë një përgjegjësie të madhe. Sado të mendojmë se tostjerat, makinat e çajit, të kafesë dhe çfarëdolloj aksesori tjetër në kuzhinë, veshjet luksoze të kohës dhe, orenditë e panumërta shtëpiake lehtësojnë jetën e çifteve të sapomartuar, faktikisht e vërteta nuk është kështu. Kursimet e përbashkëta, përpjekjet reciproke për të realizuar nevojat dhe dëshirat ndikojnë shumë në bashkëpunimin mes partnerëve. Nëse arrijnë të ndajnë kënaqësitë, lumturinë, vështirësitë, mundimet, dhimbjet, atëherë njëri- tjetrin lidhen më shumë me njëri- tjetrin. Lidhjet e forta mes bashkëshortëve nuk arrihen duke u argëtuar apo ushqyer në filan apo filan restorant, por duke përballuar bashkë vështirësitë e jetës. Partnerët, të cilët duke mbështetur njëri- tjetrin mundohen të përballojnë problemet ekonomike, ata të cilët kursejnë sëbashku për t'u pajisur me ndonjë orendi të re shtëpiake, ata të cilët, duke mos fajësuar njëri- tjetrin për problemet në edukimin e fëmijëve diskutojnë së bashku për të gjetur një rrugëzgjidhje, padyshim që do të jenë më të lidhur me njëri- tjetrin.

Ndryshimet e normave edukative në shoqëri po e lehtësojnë gjithnjë e më tepër divorcin. Është shumë i gabuar fakti se pas çdo problemi që kemi me partnerin të mendojmë se në jetën e tij ekziston dikush tjetër.

Justifikimet e shumta si: "nuk më kuptonte, sillej kështu e ashtu me mua, më ka thyer krenarinë në atë pikë saqë...", janë sjellje që i shtyjnë partnerët të kërkojnë dikë tjetër. Nëse pas çdo përpjekjeje nuk është arritur të shpëtojmë nga divorci, atëherë duhet të kemi kujdes që në martesën tjetër të mos ndodhin të njëjtat probleme. Sa e shëmtuar dhe sflitëse e krenarisë është

tradhtia e burrit ndaj gruas, po aq e shëmtuar është edhe tradhtia e gruas ndaj burrit. Vendet e punës përbëjnë një "vendgjuajtjeje", si për gratë, ashtu edhe për burrat. Për këtë arsye, çdokush duhet t'i dalë për zot partnerit të vet, duke u munduar të mbrojë edhe veten edhe atë nga harami dhe rrugët që të çojnë drejt së ndaluarës.

Martesa do të thotë përgjysmim i lirisë dhe dyfishim i përgjegjësive dhe detyrave.

Ka të rinj që i japin fund fejesës me justifikimin se "dëshironte të dinte gjithnjë se ku jam".

Është e rrezikshme mes partnerëve ndjenja e mospërfilljes që mund të lindë nga koha e tepërt që kalojmë me shoqërinë si në beqari. Sigurisht që në martesë nuk do thotë të mos takohemi fare me ta, por duhet të balancojmë mirë kohën kur duhet menduar si "unë" e kur si "ne".

Në kohët moderne, në vend të shoqërisë konkrete mund të kemi edhe shoqëri imagjinare, si kompjuteri, interneti, televizori etj. Teksa merremi me mjete të tilla, që nganjëherë mund të mos jenë të dëmshme, por të dobishme, mund të lëmë pas dore nevojat fiziko-shpirtërore të partnerit dhe fëmijëve. Kështu soses durimi dhe familja fillon e shkatërrohet. Detyra e kryefamiljarit nuk është vetëm sigurimi i të ardhurave ekonomike. Sa i mangët është një burrë në sytë e gruas dhe fëmijëve të tij, i cili, sapo vjen nga puna, në vend që të bashkëbisedojë me familjarët, të luajë me fëmijët, të përpiqet t'i këshillojë ata për këtë dhe botën tjetër, ulet pranë kompjuterit, duke shkëputur çdo lidhje me ta. E njëjta gjë ndodh edhe me gratë; një veprim apo qëndrim i pakontrolluar në familje dhe në edukimin e fëmijëve përbën çështjen më kryesore, e cila cenon lumturinë familjare.

Një qëndrim i tillë: "ç'të duhet ty, veproj si të dëshiroj", nuk duhet pëlqyer as kur jemi të martuar, as kur jemi beqarë. Përveç detyrimeve dhe përgjegjësive që kemi ndaj familjes, vetes, shoqërisë, kemi padyshim edhe detyra dhe përgjegjësi përballë Krijuesit të Gjithësisë.

Në botën moderne, të martohesh dhe të qëndrosh i martuar kërkon më shumë përpjekje se në të kaluarën. Nëse në të kaluarën divorci ishte shumë i vështirë dhe konsiderohej si turp i madh, në ditët tona është më i lehtë, madje në një mënyrë quhet edhe si vetëbesim. Porse pasojat e divorcit më shumë i përjetojnë fëmijët. Në të vërtetë, të konsideruarit e divorcit si diçka normale dhe shtimet e shumta të rasteve të tilla përbën problemin më të rëndësishëm të mbarë shoqërisë.



# Shpella e Theurit dhe enigma e të qenit bashkë me Zotin



Dr. Vejsel Akkaja

Një nga tre malet e rëndësishëm në jetën e bekuar të Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), është edhe ai i Theurit. Teksa në malin Nur Pejgamberi (a.s.) u prezantua me thellësitë e halvetit dhe meditimit, në malin Theur bie në sy përballja me bukuritë e maturisë, altruizmit, përmallimit dhe gjendja e të qenit bashkë me Zotin.

Vizita e shpellës së Theurit, që gjendet në jug të Mekës së bekuar, duhet lexuar mirë. Ky është stacioni i parë i hixhretit, i cili shënon edhe një pikë ndryshimi në Epokën e Lumturisë. Nëse do të pyesnit njerëzit shpirtërorë, ata do t'ju këshillonin me ngulm viziten në malin dhe shpellën e Theurit për të ndërjerë atmosferën shpirtërore të Resulullahut (a.s.) dhe të Ebu Bekrit (r.a.). Kur këta dy miq, iu vunë rrugës së hixhretit. Ebu Bekri nganjëherë ecte përpara e nganjëherë mbrapa Resulullahut (a.s.). "Përse veprojnë kështu, Ebu Bekir?" – e pati pyetur i Dërguari i Allahut (a.s.). "O Resulullah, kur mendoj se mushrikët mund të të zënë nga mbrapa, ec mbrapa. Ndërsa, kur në mendje më shkon ndonjë kurth që mund të të kenë bërë përpara, ec para teje" – i pati thënë i shqetësuar. Kështu, këshillohet të ndihet shpirtërisht ky udhëtim.

Shpella e Theurit është një shpellë e përshtatshme për t'u fshehur. Në shpellë hyhet vetëm duke u zvarritur ose duke u përkulur. Përreth shpellës gjenden vrima, nga ku mund të vështrohet brenda. Ata që janë

brenda shpellës, mund të vërejnë këmbët e atyre që janë jashtë, por ata që janë jashtë, pa u përkulur mirë, nuk shohin gjë brenda.

Siç dihet, Ebu Bekri ishte gati të flijonte jetën e tij për Resulullahun (a.s.). Fillimisht hyri ai në shpellë. Brenda mund të kishte gjallesa të dëmshme. Në errësirën e natës pastroi shpellën nga brenda. Çdo pëllëmbë të shpellës e kontrolloi me dorë. Aty ku gjente një vrimë, e mbushte duke shqyer një copë të rrobës së vet. Mbeti vetëm një vrimë. Ngaqë nuk i mjaftoi rroba, aty vendosi këmbën e tij. Kur u siguria që kishte përgatitur një vend të sigurt, e ftoi të hynte të dashurin e Zotit, Muhamedin (a.s.).

Përpjekjen e Ebu Bekrit për ta bërë shpellën një vend të sigurtë, mistikët e quajnë "isar (sakrifikim i vetes për tjetrin, në këtë rast për më të dashurin)". Isari është një edukatë përtej bujarisë. Isari nuk bëhet vetëm me mallra. Sikurse në rastin e Ebu Bekrit, nxënësi që është besnik në nënshtrimin ndaj më të diturve, mund të sakrifikojë edhe jetën në rrugën e të vërtetës, që do të thotë se ai nuk duhet të druhet nga asgjë.<sup>1</sup>

Zemra është si shpella e Theurit. Me një edukatë siç kishte Ebu Bekri, mbyllen të gjitha vrimat ndaj edukatës së keqe dhe në këtë rrugë duhet shfaqur çdo lloj sakrifi-

1. Shih. Ismâil Hakkî Bursevî, Ferahu'-Rûh, III, 133, Mustafa Utku, Bot. "Uludağ", Bursa, 2002.

ce. Një zemër që nuk është në gjendje të përshtatshme, nuk duhet ta ftojë Pejgamberin (a.s.).

Kur kishte mbyllur të gjitha vrimat e shpellës, duke përdorur mundësitë që kishte, Ebu Bekri kishte vendosur këmbën tek vrima ku nuk i kishte mjaftuar rroba. Sipas disa transmetimeve, thuhet se e ka pickuar gjarpri në këmbë. Pejgamberi (a.s.), ngaqë ishte shumë i lodhur, e kishte vënë kokën e bekuar në gjurin e mikut të tij, Ebu Bekrit. Me gjithë dhimbjen që ndjente nga këmba, Ebu Bekri nuk lëvizi aspak. Mirëpo, i rrodhën disa lotë nga sytë në mënyrë të pavullnetshme dhe sapo ranë në fytyrën e Resulullahut (a.s.), u zgjua menjëherë. Pasi mësoi se çfarë kishte ndodhur, e preku gjuhën me gisht dhe si një ilaç e fërkoj vendin ku ishte pickuar. Pas pak, këmba e Ebu Bekrit u shërua tërësisht.<sup>2</sup> Kjo është kuptuar nga aspekti shpirtëror si të qenët në gjendje gatishmërie ndaj gjarprit të quajtur "nefs". Njeriu, edhe sikur të jetë "i shkrirë tek Resuli", duhet ta sigurojë veten nga nefsi. Kurrë nuk do të mbesin pa shpërblim mundimet që bëhen në rrugë të Pejgamberit tonë të dashur (a.s.).

Mushrikët ishin shpërndarë për t'i gjetur kudo këta "dy miq". Një grup, nën udhëheqjen e dy njerëzve të asaj zone, që njihnin shumë mirë gjurmët, erdhi deri tek hyrja e shpellës së Theurit. Ebu Bekri, të cilit nuk i trembej syri për asgjë për të mbrojtur të Dërguarin e Allahut (a.s.), i thoshte atij: "Sikur të vritem unë, jam vetëm një person, por nëse të ndodh gjë ty, shkatërrohet i tërë ymeti." Kur Pejgamberi (a.s.), po falte namaz, Ebu Bekri e ruante atë. Kur dëgjoi zhurmën e hapave, e shprehu në këtë mënyrë shqetësimin e tij: "Populli po të kërkon ty, Vallahi, nuk shqetësohem për veten time. Kam frikë se mund të të bëjnë dëm ty." I dërguari i Allahut (a.s.), tha: "Mos u mërzi, o Ebu Bekir, padyshim që Allahu është me ne." Allahu i Lartmadhëruar e shpjegon kështu:

**Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin a.s.), Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytën, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): "Mos u mërzi, se Allahu është vërtet me ne!" Atëherë, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh) dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse Fjala e Allahut të jetë më e lartësuar. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.** (Teube, 40)

Burseviu e shpjegon kështu shprehjen që kalon në ajet **"Allahu është vërtet me ne"**: "Ndihma dhe mbrojtja e Tij është me ne". Sipas tij, ajo çfarë thuhet për të qenit bashkë, shenjon makamin e "vilajetit", në të cilin nuk arrin asnjë shqetësim ose mërzi.<sup>3</sup> Në tefsirin e Sulemiut, transmetohet se Ibn Ata ka thënë në lidhje me këtë ajet: "Mërzia nuk mund të jetë e pranishme në

atë që është me Allahun".

Resulullahu (a.s.), në hadithet e tij, ka lidhur pastrimin e nefsit dhe lartësinë e imanit me "vetëdijën e të qenit gjithnjë me Allahun".<sup>4</sup>

Ataullah Iskenderi jep një shembull, i cili e bën edhe më të shkoqur çështjen: "Një fëmijë po ecte natën me të atin. Për një moment e humbet të atin. Frikësohet shumë. Ashtu i trishtuar ecën përpara, pa ditur se ç'të bëjë. Në fakt, i ati është fshehur për ta sprovuar atë dhe e ndjek gjithnjë. Pas pak, largohen retë në qiell. Hëna me ndriçimin e saj, ndrin përreth. Fëmija sheh përreth dhe më në fund e vëren të atin. I kalon frika dhe nis të ndihet i sigurt, sepse tashmë është i bindur se i ati e ndjek atë dhe është pranë gjithnjë..." Ataullah Iskenderi thotë se ai, në zemrën e të cilit lind hëna e tevidit apo dielli i marifetit, do të shohë se është duke ecur bashkë me Allahun.<sup>5</sup>

A. Avni Konuk, thotë se të qenët bashkë me Allahun e Madhëruar arrihet në dy mënyra: e para është "të qenit bashkë në mënyrë të përgjithshme", pra gjendja e të qenit si të gjitha krijesat bashkë me Allahun. Dhe "të qenit bashkë në mënyrë individuale". Konuku, duke kujtuar hadithin "Njeriu është bashkë me atë që do", na bën të ditur se të qenët bashkë në mënyrë individuale realizohet me dashuri dhe dashuria realizohet përmes ndjekjes së Resulullahut (a.s.), pasi në ajet thuhet: **Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua."** (Al 'Imran, 31)<sup>6</sup>

Le t'i kthehemi temës sonë. Kur iu afruan mushrikët shpellës, panë se merimanga kishte vënë rrjetën e saj dhe dy pëllumbat kishin krijuar follenë, kështu u larguan pa e ndjerë të nevojshme hyrjen brenda.

Burseviu, duke u nisur nga jeta që iu dha "dy miqve" të shpellës, na kujton se duhet t'i kërkojmë Allahut jetë dhe ndihmë në prishjen e planeve të armiqve që gjenden jashtë dhe brenda nesh. Le ta përfundojmë shkrimin tonë me një dua, duke përfituar nga atmosfera e kësaj ngjarjeje:

Allahu ynë! Ashtu sikurse, me gjuhën e të Dashurit tënd, kur Ebu Bekri u shqetësua, i the: **"Mos u mërzi, se Allahu është vërtet me ne!"**, mos na lër të vetëm as ne në shpellën e mërzisë! Ashtu sikurse të Dashurin tënd e mbrojte, duke bërë perde rrjetën e merimangës, na mbro edhe ne nga e keqja e të ligjve, mos lejo të na përtypin ata! Për hatër të emrit Tënd "es-Selam", mos na lër të vuajmë në zjarrin e ndarjes!<sup>7</sup>

4. Shih. Bejhakiu, Shuabu'l-Imân, I, 470 dhe III, 187.

5. Shih. Atâullah Iskenderî, Tevekkülün İncelikleri, përkth. turq. Fatih Mehmet Albayrak, 218-219, İstanbul, 2006.

6. Shih. Mevlânâ, Mesnevî-i Şerif Şerhi, përkth. Şerh A. Avni Konuk, përgt. Mehmet Demirci, Süleyman Gökbülüt, Mustafa Tahralı, İstanbul, 2008, IX, 259.

7. Bursevî, Ferahu'r-Rûh, III, 140.

2. Shih. M. Hamidullah, İslâm Peygamberi, I, 174-175.

3. Bursevî, Rûhu'l-Beyân, VII, 357, Erkam, İstanbul, 2006.

# VIRTYTI I KURBANIT

All Byjyçapar

Ditët e pastrimit të ndryshkut, që krijohet me kalimin e kohës, janë pikërisht ditët e Bajramit. Fryma dinamike e Bajramit ndikon në tjetërsoimin e rutinës së njeriut.

Bajramet përmbajnë ngjalljen e shpresave të reja.

Besimtarët që janë mbledhur në Arafat nga katër anët e botës, duke iu bindur urdhrat të Allahut, ndërkohë që bëjnë provën e mahsherit, në zemrat e tyre ndjejnë thirrjet e Ibrahimit. Të njëjtat sprova që ka kaluar dje Ibrahim, i presin edhe Ibrahimët e sotëm, duke hapur zemrën për të zgjidhur kuptimin e ekzistencës, për të përvetësuar sekretet e jetës. Dëshirat e idhujtarizuara duhen prerë me shtatën e tevhidit, duhet zbuluar e vërteta e thelbit të qenies.

Atëherë, kur kalohen një nga një fazat e rrugëtimit

të imanit, që nisin me interesimin, dyshimin, hamendësimin dhe në fund me besimin, duke qendruar gjithnjë nën ylberin e udhërrëfyesve të vërtetë, zë të dalë filizi i të qenit njeri i përkushtuar ndaj Zotit.

Këto ditë janë ditët e Ibrahimëve.

Nëse qenia futet në forma materiale, atëherë arrin në përfundime të dhimbshme. Nëse struktura materiale përjetohet në këtë ditë me perceptimin e përtejshëm, rërat e shkretëtirave do ta shfaqin zemzemin që mbajnë në gjirin e tyre dhe kështu, faktorja e shenjtë do të bëhet vendi i adhurimit të Zotit.

Ndërkohë që Ibrahim (a.s.), Haxheri (a.s.), dhe Ismaili (a.s.), fituan përjetësinë nëpërmjet përballjes me sukses të sprovave, ne si mund të mendojmë për veten se do të

a j o

mund t'ia dalim pa u lagur? Ku është që pranohet si e shenjtë në kohët moderne? Është kusht që, sikurse Haxherja, të interpretojmë fshehtësinë e të qenit në botë. Ata që e ndjejnë si një rënkim në zemrën e tyre shprehjen: "Në dorën e kujt po na lë amanet, që po ikën?", do të merren brenda në prag të Bajramit.

Kurbani është nënshtrimi.

A nuk janë Bajramet stacionet e ndër-mjetme të udhëtimit të pafund, që formojnë në shportën e virtytit idenë e ligjit dhe parimin e rendit?

Kur do të kuptojnë se janë mashtruar ata që kanë bërë bazë të sistemeve të arsimit fatkeqësinë e të vazhduarit të konceptit sikur gjithçka ekizton rastësisht, duke u lavdëruar me anarkinë?

Gabuan ata që hamendë-



suan se do të shkonin bosh zërat që ngriheshin në qiell nga Arafati. Padyshim, gjithnjë ekziston një përgjigje plot mëshirë ndaj atyre lutjeve dhe akoma vazhdon të jepet përgjigje.

Në fakt, vlerat që i ka shtuar feja jetës sonë është lumturia e të qenit qenie. A mund të ketë ndonjë ibadet tjetër përveç Haxhit, që njeriut të mbetur në një vend t'i japë mundësinë e udhëtimit për të dëshmuar urtësinë e Allahut, duke i hapur dritaren e sipërfaqes së tokës? Në hadith thuhet: *"Nuk ka ditë më të larta tek Allahu, sesa dhjetë ditët para kurbanit. Ato ditë përkujtojeni shumë Allahun e Lartmadhëruar."*

Sekreti i jetës është të kujtosh Allahun.

Ata që nuk kanë gjetur mundësi të përmendin, për arsye të kontaktit me shqetësimin për furnizim dhe pëshpëritjet e pushtetit djallëzor, në ditët e bajramit, sado pak qoftë, do të qëndrojnë kokë më kokë me vetveten, do të kujtojnë se përse janë krijuar, duke gurrëzuar shejtanët dhe duke bërë kurban në prani të Allahut pasionet dhe epshet.

Le të jemi pranë Allahut.

Atëherë, kur qenia jonë të mbushet me ëmbëlsinë e besimit tek Zoti i Madhëruar, edhe përkushtimi ynë ndaj Allahut do të ëmbëlsohet, do të hapen perdet e krijimit dhe do të na shfaqet Xhemalull-llahu!

Ja na erdhi Bajrami!

Me dhjetëra mijëra haxhinj në tokat e shenjta, duke thënë *telbije*-të, vendosën kokën në sexhde me virtytin për t'u bërë robër të Allahut dhe i shprehën mirënjohjen dhe respektin Allahut të Madhëruar. Ai vend, drejt të cilit drejtohemi pesë herë në ditë, është bërë arenë e lloj-lloj skenave, që nga dita që ka nisur të jetë njeriu mbi këtë tokë e gjer më sot. Ibrahim i lëviz nga Palestina dhe shkoi gjetkë, ishte në kërkim të vazhdueshëm të gjurmëve të të vërtetave, kurrë nuk i neglizhoi mjetet për të mbërritur tek Ai. Ai duhet të kalonte në stadtet e Sarës, Haxheres, Is'hakut, Ismailit, majat e maleve, kurbanit, thikës që tentoi të priste dhe mbështetjes te Zoti; të gjitha këto u manifestuan vetëm te Ibrahim dhe ai e vërtetoi se ishte rob i Allahut.

*Ç'ndodhi me këtë zemër, ç'ndodhi?*

*M'u mbush me shqetësim e lëndime,*

*U dogj kjo zemër, u dogj*

*Dhe, mu te djegia gjeti shërim!*

(Haxhi Veli Bajrami)

Kemi nevojë për gëzime të përbashkëta!

Vjen një ditë dhe jeta që bëjmë kthehet në rutinë. Atëherë fillon të na duket koha shumë e gjatë dhe jetën fillojmë ta perceptojmë si sofa e ujçërve. Kur shohim në mënyrë frontale botën, vërejmë pushtetin e më të for-

tit, atëherë vërejmë që ndërgjegjja jonë ndihet keq. Eza-ni që këndohet, namazi që falet, përgatitja për Bajramin u jep jetë zemrave dhe i shpie ato në pragjet e shenjta.

Vazhdimisht duhet të zbulojmë qenien.

Jeta jonë, që është e mbushur plot me dëshira të njëpasnjëshme, duhet t'ia nisë nga dhurimi për të arritur prehjen. Vetëm atëherë kur t'ia dorëzojmë Allahut pasurinë dhe mundësinë tonë, hualli i virtyteve do të mbushet me Hakun dhe, do të shfaqet e fshehta e harmonisë mes të kundërtave.

Kurbani është etaloni i harmonisë sociale.

Sa gëzim i madh është urdhri hyjnor, për çdo musliman që qëndron rigoroz ndaj kushteve: **"Andaj, falu vetëm për Zotin tënd dhe bëj Kurban."** (Keuther, 2.). Po ashtu edhe fjala e Pejgamberit (a.s.): *"O njerëz! Pjesëtarët e familjes e kanë të obliguar (vaxhib) që të bëjnë kurban çdo vit."*




Feja islame ka bërë, që të mund të takohen dëshirat me realitetet e jetës, ka puqur thelbin me formën dhe ka bërë që edhe sjelljet të jenë në kategorinë e veprave të mira fetare.

Jeta është një dhuratë që ia vlen t'i kushtohet rëndësi.

Këto kohë, që janë të rrethuara me dallgët e dashurisë, sjellin njëherazi edhe begatitë hyjnore, gjallërohen vlerat, si: solidariteti, humanizmi, vizitat, interesimi, vajtja në varreza dhe dhurimi. Po ashtu edhe respekti për të rriturit, dashuria për të vegjlit, dhembshuria për të sëmurët, mëshira për jetimët dhe ndihmesa për të varfrit.

Me rastin e Bajramit, duhet të kemi përgjigje për t'u dhënë mentaliteteve që mohojnë të vërtetat e natyrshme. Jeta është e vyer, atëherë kur i përkushtohesh Allahut, qenia është manifestimi i emrave të Tij.



# Të duash Pejgamberin (a.s.)

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Në kaptinën "Menakib" të "Mishkatu'l-Mesabih", në hadithin me numër 6284, transmetohet prej Ebu Hurejres (r.a.), se Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

*"Një pjesë prej umetit tim, që më do shumë, janë ata që do të vijnë pas meje dhe do të dëshirojnë të më shohin duke sakrifikuar familjen dhe pasurinë e tyre." (shih. Muslim, Xhennet, 12.)*

## VËZHGIM

Çdo vit që kalon, po vëmë re se aktivitetet që zhvillohen në kuadër të Ditëlindjes së Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), kanë fituar një nivel të kënaqshëm, qoftë si shfaqje, qoftë si përmbajtje dhe qoftë si pjesëmarrje. Veçanërisht, botimet e ndryshme dhe përpjekjet që bëhen në këtë drejtim për shtresat e ndryshme të shoqërisë, shprehin një zhvillim pozitiv për sa i përket njohjes dhe rritjes së vetëdijes së popullit. Në këto aktivitete, myslimanët testojnë devotshmërinë, ndjenjat ndaj Pejgamberit (a.s.), mendimet dhe sjelljet e tyre. Për rrjedhojë, të gjithë gjejnë mundësinë për t'i rregulluar ato dhe për të rishikuar marrëdhëniet e tyre me Pejgamberin (a.s.). Lotët që derdhen, buzëqeshjet, shfaqjet e entuziazmit dhe duatë që bëhen me zë të lartë në shenjë kënaqësie nëpër sallat e këtyre programeve, kanë të gjitha cilësinë e një "kërkese për mëshirë". Kjo lëvizje që vihet re në këtë fushë, padyshim që do të sjellë me vete edhe begatinë e saj.

## "JE NË ZEMRËN TIME TË VOGËL"

Gjatë një konkursi të poezisë me rastin e Ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), një vogëlush i shkollës fillore reciton një poezi kushtuar Pejgamberit (a.s.), në një varg të së cilës thuhet: **"Nëse pyet tokën, je në zemrën time të vogël!"**. Kjo strofë u bë pasqyrimi i mendimeve të të gjithë atyre që ishin në sallë. Kjo kuptohej nga lotët dhe furtuna e duartrokitjeve që shpërthyen në sallë. Fjalja, **"Je në zemrën time të vogël"**, i kishte shumë hije atij vogëlushi, që ishte ende në shkollën fillore.

Sa herë që e kujtoj, ndjej një mahnitje të çuditshme dhe admirim për ato pak fjalë dhe them me vete: "Ah sikur të kisha mundësi t'i thosha edhe unë ato fjalë me pastërtinë e zemrës së atij fëmije: **"Je në zemrën time të vogël"**

## "KJO DASHURI NUK ËSHTË NJË SHPREHJE E THATË"

Indikuar nga kjo ndodhi dhe duke marrë shkas prej lajmit të mirë që na ka dhënë hadithi i mësipërm, mendoj se do të ishte me vend të theksonim disa pika.



Para së gjithash, edhe pse ky hadith nuk e arrin gradën e haditheve të tjerë, që fillojnë me fjalët e sahabëve: **“Të qofshin falë nëna dhe babai im!”**, prej tij kuptojmë se do të ketë njerëz të tillë të dashuruar pas Pejgamberit (a.s.), që do të sakrifikojnë familjen dhe pasurinë e tyre për ta parë atë. Kuptimi i kësaj është se zemrat e mbushura me dashuri për Pejgamberin (a.s.), nuk janë të kufizuara me Epokën e Lumturisë, por ka mundësi që edhe pas shumë viteve, madje edhe pas shumë shekujve **“të jesh prej atyre që e duan shumë atë”**. Ky konstatim dhe lajm i mirë, është deklaruar nga vetë Pejgamberi (a.s.), si një privilegj i veçantë për ume-tin e tij.

### Dashuria kërkon pasim

Në këtë pikë, na duhet të kujtojmë edhe këtë të vërtetë: Dashuria, e cila reflektohet në fjalët, **“Të qofshin falë nëna dhe babai im!”**, e tregonte veten në sjelljet e sahabëve fisnikë, të cilët përpiqeshin të pasonin dhe t'i përshtateshin Pejgamberit (a.s.), në çdo çështje. E thënë ndryshe, dashurinë e tyre ata e shprehnin me pasimin e Pejgamberit (a.s.). Kjo, sepse ata ishin të vetëdijshëm ndaj faktit, se: **“el-Mehabbetu ala kadri'l-mutabea kema enne'l-mutabeate ala kadri'l-mehabbe - Dashuria e vërtetë është në përpjesëtim të drejtë me pasimin e atij që do. Ashtu sikurse edhe pasimi është në përpjesëtim të drejtë me dashurinë.”**

Kjo tregon, jo vetëm dashurinë e madhe të sahabëve ndaj Pejgamberit (a.s.), por edhe vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në këtë dashuri. Pra, pasimi i sunetit është edhe tregues i ndjenjës së dashurisë ndaj Pejgamberit (a.s.). Ata që do të dëshirojnë të shohin Pejgamberin (a.s.), duke vënë në rrezik familjen dhe pasurinë e tyre (pra, çfarë kanë e nuk kanë), janë ata të cilët dallohen në pasimin e Pejgamberit (a.s.).

Pretendimet e tjera jashtë këtyre janë të dënuara të mbeten thjesht pretendime boshe. Dashuria, nuk është thjesht ndjenjë dhe fjalë, por ndjenjë dhe veprim. Ashtu siç thotë edhe poeti: “Kjo dashuri nuk është një shprehje e thatë”.

### NDIKIMI I KURANIT

Shkaku kryesor që umeti i Muhamedit (a.s.), është më superior prej umeve të tjera, qoftë në cilësi, qoftë në numër, tregohet në një hadith fisnik, që ndodhet në kaptinën “Fedail ue Shemail” të librit “Mishkatu'l-Mesabih”:

*“Çdo pejgamberi, i janë dhënë mrekulli, me anë të të cilave ata vërtetonin pejgamberinë e tyre vetëm për njerëzit e kohës së tyre, në rast se ishin të detyruar. Ndërsa, mrekullia që më është dhënë mua, është libri (Kurani i cili përfshin të gjitha kohërat), që më shpalli Allahu. Për këtë arsye, unë shpresoj se në Ditën e Kiametit do të jem pejgamberi që do të ketë më shu-*

*më umet (se të gjithë pejgamberët e tjerë)”* (Buhari, Fedailu'l-Kur'an 1; Muslim, Iman 239; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 341, 451.)

Është e qartë se Kurani Kerim është një mrekulli me një ndikim që zgjat deri në Ditën e Kiametit. Cilësia e shpalljes për të cilën bëhet fjalë, përfshin veçantinë e mrekullisë së Kuranit, superioritetin e rrënjëve të identitetit të myslimanit, vlerën dhe paarritshmërinë e tij, universalitetin dhe çdo lloj vlere tjetër të tij. Prandaj, të pasosh Kurandin, do të thotë të jesh i vetëdijshëm për të gjitha këto cilësi të larta dhe të arrish të kuptosh vlerën e njeriut dhe të Islamit. Për këtë arsye, pika më e fortë mbështetëse e shpresës “për të qenë Pejgamberi me më shumë umet”, është cilësia e veçantë e shpalljes së Kuranit Kerim. Ky hadith fisnik është një thirrje indirekte ndaj myslimanëve që të shtojnë përpjekjet e tyre për t'ia bërë të njohur të gjithë botës Kurandin Kerim, me qëllim që cilësitë e tij të veçanta dhe fuqia e tij ndikuese t'i përfshijë edhe ata.

Kjo shpallje (Kurani), e cila përbëhet nga shprehje të përmbledhura, ka si shpjegues disa shprehje të tjera (sunetin) me cilësi përmbledhëse dhe universale. Dhe këto dy vlera janë në të njëjtën linjë dhe të përshtatshme me njëra-tjetrën. Si përfundim, zemra dhe identiteti i myslimanit, nën ndikimin e karakterit të shpalljes dhe në përpjesëtim të drejtë me pasimin e saj, do ta mbrojë edhe ekzistencën e vet edhe identitetin islam.

Meqenëse Kurani Kerim ka një ndikim të vazhdueshëm dhe rrënjësor në dashurinë dhe pasimin e Pejgamberit (a.s.), atëherë edhe Kurani Kerim, edhe Pejgamberi (a.s.), si burim dashurie, duhet të kenë një vend të veçantë dhe të pandashëm në zemrat e myslimanëve. Prandaj, të flasësh për një dashuri pa Muhamed (a.s.) dhe për rrjedhë, për dashurinë ndaj Kuranit, është vetëm një pretendim i thatë dhe i pakuptimtë.

### GARANCIA E SHPËTIMIT

Muhamedi (a.s.), është i pari që do të trokasë në portën e xhenetit<sup>1</sup> dhe po ashtu është i pari të cilit do t'i hapet ajo portë<sup>2</sup>. Prandaj, përpjekja për t'u bërë një individ i umetit që e do atë, është garancia më e madhe për të arritur lumturinë e xhenetit së bashku me të. Të përpiqesh të ndjekësh me dashuri dhe sinqeritet prijësin tonë në këtë botë dhe garancinë e shpëtimit tonë në botën tjetër, duke marrë parasysh sakrifkimin e gjithçkaje që kemi, përbën pikën më kulminante të kësaj çështjeje. Kjo, sepse “Njeriu është së bashku me atë që do”<sup>3</sup>. Dhe treguesi më i mirë i dashurisë ndaj Allahut, është pasimi i Pejgamberit (a.s.)<sup>4</sup>.

1. Shih. Muslim, Iman 331.

2. Muslim, Iman 333.

3. Shih. Buhari, Edep 96; Muslim, Birr 165.

4. Shih. Al-i Imran (3), 31.

M. Ali Eshme

## Zgjidhja për ndihmën e individit, shoqërisë, umetit dhe njerëzisë është në përsëritshmëri

Kurdo që njerëzimi i është nënshtruar materiales dhe dëshirave vetjake, është bërë mizor. Është bërë përbindësh. Ka ndarë me shejtanin të njëjtin rol. Madje, ka shkuar edhe më tutje. Doli një Nemrud dhe tha: **“Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje”**. (Bakara, 258) Doli një Faraon dhe: **“Tuboi njerëzit e u deklaroi: ‘Unë jam zoti juaj më i lartë!’** (Naziat, 23-24) Doli një Karun dhe tha: **“Kjo (pasuri) më është dhënë vetëm prej diturisë sime”**. (Kasas, 78).

Njerëzit e tillë kanë bërë krime të papara. Kanë bërë gjëra të paqena. Kanë humbur në kanalizimet e krimeve. U bënë dredharakë dhe mosmirënjohës. U falsifikuan dhe u implikuan në ligësi. U bënë komisionarë. Dredhinë dhe mashtrimin e bënë profesion. Vazhdimisht bërtitën, bënë ngatërresa, u zunë, u munduan dhe u përpëliten të bëheshin të vlefshëm dhe sundues. Çdo gjë e harxhuan. Pohuan se ishin zota. Pohuan se ishin profetë. U tërbuan kur nuk e arritën atë që dëshironin. U mburrën, u bënë mendjemëdhenj, u krenuan dhe u hoqën si të mëdhenj me ato që bënë. Për hir të kësaj bënë çdo lloj padrejtësie dhe barbarizmi. Allahu i Madhëruar thotë për ta: **“Pikërisht këta janë ata që kanë këmbyer udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia nuk u sollti kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë.”** (Bakara, 16) Sytë e tyre u verbuan kundrejt dritës dhe veshët u shurdhuan. Secili prej tyre u zvogëlua gjithnjë e më shumë. U poshtërua gjithnjë e më shumë. U bë zero. Dikush u bë topall, dikush tjetër u bë si grerëz. Dikë e përpiu toka e dikush u mbyt në ujë. Jeta e tyre e shkujdesur dhe larg nga Zoti e nënshtrimi ndaj Tij, u shkaktoi atyre tragjedi në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata që i panë me syrin e marrjes mësim, ia vunë gishtin kokës.

Ndërsa, ata që nuk i panë apo që harruan, përsëritën të njëjtat gabime. Tani edhe bota që po globalizohet, po bën përsëri të njëjtat gabime dhe po rishfaq injorancën e vet të fëlliqur. Siç ishin të poshtrit e djeshëm, ashtu janë edhe të sotmit. Ata janë larg Rrahmanit dhe afër shejtanit. Larg drejtësisë e mëshirës dhe afër padrejtësisë e poshtërimit. Larg përsëritshmërisë e humanizmit dhe afër idhujtarisë e barbarizmit. Larg shpëtimit e qetësisë dhe afër humbjes e ndëshkimit.

Përderisa njeriu privohet nga cilësitë dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm fatkeqësi. Prandaj ndodhin kaq shumë turbullira dhe ngjarje tragjike, që s'kanë fund për individin, familjen, shoqërinë dhe popullin. Fatkeqësitë shkatërruese që ka shkaktuar mendimi se i drejtë është ai që ka fuqinë, po shfaqen në çdo vend të botës. Çfarë nuk shkatërrojnë sulmet, barbarizmat e pafundme, padrejtësitë dhe tiranitë e atyre, që sa më shumë të pasur të jenë, aq më shumë janë të privuar nga përsëritshmëria! Rezultati i këtyre në botën islame që prej dyqind vjetësh është shkatërrim i historisë, i civilizimeve, i bibliotekave, i monumenteve, vrasje e foshnjave dhe e nënave, vatra të rrënuara dhe shtëpi të djegura. Të gjithë po klithin: Njeriu ka nevojë për edukim. Ka nevojë për edukim fetar, jo për edukim që i nënshtrohet djallit dhe nefsit. Ka nevojë për një edukim hyjnor, që do ta bëjë atë ta përjetojë humanizmin sipas rregullave qiellore. Ky edukim është disiplina dhe mësimi shpirtëror. Pra, edukimi mistik i Islamit. Sepse ky edukim i ka gjuhëzuar përpara Allahut Teala edhe sulltanët më të fuqishëm të kësaj bote dhe i ka bërë ata të jetojnë jo si dhunues kundër popullit të tyre, por si personalitete monumentale të mëshirës ndaj tyre.

Në sajë të tyre, kjo botë dëshmoi shekuj plot mëshirë, drejtësi dhe qetësi. Ligësitë nuk u përhapën dot dhe muret e mirësisë e të mëshirës nuk u shkatërruan. Por siç zhyten dhe e sulmojnë mikrobet shëndetin e njeriut sapo të gjejnë mundësinë, edhe ata që përbëjnë palën negative në sipërfaqen e kësaj bote, si domosdoshmëri e sprovës hyjnore, gjithmonë e zvarrisin njerëzimin në shkatërrim sapo t'u jepet mundësia.

Sulmet më shkatërruese të këtyre mikrobeve janë qasjet që shfaqen sikur ndjekin rrugën e Zotit (xh.xh.), por që përpiqen ta bëjnë njeriun një krijesë komplet materialiste duke ia prishur orientimin shpirtëror. Veçanërisht, ato qasje që janë armike të përshtatshmërisë.

Kjo ndoshta është normale kur e bëjnë femohuesit, por sa e dhimbshme dhe sa humbje e madhe është kur edhe disa dijetarë të shkujdesur, që konsiderohen besimtarë, marrin pjesë në të njëjtin rresht të armiqtë ndaj fesë që kanë jobsimtarët. Mbi të gjitha, fatkeqësi e madhe është edhe përdorimi i argumenteve fetare për ta tharë dhe për ta shkatërruar orientimin shpirtëror të njeriut. Kthimi i njeriut në ateist, duke i thënë se ky është besimi i vërtetë, është diçka shumë tradhtarë. Një pyetje duhet të bëjmë: Përpjekja për të shkatërruar devotshmërinë, edukatën, gnosën dhe përshtatshmërinë sublime që Islami dëshiron të ndërtojë te njeriu, është një dije miqësore me zemër të hapur apo një armiqtësi e fshehtë me zemër të ngurtë? Është një punim akademik i pranueshëm apo një aktivitet injorance dhe disfatizmi? A është edukim shkatërrim i besimit të nxënësit e i ndërtesës së jetesës së tij me dinamitin e dyshimit të pavend? Përpjekjet si sëpata të mprehta, që këpusin lidhjen e vogël të një brezi që e ka kthyer në një pe pambuku besnikërinë që ka ndaj Allahut dhe Pejgamberit si rezultat i atyre që kanë bërë femohuesit, është nxjerrje në pah e së vërtetës apo njohje dhe përfaqësim i saj?

Çfarë shpreh mendimi për të copëtuar timonët për shkak të një shoferi të paaftë apo mendimi për të shkatërruar mihrabët për shkak të një imami që gabon apo mendimi për shfarosjen e lapsave dhe letrave për shkak të një pikturë të bërë keq? Kjo është shumë e lehtë për t'u kuptuar. Prandaj sot ka më shumë nevojë për përshtatshmëri. Devotshmëria, siç ka qenë gjithmonë, përsëri është shumë e dobishme. Veçanërisht për botën akademike. Përndryshe njeriu largohet nga Allahu Teala sado dije të ketë. Largohet siç është larguar shejtani. Shkaku i vetëm i këtij largimi është egoizmi. Egoizmi si kancer shpirtëror, është kusht që duhet të eliminohet. Prandaj, kjo çështje në tasavvuf është prej

temave bazë të edukimit të njeriut, sepse egoizmi është një grip i shejtanit, që e pengon njeriun t'i afrohet Allahut të Lartësuar. Djallin, edhe pse kishte kaq shumë dije, e shkatërroi mikrobi i egoizmit. Për këtë arsye, edukimi shpirtëror i rregulluar me dispozitat e Allahut të Lartësuar, është bërë një urdhër dhe edukim hyjnor, që e nxjerr nga jeta dhe zemra çdo lloj egoizmi negativ dhe të gjitha ndikimet e këqija të tij.

Vepra që e shpreh më qartë këtë është kurban, sepse kurban nuk është vetëm çështje e therjes së kafshës. Kurban ka aspektin e edukimit hyjnor, që përjetohet para therjes së kafshës. Kurban përfaqëson flijimin e egoizmit. Kur bëhet kurban për Allahun Teala, do të thotë se nefsi, pasuria, jeta dhe fëmijët nuk mund ta zënë vendin e Zotit (xh.xh.), në zemër. Këto duhet të bëhen kurban për Allahun e Madhëruar në thellësitë e zemrës, në mënyrë që të mos bëhen idhuj. Sepse çdo gjë që nuk mund të bëhet kurban, domethënë, çdo gjë që nuk mund t'i dorëzohet të zotit të saj, do të thotë se është bërë idhull i zemrës. Kjo është e vlefshme për dijen, për fëmijët, për pasurinë, për jetën dhe për çdo gjë tjetër. Për këtë arsye, Allahu, xhelle xhelaluhu, këtë amanet, që faktikisht duhet të kryhet shpirtërisht, e ka urdhëruar edhe në praktikë, në mënyrë që ta kuptojë e gjithë njerëzia. Kështu, e ka bërë të qartë dhe të kuptueshme të vërtetën dhe urtësinë e kësaj çështjeje. Njerëzit duhet ta perceptojnë këtë.

A e urdhëron Allahu njeriun që të therë fëmijën e tij? E urdhëroi nën kontrollin e Tij. A mund ta zbatojë njeriu këtë urdhër? Nëse e urdhëron Allahu, sigurisht po, sepse Allahu i Madhëruar është Ai që ia mundëson njeriut zbatimin e urdhrit të Tij. Ndërsa rezultatin e realizon jo sikur duket apo pritët, por sipas vullnetit të Tij të lartë. Ja pra, për të zbatuar këtë urdhër hyjnor, Ibrahim i çoi birin e tij, Ismailin në vendin ku do ta bënte kurban. Sipas transmetimit, Ismaili (a.s.), më së shumti ishte trembëdhjetë vjeç. Babai i tij e shtriu përtokë me dhembshuri. Ia vuri thikën në fyt. Në ato momente Allahu urdhëroi dhe thika nuk preu. Domethënë, Allahu Teala e urdhëroi Ibrahimin: "There birin tënd për ta bërë kurban për Mua!" Ndërsa thikën e urdhëroi: "Ti mos e prit!" Në këtë mënyrë, therja u realizua vetëm në botën e brendshme të Ibrahimit dhe të Ismailit. Xhebraili erdhi dhe i gjeti të habitur babë e bir. Me vete kishte një dash që e kishte sjellë nga xheneti. Atyre u dha përgëzimin e Allahut Teala. Dhanë tekbiere dhe e bënë dashin kurban.

Allahu i Lartësuar e lavdëron Ibrahimin (a.s.), në Kur'anin Fisnik, duke u shprehur: **"Ibrahimi, i cili ishte shumë besnik (i cili shfaqti besnikëri ndaj premtimit)..."** (Nexhm,



37) Po ashtu, shpreh edhe vlerësimin dhe urimin hyjnor, duke thënë: **“Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. ‘Paqja qoftë mbi Ibrahimin!’ Ja, kështu, Ne i shpërblejmë të devotshmit. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.”** (Saffat, 107-111) Domethënë, synimi i Allahut Teala që e urdhëroi Ibrahimin (a.s.), për të therur birin e tij, nuk ishte urdhër që një baba të therte fëmijën, por ishte therja e çdo dashurie provizore që ai baba kishte në zemër përveç dashurisë ndaj Allahut të Madhëruar. Qoftë edhe dashuria ndaj fëmijës. Edhe synimi në urdhrin që i tha Ismailit: “Afroje qafën te thika!”, nuk ishte për ta therur atë, por për ta bërë që ta perceptonte të vërtetën se ajo që i përket Allahut (xh.sh.), nuk mund t’i përkasë dikujt tjetër. Madje, e bëri ta perceptonte me anë të babait të tij. E gjithë çështja është të mos i bëjmë idhuj dhe të mos biem në një gjendje që të mos duam t’i kthejmë prapa amanetet që na ka dhënë Allahu Teala. Të mos e bëjmë idhull qoftë edhe jetën, fëmijën apo pasurinë. Në këtë mënyrë, të përjetojmë besnikërinë dhe dashurinë e kthimit prapa të çdo amaneti te Zoti (xh.xh.). Ajo që dëshiron edhe Allahu i Lartësuar, faktikisht është vetëm kjo gjendje dashurie. Pra, Zoti nuk synon kurrë që t’i pritët koka apo të urdhërohet për prerjen e kokës së të dashurit të Tij. Mevlana thotë: “Nëse dikush është përgatitur për t’u bërë kurban në rrugë të Allahut Teala duke e afruar qafën te thika si Ismaili, Allahu nuk lejon që të pritët ajo kokë” Sepse ajo që kërkon Allahu i Plotfuqishëm, nuk është prerja e qafës së robit, por është besnikëria e dashurisë dhe e nënshtimit në zemër. Çdo gjë që mund ta dëmtojë këtë besnikëri dhe nënshtim, duhet të bëhet kurban.

Të mos harrojmë se, siç është kusht të jesh mysliman për të bërë kurban, është kusht që të kesh një nënshtim në gradën e dashurisë për t’u bërë kurban. Po ashtu, siç është kusht të jesh i lirë për të bërë kurban, është kusht që të kesh një vullnet dhe dëshirë të brendshme për t’u bërë kurban pa ndonjë imponim. Siç është kusht që të kesh arritur pubertetin për të bërë kurban, ashtu është kusht që të jesh një i mençur dhe i pjekur shpirtërisht për t’u bërë kurban. Siç është pasuria kusht për të bërë kurban, është kusht edhe për t’u bërë kurban. Në çfarëdo çështjeje që mund të bëhemi kurban, mendjet dhe zemrat tona duhet të jenë të pasura. Nëse duhet të bëhemi kurban në çështjen e besimit, patjetër duhet të jemi të pasur me besim. Në të njëjtën mënyrë, duhet të jemi të pasur në dashuri, në dije etj., sepse një njeri që ka dashuri të varfër, nuk mund të bëhet kurban. Edhe ai që është i varfër në besim, nuk mund të bëhet kurban. Të bërë kurban është një shenjë e pasurisë në gjërat që thamë më lart. Pra, është shenjë e sinqeritetit dhe e besnikërisë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “*Namazit është kurbanit i çdo njeriu të devotshëm.*” (Kuzai, Musned, I, 181.) Nisur nga ky aspekt,

e vërteta e Tij më e qartë është të bërë kurbanit për hir të Allahut Teala.

Thuhet se nga umetet e kaluara ishin dy besimtarë. Në vendin ku jetonin, politeistët i kishin imponuar për të therë kurban për idhujt që i kishin bërë vetë. Ata kishin rezistuar, kishin refuzuar dhe kishin thënë: “Kurbani bëhet vetëm për Allahun.” Këtë herë, politeistët i kërcënuan: “Atëherë, bëhuni gati për të vdekur! Nëse nuk bëni kurban për idhujt tanë, do t’ju vrasim!” Përsëri nuk e bënë atë që deshën. Këtë herë, politeistët zullumqarë u zemëruan dhe u irrituan edhe më shumë. Në këtë mënyrë, këtë çështje e shndërruan në çështje inati. Ata ishin të vendosur për t’ua imponuar atyre mendimet e veta. Por këtë radhë e ndryshuan propozimin dhe u thanë: “Të paktën therni një mizë dhe shpëtoni nga vdekja!” Njëri prej këtyre dy besimtarëve e pa këtë propozim si të zakonshëm dhe të padëmshëm. Ai e vlerësoi këtë situatë në mënyrë të verbuar dhe mendoi: “Kjo nuk është asgjë tjetër përveçse një mizë. Më e logjikshme është ta bëj kurban, se sa të vdes...” Kështu, e pranoi propozimin. Menjëherë preu një mizë për një idhull që i treguan politeistët. Pastaj ata e lanë të lirë. Shokut të tij i thanë: “Eja, there edhe ti një mizë!” Por ky besimtari tjetër nuk e pranoi aspak këtë propozim. Përsëri tha: “Sidoqoftë, kurbanit theret vetëm për Allahun!” Mushrikët u zemëruan shumë nga kjo gjë dhe e martirizuan duke i thënë: “Sa njeri i çmendur paske qenë!”

Ky besimtar e dha jetën e tij, por jo besimin. Në këtë mënyrë, u bë prej banorëve të xhenetit. Ndërsa besimtari që pandehte se e shpëtoi jetën duke bërë kurban për idhullin e politeistëve, ndërroi jetë pa e shpëtuar besimin kur i erdhi çasti i vdekjes dhe u bë prej banorëve të xhehenemit. Ja dy shpërfaqje për shkak të kurbanit! Që të dyja janë shpërfaqje jetike. Shumë të rëndësishme nga aspekti i destinacionit. Shumë kuptimplota nga aspekti i shpërblimit. Mesazhi i dhënë është shumë i qartë: “Dashuria, besimi dhe afrimiteti ynë me Allahun Teala është në raport me atë që sakrifkojmë për Të... Sepse jeta është formuar mbi bazën e sakrificës. Edhe feja është sakrificë. Po ashtu edhe dashuria... Kjo sakrificë është ajo që e bëri Ibrahimin, halil (mik të Zotit), Ismailin, delil (argument) dhe Jusufin, xhemil (të bukur). Realiteti i jetës që nga fillimi e deri në fund të saj.

Çfarë pret një fëmijë i sapolindur dhe i dobët? Çfarë pret një baba dhe një nënë që dridhen në kthetrat e pleqërisë? Çfarë pret një i sëmurë që përpëlitet në dhimbje? Çfarë presin viktimat e tragjedive që u janë shkatërruar shtëpitë, të cilat kanë qenë vendstrehimi i tyre në jetë? Çfarë presin rënkimet e shkreta që kërkojnë shpresë për t’u mbajtur në jetë ndërmjet gërmadhave dhe bombardimeve? Çfarë presin të dëshpëruarit që nuk u ka ngelur shpresë jete në gojën e krokodilit të uritur? Çfarë presin të rinjtë që nuk dinë të notojnë në dallgët madhështore të cunameve që shpërthejnë nëpër

shpirtrat dhe moralet e tyre? Çfarë pret një histori e stërmadhe, në faqet e pastra të së cilës ka rënë baltë? Vetëm një gjë: Sakrificë. Të gjitha presin sakrificë. Një sakrificë që do shndërrohet në festë. Një sakrificë që e bën monument mëshire dhe dhembshurie zemrën në të cilën pikon. E bën personalitet shembullor.

Siç dihet, që kur është krijuar kjo botë, asnjëherë nuk kanë munguar vullkanet, tërmetet, furtunat, zitë e bukës, sëmundjet, dobësitë, vuajtjet, luftërat etj... Për këtë arsye, të gjitha zgjidhjet janë mbledhur në një fjalë të vetme: Sakrificë... Ibrahim (a.s.), u hodh në zjarr nga Nemrudi me katapultë, por ai e fitoi sprovën e sakrificimit të jetës. Zjari nuk e dogji atë dhe u shndërrua në një kopsht me lule. Në këtë mënyrë, ky pejgamber i bekuar fitoi atributin Halil (mik i Zotit). Edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, shfaqti kulmin e kësaj sakrifice dhe u bë Habib (i dashuri i Zotit). Edhe sakrificuesit, që thanë nga zemra në audiencën e tij të bekuar: "Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut." – për çdo urdhër, për çdo dëshirë, për çdo shenjë, për çdo frymëmarrje, për çdo hap, për çdo fjalë, për çdo të vërtetë dhe për çdo gjendje të Tij arritën nderin për të qenë shokë të Tij. Ndërsa, ata që erdhën pas Tij dhe u bënë shembuj të kësaj sakrifice pa e parë Atë, fituan pozitën e të qenit vëllezër të Pejgamberit (a.s.). Ata që u sakrificuan dhe u flijuan për këtë përgëzim të Tij duke e arritur këtë pozitë, u bënë Fatihë dhe Akshemseddinë. Ata që e bënë veten kurban për Atë me sakrificë të pafundme, gjithmonë u lartësuan dhe u bënë Mevlana, u bënë Junusë, u bënë Ede-bali, u bënë Nakshibendë, u bënë Hydaji... Të gjithë arritën fitore madhështore. Faktikisht, a nuk është sakrificë misteri i të gjitha fitoreve të vërteta? Sigurisht që ka festë për ata që e flijojnë veten. Sigurisht, ka festë për ata që e flijojnë pasurinë. Sigurisht, ka festë për ata që ia dorëzojnë Hakut në kohë fëmijët e tyre. Sigurisht, ka festë për ata që arrijnë afrimitetin ndaj Zotit me devotshmëri në adhurim, sepse Allahu i Madhëruar thotë: **"Tek Allahu nuk arrin as mishi dhe as gjaku i tyre (i kurbanëve), por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj, që ju ta madhëroni Allahun, sepse ju ka udhëzuar. Prandaj, jepu lajmin e mirë të devotshmëve...!"** (Haxh, 37)

Domethënë, qëllimi i kurbanit është mbujtja e gjendjes sonë shpirtërore me devotshmëri. Domethënë, është afrimitet ndaj Allahut Teala. Është afrimitet me sinqeritet ndaj Tij. Domethënë, nga zemra dhe brenda kornizës së Islamit. Domethënë, afrimitet me dashuri. Afrimitet i pastër totalisht. Të mos harrojmë se kurbanit gjithmonë e afron njeriun te Ai për të cilin bëhet kurban.

Nëse njeriu bën kurban për një gur, atij i ngurtësohet zemra dhe i bëhet si gur. Nëse bën kurban për dheun, shpirti i zhytet në baltë. Por, nëse njeriu bën kurban për Allahun e Lartësuar, atëherë zemra e tij është udhëtare e miraxhit. Për këdo që të bëhet kurban, atje drejtohet edhe qendra e besimit bashkë me të. Pastaj, ndërmjet atij për të cilin është bërë kurbanit dhe atij që e ka bërë kurbanin, fillon një afrimitet i madh. Prandaj, shkak që njëri prej dy besimtarëve u shkatërrua, nuk ishte therja e një mize, por afrimiteti ndërmjet tij dhe idhujve si rezultat i therjes së mizës me njet kurbanit. Sikundër kësaj, nënshtrimi dhe flijimi i vetes për Allahun Teala që shfaqti ai tjetri si Ismaili, e lartësoi atë dhe e bëri të arrijë lumturinë e përhershme, sepse, qoftë negativ apo pozitiv, me kurbanin i cili është afrimitet shpirtëror përjetohet ndryshime dhe transformime të mëdha. Nisur nga kjo, edukimi i njeriut në lidhje me çështjen e kurbanit, mbart një rëndësi shumë të veçantë, sepse, nëse njeriu ka devijuar nga natyra e tij dhe është dhënë pas krijesave, domethënë, nëse adhuron gurët, drurët, paratë, pasurinë, etj., të cilat janë krijuar për t'i shërbyer atij, është shumë e vështirë për ta larguar atë nga ai gabim në të cilin ka rënë, madje, nganjëherë është e pamundur. Kështu është edhe gjendja e kundërt e kësaj. Domethënë, kush e bën veten kurban për dashurinë sublime dhe Krijuesin e Lartësuar, zemra e tij ka formuar me Të lidhje të pashkëputshme. Kjo është edhe ajo që synohet, domethënë, që njeriu ta arrijë këtë pjekuri në rrugën e nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Nisur nga ky aspekt, dashuritë e vërteta gjithmonë i kanë lidhur zemrat me njëra-tjetrën nëpërmjet kodit të kurbanit. Kurbanit gjithmonë është bërë masa më e rëndësishme dhe e vetme e dashurisë së vërtetë. Të gjithë poetët e dashuruar i shprehin poezitë e tyre në horizontin e flijimit.

Mjerë ata që nuk arrijnë ta perceptojnë këtë të vërtetë! Mjerë ata! Mjerë ata që ia bëjnë veten kurban shejtanit dhe armikut, në vend që t'ia bëjnë Allahut të Madhëruar! Mjerë edhe ata njerëz të ditur që ia bëjnë kurban injorancës të vërtetat dhe të drejtat! Mjerë edhe të shkujdesurit që në këtë kohë të fundit, bëjnë kurban miza moderne për idhuj modernë! Mjerë edhe ata që ia dedikojnë veten e tyre padrejtësisë dhe mizorive, në vend që t'ia dedikojnë drejtësisë dhe mëshirës! Sikundër kësaj, lum ata që kapen pas përsheptshmërisë që nuk e ka prishur qëndrimin e saj, edhe pse materializmi, mizoritë dhe padrejtësitë e luftojnë ashpër atë! Lum edhe ata fatmirët që ia kanë dorëzuar veten dhe ia kanë bërë kurban Allahut Teala dhe sulltanit të pejgambereve, Muhamed Mustafasë (a.s.) dhe kanë arritur lumturinë e përhershme!





# *Pa shpëtuar* **AI QË PASTROI SHPIRTIN**

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: **“Pasha nefsën dhe Atë që e krijoi. Atë që ia mësoi nefsit të keqen dhe të mirën. Ka shpëtuar ai, që nefsën e tij e pastroi. Ka humbur ai, që nefsën e tij e neglizhoi”**. (Shems: 7-10).

Në suren Shems Allahu (xh.sh.) betohet 11 herë në 11 gjëra të ndryshme. Kur Zoti betohet në diçka, vërja gishtin kokës se është betim i madh. Ndërsa kur betohet 11 herë, me siguri betimi është 11 herë më i madh. Për çfarë betohet Allahu (xh.sh.)? Përgjigja vjen në ajetin pasues të kësaj sureje. Allahu (xh.sh.) thotë: **“Ka shpëtuar ai që nefsën pastroi. Ka humbur ai, që nefsën e tij e la pas dore”**. (Shems, 9-10). Nefsi jonë është gjëja më e dashur që kemi. Nefsi është vetja jonë dhe çdokush e do veten e tij. Por bëni kujdes, se nefsi mund të jetë edhe armiku më i keq i njeriut. Nëse nefsi merr për keq, nuk ka armik më të fortë sesa nefsi.

Nëse bisedon me dikë dhe nuk të pëlqen muhabeti, ngrihesh pa siklet e largohesh. Nëse nuk të pëlqen shoku, ndahesh me të. Madje edhe bashkëshortët ndahen, nëse nuk e pëlqejnë njëri – tjetrin.

Po nefsit tënd çfarë do t'i bësh, nëse ai nuk është në rregull? Ti nuk mund të ndahesh prej tij, sepse ai është vetja jote. Prandaj Muhamedi (a.s.) lutej me këto fjalë: **“O Allah pastroje nefsën tim, bëje atë nefsi të devotshëm, Ti je Zoti dhe Kujdestari i tij. Askush tjetër nuk e pastroi nefsën përveç Teje”**<sup>1</sup>.

Asgjë tjetër nuk meriton vëmendje më të madhe sesa nefsi i njeriut. Prindi i rri në kokë fëmijës së tij

dhe për çdo gabim ia bën një vërejtje. Pronari i rri në kokë punëtorit të vet dhe e sheh se çfarë vepron. Po njeriu a i rri në kokë nefsit të tij. Nëse fëmija merr për keq, ti mund të jesh mirë, nëse merr punëtori për keq, ti përsëri mund të jesh mirë. Po nëse nefsi yt merr për keq, ku do të shkosh?

Në zakonisht investojmë shumë për të tjerët, por pak punojmë me vetet tona. Nuk ka gjë më të vështirë sesa edukimi i nefsit. Ta edukosh fëmijën është e vështirë. Të edukosh fëmijën e tjetrit, është akoma dhe më e vështirë. Të edukosh një popull është mjaft e vështirë. Por më e vështirë se të gjitha këto është edukimi i nefsit tënd. Prandaj ka pak njerëz që thonë: “Të edukoj njëherë veten time, pastaj të merrem me të tjerët”.

Nefsi kërkon stërvitjen më të madhe. Ka njerëz, që stërvisin mendjen dhe mirë bëjnë. Ka shumë të tjerë, që stërvisin trupin dhe përsëri mirë bëjnë. Por ka shumë pak që stërvisin nefsën e tyre, veten e tyre. Dijetarët e kanë përngjasuar nefsën me fëmijën e vogël. Kur fëmija mësohet me qumështin e nënës, nëse nëna nuk e ndan nga gjiri, ai e ka shumë të vështirë të ndahet nga ai lloj ushqimi. Po ashtu ndodh edhe me nefsën. Nëse ai mësohet me një gjë, e ka shumë të vështirë të ndahet prej saj.

Allahu (xh.sh.) e krijoi nefsën e njeriut me dy elementë të çuditshëm: me shpirtin prej qielli e me trupin prej toke. Ata dashje pa dashje bëjnë luftë brenda njeriut. I zgjuar është ai që i jep prioritet shpirtit, sepse **“Ka shpëtuar ai që pastroi nefsën e vet”** (Shems, 9) dhe nefsi pastrohet vetëm kur lidhet me Zotin. I humbur është ai, që i jep prioritet tokës dhe harron shpirtin,

1. Hadithi i vërtetë. Muslimi (2722) dhe Ahmedi (6/209).

sepse nefsin e tij e ka lënë pas dore. Nëse ia le nefsin tokës, ajo të tërheq poshtë dhe nëse ia le nefsin qiellit, ai të tërheq lart. Prandaj ka njerëz të mëdhenj, të cilët mund të jenë më të pastër se engjëjt e Zotit, sepse gjithmonë synojnë për lart. Gjithashtu ka edhe të tjerë, që ecin me dy këmbë, por që nuk e meritojnë të quhen njerëz, pasi janë më poshtë sesa kafshët që janë krijuar prej dheu.

### Ç'DO TË THOTË TA PASTROSH NEFSIN, Ç'DO TË THOTË TA EDUKOSH VETEN TËNDE?

Kjo do të thotë ta nxjerrësh të keqen nga nefsi e ta mbushësh atë me të mira. Do të thotë ta heqësh dyshimin e ta fusësh besimin, ta heqësh syfaqësinë e të fusësh sinqeritetin. Do të thotë që një punë ta bësh vetëm për hatër të Zotit, do të thotë të nxjerrësh nga nefsi koprracinë e ta mbushësh zemrën me bujari. Do të thotë të nxjerrësh ashpërsinë nga nefsi e ta mbushësh atë me dashuri dhe butësi.

### NEFSI I ÇDO NJERIU KA TRE FORCA

1- **Forca e epshit.** Epshi është dëshira për pasuri, për pushet për ushqim, për luks. Kjo dëshirë i ngjan më shumë kafshëve, të cilat nuk kanë logjikë, por kanë vetëm epshin për të plotësuar. Kështu janë edhe ata njerëz, që nefsin e tyre e kanë lënë në dorë të forcës së epshit. Ata nuk janë njerëz. Allahu thotë në Kuran: **"Ata janë si kafshët madje edhe më keq..."** (Furkan, 44). Më tipiku nga të gjitha kafshët është derri, i cili ka epsh të jashtëzakonshëm. Ai prish e shkatërron, ai vetëm ha e kurrë nuk ngopet. Ashtu është edhe nefsi i njeriut, kur i dorëzohet epsheve.

2- **Forca e zemërimit.** Ajo i ngjan bishave dhe egërsirave. Njeriu ndonjëherë del jashtë kontrolli dhe e harron veten e tij. Atij i zmadhohen sytë, i fryhen damarët, i skuqet fytyra dhe pasi i kalon kjo gjendje pyet: "A unë e bëra këtë punë"? Kështu ndodh, kur njeriu ia dorëzon nefsin e tij zemërimit. Këta njerëz nuk kanë logjikë.

3- **Forca e arsyes dhe logjikës.** Kjo forcë të vendos kufij për shumë gjëra, të cilat nuk duhen bërë. Ata njerëz që ia dorëzojnë nefsin e tyre arsyes dhe logjikës, meritojnë të quhen njerëz. Prandaj Allahu (xh.sh.) ka bërë, që logjika të drejtojë epshin dhe zemërimin. Allahu (xh.sh.)

na bëftë nga ata, që nefsin e tyre ia dorëzojnë logjikës dhe arsyes.

### TË PUNOSH ME VETEN TËNDE.

Kur t'i flasësh tjetrit, t'i thuash vetes: "Po unë a e bëj këtë punë"? Kur e kritikon tjetrin, t'i thuash vetes: "Po unë a ia kam ndaluar vetes këtë gjë"? Nëse duam, që Zoti ta ndryshojë gjendjen tonë, fillimisht duhet të ndryshojmë vetet tona. Ky është hapi më i vështirë, por është hapi i parë në rrugën drejt suksesit. Ajo punë fillon shumë kollaj, fillon me veten tonë. Unë do të pyetem në Ditën e Kiametit vetëm për veten time dhe për asnjeri tjetër. Nëse unë ndryshoj veten time, i them Zotit: "O Zot kaq pata mundësi të ndryshoj veten time dhe Ti je Gjykues i punës që kam bërë".

Të pastrosh nefsin tënd, do të thotë të kujtosh gjithmonë llogarinë. Kur njeriu të dalë para Zotit, do t'i shkojë mendja se ka pasur para, fëmijë e pushet, por asnjëra prej këtyre nuk i hyn në llogari Zotit të gjithësisë. Allahu (xh.sh.) thotë në Kuranin fisnik: **"Përveç atij që vjen me zemër të shëndoshë"**. (Shuara, 89). Të pastrosh nefsin tënd, do të thotë të bëhesh gati për xhenet, pasi njeriu nuk hyn në xhenet pa ndryshuar veten e tij. Allahu (xh.sh.) thotë: **"Ai që ndal nefsin e vet, ai meriton xhenetin e Zotit të Botëve"**. (Naziat, 40-41).

### SI PASTROHET NEFSI?

Pyetja është e vështirë dhe puna është akoma më e vështirë, por inshallah Zoti na e lehtëson. Nefsi pastrohet duke enjohur atë. Njeriu që nuk njeh nefsin e vet, nuk mund ta pastrojë atë. E kush e njeh nefsin më mirë se Krijuesi i nefsit, Allahu (xh.sh.). Mos prit nga jobsimtari, që ta edukojë nefsin e vet, se ai nuk beson se ka nefsi. Nuk beson se ka një njeri tjetër brenda vetes së tij, që duhet ta edukojë. Vetëm ai që e njeh Zotin, mundohet ta edukojë nefsin e vet.

Nefsi pastrohet duke e detyruar të bëjë ibadet, duke e detyruar të rrijë brenda rregullave, se nefsi s'e ka qejf ibadetin, s'e ka qejf rregullin. Ibadeti është rregull. Ibadeti është i vështirë, është i idhët, nuk është i lehtë dhe nefsi s'e ka qejf diçka të tillë, por mësoje me ibadet, mësoje me namaz, mësoje me agjërim, me lexim Kurani. Gjithmonë kritikojë atë dhe ke për të parë se nefsi dalëngadalë zbutet dhe të rri gjithmonë pas



këmbëve të tua, ndërsa kur s'e edukon atë, ai bëhet si kalë pa fre.

Nefsi pastrohet duke folur me të. Sot fatkeqësisht shumë pak njerëz rrinë me nefsin e tyre. Më thoni sa njerëz rrinë pesë minuta me veten e tyre? Realisht nuk rrimë. As televizori nuk të lë, as shoku s'të lë, as kafja s'të lë, as puna s'të lë, as makina s'të lë. Shumë pak njerëz i thonë nefsit: "Pse o nefsi e bëre këtë punë? A s'ke frikë nga Zoti? A s'e di se kjo punë mund të të çojë në zjarr të xhehenemit? Pse o nefsi kur dëgjove për mirë, u bëre dembel, pse s'vrapove të fitosh sevapin e Zotit?"

Le të diskutojmë me veten tonë, me nefsin tonë. Kur kemi probleme me dikë, i themi: "Si thua të ulemi e të merremi vesh?" Po kur nuk je rehat me veten tënde, me nefsin tënd, çfarë duhet të bësh? Duhet të ulemi e të diskutojmë me nefsin tonë, por më shumë se diskutimi, nefsi ka nevojë për qortim. Nefsi duhet qortuar, se zakonisht ai anon nga e keqja dhe robi që qorton nefsin e vet, është shumë më afër Zotit, sesa ai tjetri, i cili bën të kundërtën, i rreh shpatullat nefsit të vet dhe thotë: "Mua kështu më pëlqen, kështu kam qejf të bëj, kështu ma thotë mendja". Këta të dytët janë njerëz, që e duan nefsin e tyre, e shenjtërojnë atë, e kanë dorëzuar veten në dorë të nefsit të tyre dhe Zoti na ka treguar se ai që e dorëzon veten në dorë të nefsit, ai ka shkatërruar veten e tij.

Ka disa njerëz të tjerë, jo vetëm që e duan nefsin, por e shenjtërojnë dhe e adhurojnë atë. Zoti thotë në Kuran: "**A i ke parë ata njerëz, që për zot kanë epshin dhe nefsin e tyre**"? (Furkan, 43). Ata kanë dituri, por i janë dorëzuar totalisht nefsit të vet. Këta njerëz i ka humbur Allahu (xh.sh.).

Nefsi duhet të ketë sinqeritet. Thuaji nefsit tënd: "Çfarë qëllimi kishte për këtë punë që e bëre? A që të të shohë shoku, që të të shohë dikush tjetër, apo e bëre vetëm për Zotin e gjithësisë?" Sinqeriteti është gjëja më e vështirë për nefsin, sepse nefsi nuk ka asnjë hise në sinqeritet. Por nuk ka forcë më të madhe, sesa kur njeriu e bën një punë për Allahun (xh.sh.).

Nefsi pastrohet duke i përmendur vdekjen. Thuaji vetes: "O Nefsi! Ha sa të duash, një ditë do ta nxjerrësh çdo gjë. Jeto sa të duash, një ditë do të vdesësh. Bëj çfarë të duash, një ditë do të japësh llogari një më një. Kujtoje o nefsi vdekjen. Kujtoje atë ditë, kur do të shkosh tek Zoti me punët e tua të mira dhe të këqija. Profeti (a.s.) thoshte: "*Zemra ndryshket ashtu siç ndryshket hekuri. Pastrojeni zemrën tuaj duke përmendur Zotin dhe duke përmendur vdekjen*".<sup>2</sup>

2. Hadith i dobët. Bejhakui në Shuabul iman (519). Shejh Albani e vler -

Nefsi edukohet duke iu lutur Zotit të gjithësisë. Thuaj me gjithë zemrën tënde: "O Allah, pastroji nefset tona, rregulloji ato. Drejtoji nefset tona nga e mira. Bëje nefsin mik për ne dhe jo armik për ne". Profeti (a.s.) u tha një ditë shokëve të tij: "*Në trupin tuaj është një pjesë, e cila nëse është në rregull, gjithë trupi është në rregull dhe nëse prishet ajo, prishet e gjithë jeta e njeriut. Ajo është zemra. Nëse ajo rregullohet, e gjithë jeta shkon mbarë. Nëse zemra prishet, jeta e njeriut shkatërrohet dhe ai thjesht sa mendon se jeton mbi shpinën e kësaj toke*".<sup>3</sup>

I lutemi Allahut (xh.sh.) t'i rregullojë zemrat dhe nefset tona. Njeriu është NJERI për këtë shpirt dhe këtë nefsi që ka dhe jo për paraqitjen e tij. Shpeshherë njerëzit martohen nga bukuria e bashkëshortit/es dhe bukuria e ka ndikimin e saj. Por pasi martohen, ata hyjnë në nefsin e njëri – tjetrit dhe shikojnë një person shumë ndryshe nga sa e kishin menduar. Kështu ata ndahen, sepse i kanë dhënë vlerë pamjes së jashtme, por nuk i kanë dhënë asnjë vlerë esencës.

Ka raste kur njerëzit martohen me pahir. Filimisht nuk të pëlqen bashkëshorti/ja, por kur futesh brenda nefsit të tij, shikon se aty ka një thesar vlerash dhe parimet, saqë ti mahnitesh prej këtij thesari dhe nuk të hyn më në sy bukuria dhe pamja e këtij njeriu. Prandaj gjëja më me vlerë që ka njeriu, është bota e tij e brendshme. Bukuria mund të të gënjejë për 5 minuta, por jo për gjithë jetën.

Nëse shikojmë një vilë të bukur nga jashtë, por të errët dhe të frikshme nga brenda, a mendoni se ndokush ka dëshirë të rrijë aty? Askush nuk do të rrijë në atë shtëpi. Ti nga jashtë mahnitesh, por mirësia e shtëpisë nuk është nga jashtë, por nga brenda, se njeriu rri brenda shtëpisë dhe jo në çatinë e saj. Ka edhe shtëpi të tjera, që nuk duken shumë të bukura nga jashtë, por kur hyn brenda, shikon që në atë shtëpi Zoti ka futur bereqet, kënaqësi e ëmbëlsi dhe ty nuk të bën shumë përshtypje e jashtëmja. Po kështu është edhe puna e njeriut. Pamja e jashtme mund të të gënjejë, por ajo që vlen është shpirti dhe zemra e njeriut.

Prandaj i lutemi Allahut (xh.sh.) që t'i rregullojë zemrat dhe nefset tona. Zoti na i bëftë nefset të qeta, që ditën kur të vdesim të na thonë melekët: "O nefsi i qetë, dil për tek Zoti. Ai është i kënaqur me ty dhe ti je i kënaqur me të. Vendbanimi yt i përhershëm është xheneti i Zotit".

Amin!

son hadithin të dobët. Ndërsa me tekstin në fjalë e shënon Ibn Ebi Shejbeh (34865) si thënie të Ebu Derdas.

3. Hadith i vërtetë. Buhari (52) dhe Muslimi (4178).



# Sëmundjet e zemrës dhe shërimi i tyre



Vërtet, zemrat qetësohen me  
përmendjen e Allahut! (Ra'd, 28)

Xhafer Bekiroglu

Të dashur lexues! Të gjithë duhet ta dimë se miqtë e Zotit kanë thënë: "Shërimi i sëmundjeve shpirtërore, që ia tundojnë zemrën robit dhe që e largojnë atë nga adhurimi ndaj Allahut Teala, është një çështje shumë e rëndësishme që duhet të kryhet në mënyrë absolute. Kjo duhet të vazhdohet deri sa zemra të mos largohet nga Allahu i Madhëruar për shkak të tyre, të mbushet me kënaqësi shpirtërore nga fakti i të qenit mik me Atë dhe të jetë e gëzuar. Sëmundjet për të cilat po flasim, janë katër llojesh:

Lloji i parë: Kjo është çështja e riskut dhe shqetësimet e përpjekjet e tepërta që shfaqen për ta fituar atë. Shërimi i këtij lloji është mbështetja e plotë te Allahu i Madhëruar.

Lloji i dytë: Janë gjërat që vijnë në mendje dhe tentivat në kundërshtim me dispozitat hyjnore për t'i arritur ato gjëra. Shërimi i këtij lloji arrihet vetëm duke i lënë çështjet në dorë të Allahut Teala.

Lloji i tretë: Këto janë gjërat e hidhura dhe fatkeqësitë që na ndodhin. Shërimi i këtyre arrihet vetëm me durim.

Lloji i katërt: Këto janë kazaja e kaderi dhe gjërat e këqija që na ndodhin në forma të ndryshme që ato shfaqen. Shërimi i këtyre arrihet me bindje ndaj Allahut për çdo gjë që vjen prej Tij.

Zemra e robit, që i mbështetet Allahut Teala në çështjen e riskut, që ia lë në dorë Allahut çdo gjë në kohët kur ka frikë apo është e shqetësuar, që shfaq durim ndaj vështirësive dhe që është e kënaqur me caktimin e Zotit, bëhet e pastër dhe arrin qetësinë shpirtërore. Pastaj bëhet një zemër e përsosur dhe arrin çdo gjë që dëshiron. Shërimi dhe ilaçi i këtyre katër lloj sëmundjeve janë këto katër gjëra themelore: Mbështetja te Allahu, lënia e çështjeve në dorë të Allahut, durimi dhe të qenët i kënaqur me caktimin e Zotit (xh.sh.). Secila prej këtyre sëmundjeve është shpjeguar me të gjitha detajet në kreun që flitet për to në Marifetname. Fak-

tikisht, secila prej sëmundjeve që u përmend më sipër, gjithmonë e preokupon zemrën dhe e largon atë çdo çast nga audienca e Allahut të Lartësuar. Sëmundja më e madhe dhe më e vështira prej këtyre është konsideruar shqetësimi për riskun, sepse çështja e riskut është sprovë e madhe për shumicën e njerëzve. Për këtë arsye, e stërmundojnë veten dhe e vështirësojnë jetën. Zemrat e tyre janë të brengosura dhe mendjet të shkujdesura, ngaqë shqetësohen se si do ta fitojnë riskun. Ata kanë hyrë në vështirësi të madhe dhe janë brengosur tej mase në çështjen e sigurimit të riskut. Mendimet u janë prishur, jeta e tyre s'ka begati dhe bota u është ngushtuar.

Shumë prej njerëzve kanë ngelur pa rrugëzgjdhje dhe si rezultat, e kanë lënë adhurimin ndaj Allahut Teala duke u përpjekur për të fituar riskun, kanë shkuar e kanë trokitur në dyert e njerëzve të dhënë pas dynjasë dhe janë bërë shërbëtorë të tyre. Ata janë bërë robër të njerëzve të dobët, siç janë edhe vetë dhe kanë rënë në probleme e vështirësi të mëdha, duke u poshtëruar dhe ofenduar në çdo lloj mënyre. Ata rënkojnë në burgun e natyrës së kësaj bote, kanë devijuar në errësirën e neglizhencës dhe u është shkatërruar jeta prej vuajtjeve të pafundme. Më së fundi, janë penduar duke iu drejtuar Allahut Teala, por për shkak të mëkateve të shumta, kanë merituar zjarrin e xhehenemit. Megjithatë, besimtarët që e kanë të hapur syrin e zemrës nuk janë lidhur shumë pas kësaj bote dhe kanë ndjekur rrugën e dijetarëve të ndershëm. Ata kapen pas fesë së Zotit të Botëve dhe mbështeten plotësisht te Ai. Nuk kontaktojnë me njerëzit më shumë se çështje e nevojshme dhe preferojnë vetminë me Zotin e tyre. E kanë lënë shqetësimin për punën e riskut dhe kanë hyrë në botën shpirtërore. Ata i kanë lënë njerëzit e nefsin dhe kanë arritur qetësinë shpirtërore duke pirë eliksirin e dashurisë. Lum për ata që jetojnë duke e mbajtur të gjallë këtë krahasim në mendjet e tyre!

## SHEGA DHE DOBITË E SAJ

**“Atje do të ketë fruta, palma hurmash dhe shegë.”**  
(Rahman, 68.)

Shega është një pemë e vogël gjetherënëse. Fruti ka ngjyrë të kuqe dhe shije karakteristike majhoshe. Lloji më i mirë i shegës është ajo më e lëngshme dhe me ngjyrë të kuqe të fortë dhe me lëkurë të hollë. Mendohet se atdheu i shegës është Irani. Shega është e përhapur më së shumti në zonën e mesdheut. Në këtë pikëpamje ngjason me përhapjen e ullirit.

Brenda shegës gjenden 700-800 fara të vogla ngjyrë të kuqe. Shija e shegës sillet nga e ëmbla deri te e tharta. Shega kryesisht ka madhësi të një portokalli apo grejfruti. Ka formë ovale dhe lëvore ngjyrë të kuqërremtë.

Shkenca po merret me zbulimin e sekreteve të shegës: hulumtohen përbërësit nutritivë dhe shërues të frutit, lëngut, madje edhe vajit i cili merret nga farat.

Gjithashtu, shega kohë më parë është shpallur “kampionë” midis pemëve dhe sërish është gjendur në qendër të vëmendjes, jo vetëm për shkak të shijes së mirë të thartë e deri te shija e ëmbël, por për shkak të kontributit të saj në ruajtjen dhe forcimin e shëndetit

Shega, një nga frutat më të shijshme këshillohet që të jetë pjesë e dietës sonë. Fakti që ky frut maturohet plotësisht në fillim të vjeshtës dhe vazhdon të korret deri në fillim të janarit, na bind edhe më tepër se përmban vlera ushqyese dhe kuruese të jashtëzakonshme.

Shega është përdorur për qëllime mjekësore që në lashtësi. Por me përparimin e shkencës janë dhe po zbulohen dobi të shumta mjekësore të shegës.

Lëngu i shegës rrit prodhimin e rruazave të kuqe të gjakut, lehtëson nga temperatura dhe zvogëlon ngarkesën kardiake që vëzhgohet kur dikush është i sëmurë me grip.

Ajo është ideale të përdoret kur fëmijët e vegjël shfaqin kollë dhe temperaturë. Për më tepër, përmban një sasi të madhe fitoestrogjenesh (estrogjene bimore) dhe flavonoide, që kanë ndikim mbrojtës në lëkurë, flokë dhe thonj.

Studime të mëparshme kanë treguar se shega është e përshtatshme edhe për të parandaluar infarkt dhe sëmundje të tjera në zemër, pasi është i pasur me antioksidues të shumtë.

Hulumtimet e fundit mbështesin se,





lëngu i saj mund të mbrojë nga infeksionet bakteriale, tumoret e lëkurës, ndihmon në parandalimin dhe ngadalësimin e përhapjes së kancerit në mushkri, kancerit në prostatë, kancerit në gji, diabetit, osteoporozës, etj.

Përse është e dobishme: Shkencëtarë thonë se, konsumimi i përditshëm i shegës nga një mama e ardhshme, mund të pengojë një dëmtim të mundshëm në trurin e embrionit. Përmban lëndë antioksiduese që kontrollojnë tensionin arterial dhe ulin nivelet e kolesterolit.

Shega e pjekur është e nxehtë dhe e lagësht, i ndihmon fytit, mushkërive dhe bronkeve, vepron si lehtësues dhe qetësues i kollës dhe është i mirë për vrerin.

Si laksativ i lehtë, pengon kalbëzimin në lukth dhe është më e fuqishmja në mesin e kategorive të ngjashme të ushqimit si burim me vlera të shumta të substancave për tërë trupin. Shega tretet në lukth dhe thithet shpejt për shkak të temperamentit të saj të jashtë zakonshëm dhe të lehtë, e nxehtë lukthin ngadalë, shega nuk duhet të hahet kur njeriu ka temperaturë.

Lëngu i shegës shuan etjen, rrit oreksin dhe i jep freski mendimit të njeriut për shkak të efektit pozitiv në sistemin nervor.

Gjithashtu përdoret me sukses për heqjen e njollave dhe rruhave të fytyrës.

Lëngu i shegës ka tre herë nivelin më të lartë të antioksidantëve se të rrushit të zi dhe çajit jeshil. Përmban një sasi të lartë të përbërësve bioaktivë, flavonoide; anthocyane, thartirën phenol; polyphenole; të cilat kanë shumë rëndësi në rregullimin, ripërtirjen dhe zhvillimin e qelizave. Është edhe shumë e pasur me kalium, potas, hekur dhe Vitaminat A,C dhe E.

Në mjekësinë popullore përdoren frutat dhe lëvozhgat e tyre, lulet, farat, rrënjët dhe lëvorja e degëve dhe e rrënjëve, e cila ka shije te athet dhe ere.

Lëngu i shegës përmban mesatarisht 12 për qind sheqer, acide organike, pektinë, vitamine C, etj. Vetëm 30 minuta pas marrjes së lëngut të shegës aktiviteti ynë rritet me 32 për qind.

Lëngu i shegës shuan etjen, nxit oreksin dhe përmiçëson tretjen e ushqimeve.

Ai përdoret me sukses në sëmundjet e stomakut dhe të zorrëve, është freskues dhe mënjanon helmet e organizmit.

Lëngu i shegës jep rezultate në luftimin e parazitëve që zhvillohen në zorrë.

Lulet e shegës përmbajnë tani në dhe kanë veti rruçdhëse e tonike; ato rekomandohen në dhimbjet e barkut, në hemorragji, në hemorroidet, si dhe për gargara të gojës, kundër ënjtjes së bajameve dhe acarimeve të mishrave të dhëmbëve.

Merren 20-30 gramë lule shege në një litër ujë dhe vihen të zihen për gjysmë ore. Nga ky çaj merren 2-3 gota çaji në ditë. Edhe lëvozhga e frutave të shegës ka veti regjëse. Lëvozhga e thatë, para se të përdoret, duhet të vihet në ujë për disa orë që të zbutet.

Çaji i lëvozhgave të shegës përdoret kundër diarreve, si dhe për luftimin e krimbave parazitare të zorrëve.

Lëvozhga e frutave të shegës lufton me sukses amebat, të cilat e dobësojnë shumë organizmin, e vëçanërisht te fëmijët. Për këtë merren lëvozhgat e një kokrrë shege, vendosen në një enë prej balte dhe zihen në gjysmë litri ujë derisa të mbetet gjysma e sasisë së ujit. Pasi ftohet lëngu, pihen dy gota çaji në ditë, një në mëngjes e një në darkë, gjithmonë para buke, për 10-15 ditë. Pa përdorur tjetër ilaç, organizmi do të çlirohet nga amebat.

Përzierja magjike: Lëng shege me kivi. Përzierje fantastike, antikancerogjene dhe energjike. Që të dyja përmbajnë sasi të konsiderueshme të vitaminës C.

## FILLON PELEGRINAZHI I HAXHIT



Besimtarët myslimanë nga e gjithë bota kanë mbërritur në qytetin e shenjtë të Mekës, në Arabinë Saudite për të kryer pelegrinazhin e përvitshëm të Haxhit i cili është detyrim një herë në jetë për çdo mysliman që ka mundësi financiare për ta kryer. Haxhi për Myslimanët është një formë adhurimi i cili shërben për pastrimin nga mëkatet dhe afrimin e njeriut me Zotin e gjithësi-

së. Haxhi përveç anës shpirtërore ka edhe përmasën sociale e cila shprehet përmes ndjenjës së vëllazërisë midis njerëzve me kombësi, etni dhe gjuhë të ndryshme. Për të ndihmuar besimtarët në mënyrë që të kryejnë një pelegrinazh sa të më lehtë qeveria Saudite ka bërë investime të jashtëzakonshme për të përmirësuar infrastrukurën e Haxhit.

## HIDHEN THEMELET E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK

U organizua ceremonia e hedhjes së themeleve të projektit gazsjellës 45 miliard dollarësh TAP (Trans Adriatic Pipeline). Projekt i cili do të sigurojë sjelljen e gazit nga Azerbajxhani në Evropë. Nga zbatimi i kë-


tij projekti Shqipëria do të përfitojë të drejtën që të blejë gaz me çmim më të ulët se ato të tregut, për të plotësuar të gjitha nevojat e veta të brendshme me energji.



## SHKENCETARET ZBULOJNE ALPE NE ANTARKTIDE

3 mijë metra nën akullin e Antarktikës, ndodhen masive malore të ngjashme me alpet të vendosura në pjesët e tjera të tokës. Zbulimi është kryer nga një grup shkencëtarësh në përbërje të cilëve kishte amerikanë, evropianë, kinezë dhe japonezë. Shkencëtarët thanë se ky zbulim rrëzoi pretenimet e gjeologëve të cilët deri më sot mbronin tezën se në Antarktikë nuk ka male, e jo më masive malore. Teza e tyre mbështetej në studimin e mënyrës së formimit të Tokës. Zbulimi u arrit falë hulumtimeve me radar dhe rreze lazer të botës poshtë akullit të Antarktikës. Shkencëtarët thanë se

zbuluan një masiv malor të gjatë 800 kilometra dhe maja më e lartë shkon deri në 3 mijë metra. Zbulimi vërteton tezën e shkencëtarëve rusë, të cilët 50 vjet më parë thanë se poshtë akujve të Antarktikës kishte masive malore. Por gjithçka që prej asaj kohe mbeti një tezë e kundërshtuar fort nga gjeologët. Antarktika mendohet se është formuar 100-250 milion vjet më parë, kur Toka ishte ende nën "pushtetin" e dinosaurve. Në atë kohë, thonë shkencëtarët britanikë, "kontinenti i akullit" u shkëput nga "trungu mëmë" dhe nisi të rrëshqasë ngadalë drejt Polin të Jugut.



## AIRBUS PREZANTON SUPERSONIKUN, LONDER - TOKYO 2 ORE

Kompania mëmë e Airbus, EADS ka prezantuar sot një projekt të saj futuristik i cili premton një fluturim dy orësh nga Londra drejt Tokios. Avioni i etiketuar si ZEHST (Zero Emission Hypersonic Transportation) nuk do të shkaktojë ndotje si dhe premton të jetë më pak i zhurmshëm se avionët e sotëm modern. Sipas kompanisë, ky projekt i përket perspektivës,



pasi do të duhen edhe 40 vjet që të marrë jetë. Bëhet fjalë për një supersonik pasagjerësh, i cili do të përdore tre grupe motorësh për të arritur shpejtësinë 3.125 mph, katër herë më shumë se shpejtësia e zërit, dhe do të njihet si Mach 4. Projekti u prezantua sot përpara hapjes zyrtare të "Paris Air Show".

## ORA INTELIGJENTE E APPLE



Në eventin e mbajtur më 9 shtator në San Francisko-s, Apple prezantoi orën e saj inteligjente Apple Watch. Kompania nuk dha një datë specifike për lancimin por theksoi fillimin e vitit të ardhshëm. Ora inteligjente do të kushtojë 349 dollarë.

"Ja vlen të prisni" tha CEO i Apple Tim Cook në skenën ku ai foli. "Ne mendojmë se njerëzit do ta dashurojnë këtë produkt dhe do të duan ta mbajnë në duart e tyre."

Mirë funksionimi i orës inteligjente e bën të domodoshme

disponueshmërinë e një iPhone. Ora inteligjente funksionon me iPhone 6 Plus, iPhone 6, iPhone 5S dhe iPhone 5c. Këto janë telefonët që kompania ka në plan të shesë këtë vit.

Apple Watch do të jetë i disponueshëm në dy madhësi, tre modele: Apple Watch, Apple Watch Sport, dhe Apple Watch Edition. Çmimi prej 349 dollarësh është minimum që duhet të paguani për këtë orë, por në varësi të madhësisë dhe modelit, kostoja mund të rritet.